


# OBLIGIMET E PAPËRMBUSHURA: SI I QASEN QEVERITË E BALLKANIT PERËNDIMOR KRIMIT TË ORGANIZUAR



WESTERN BALKANS  
ORGANIZED CRIME  
**RADAR**



**BCSP**

Shkurt 2021

# OBLIGIMET E PAPËRMBUSHURA: SI I QASEN QEVERITË E BALLKANIT PERËNDIMOR KRIMIT TË ORGANIZUAR

Shkurt 2021

Botues:

**Qendra e Beogradit për Politikë të Sigurisë (BCSP)**

Redaktor:

**Bojan Elek**

Autorë:

**Plator Avdiu, Shpat Balaj, Dina Bajramspahić, Imer Dulaš, Dragana Janićijević, Miloš Jovanović, Magdalena Lembovska, Benjamin Plevljak, Redion Qirjazi, Romario Shehu**

Përkthimi në shqip:

**Lexica**

Dizajni dhe faqosja:

**Srdjan Iliq**



Kingdom of the Netherlands

**B | T | D** The Balkan Trust  
for Democracy  
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND



Norwegian Embassy  
Belgrade

Mohim i përgjegjesisë\*

Mendimi i shprehur në këtë botim nuk përfaqëson mendimin e Ambasadës së Mbretërisë së Norvegjisë në Beograd ose të Fondit Ballkanik për Demokraci, as të Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij.

Lufta kundër krimit të organizuar ka qenë, të paktën në nivel deklarativ, në krye të agjendave të qeverive të Ballkanit Perëndimor për gati një dekadë tani. Ky zotim shpesh ishte vetëm deklarativ, i sjellë nga aktorë të jashtëm, ku i tillë është BE përmes procesit të pranimit që përfshin gjashtëshen e BP dhe vë theksin në nevojën për të trajtuar krimin e organizuar në mënyrë më efektive. Ndërsa perspektiva e zgjerimit konsiderohej ende e besueshme dhe e gjallë, qeveritë kishin stimuj për të investuar përpjekje në zhbërjen e rrjetit të organizuar kriminal që tradicionalisht ka qenë i organizuar më mirë sesa vetë qeveritë. Me fillimin e të ashtuquajturës lodhje të zgjerimit dhe pa ndonjë të ardhme të sigurt evropiane për gjashtëshen e BP, këta stimuj u humbën. Kjo, e shoqëruar me mungesën e nxitjes së mirëfilltë, organike për të trajtuar krimin e organizuar brenda vendeve, çoi në rënien në dëshpërim të shpresave të qytetarëve për shoqëri pa krim.

Ky raport hulumtimi ka për qëllim të hetojë një pjesë të problemit të përshkruar më sipër, respektivisht të përcaktojë pse qeveritë e BP nuk po i përmbushin zotimet për të trajtuar krimin e organizuar. Për ta bërë këtë, një pyetje që duhet adresuar së pari është se si dikush madje mund të vlerësojë efektivitetin e luftës kundër krimit të organizuar në gjashtëshen e BP. Me sa duket, ndërsa ka kuptim të përgjithshëm që rezultatet lënë për të dëshiruar, ekziston një boshllëk si në të dhënat statistikore administrative ashtu edhe në bazë të sondazheve të disponueshme për publikun, gjë që e bën të vështirë të përcaktohet se sa efektive janë përgjigjet e shtetit kundër krimit të organizuar. Kjo lë hapësirë për narrativë konkurruese në lidhje me rezultatet e luftës kundër krimit të organizuar. Kjo është arsyeja pse është e mundur të kemi, në të njëjtën kohë, një qeveri të BP që pretendon se po udhëheq një luftë shumë të suksesshme ndaj mafisë, dhe në të njëjtën kohë ka raporte të besueshme dhe ekspertë udhëheqës që pretendojnë se e njëjta qeveri është kriminalizuar thellësisht dhe lufta e përmendur ndaj mafisë nuk është veçse një marifet mediatic.

Sfida e parë e identifikuar në këtë raport është mungesa e të dhënave të besueshme mbi krimin e organizuar, që është pengesa e vetme më e madhe për të pasur debat publik të informuar me prova mbi këtë çështje. Edhe pse kjo është çështje tashmë e njohur, vlen të përmendet se shumica e vendeve në rajon nuk kanë sisteme statistikore të afta për të mbledhur dhe monitoruar të dhënat për krimin e organizuar. Nëse ekzistojnë këto sisteme, të dhënat ndryshojnë shumë midis llojeve të ndryshme të krimit ose nuk ndahen për të lejuar analiza domethënëse. Një detyrë veçanërisht e vështirë është të përcjellët një rast përmes sistemit të drejtësisë penale sepse nuk ka identifikues unikë që do ta lejonin këtë. Për më tepër, të dhënat zakonisht nuk janë të disponueshme në të gjitha institucionet dhe, edhe pas marrjes së tyre përmes kërkesave të lirisë së informacionit, pak konkluzione mund të nxirren për shkak të sistemeve të menaxhimit të rasteve që përdorin indikatorë të ndryshëm që nuk lejojnë krahasim domethënës.

Gjetja e dytë kryesore është se, megjithëse parakushtet ligjore dhe strategjike kryesisht ekzistojnë në gjashtëshen e Ballkanit Perëndimor, është zbatimi ai që lë shumë për të dëshiruar. Agjencitë e zbatimit të ligjit shpesh janë me kapacitete të pamjaftueshme, atyre u mungon koordinimi dhe burimet e duhura për të qenë në gjendje të përmbushin me sukses mandatet e tyre. Për më tepër, është kuptim i përgjithshëm i të gjithë bashkëbiseduesve të intervistuar në procesin e hartimit të këtij raporti se bashkëpunimi i mjaftueshëm i agjencive të zbatimit të ligjit është faktori më i rëndësishëm për trajtimin e krimit të organizuar. Megjithëse ekzistojnë marrëveshje bilaterale dhe ekzistojnë mori

forumesh rajonale dhe ndërkombëtare për bashkëpunimin e agjencive të zbatimit të ligjit, ekzistojnë pengesa që parandalojnë bashkëpunimin më efektiv dhe përgjigjen më të koordinuar.

Së fundmi, politika luan rol të madh qoftë përmes ndikimit politik mbi agjencitë e zbatimit të ligjit, mungesës së vullnetit politik për të luftuar krimin e organizuar ose vullnetit politik për të mos e luftuar atë, ku duket se politika është pengesa kryesore për të pasur përgjigje më të mira të shtetit ndaj krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor. Strategjia e Besueshme e Zgjerimit e BE-së nga viti 2018 theksonte se “vendet tregojnë elemente të qarta të kapjes së shtetit, përfshirë lidhjet me krimin e organizuar dhe korrupsionin në të gjitha nivelet e qeverisë dhe administratës.” Prandaj janë liderët politikë që janë njëkohësisht zgjidhësit kryesorë të problemit dhe problemi kryesor që duhet të zgjidhet, prandaj u takon atyre që në fund të fundit të marrin përgjegjësinë për krijimin e mjedisit të përshtatshëm për të luftuar kundër krimit të organizuar dhe për të rritur qëndrueshmërinë shoqërore ndaj dëmeve të tij.

<b>Shqipëria</b>	<b>7</b>
Përmbledhje ekzekutive	8
Hyrje	9
Analiza e kuadrit ligjor, strategjik dhe të politikave	10
Bashkëpunimi në nivelin rajonal dhe të BE-së dhe shkëmbimi i njohurive	13
Historiku i përpjekjeve të Shqipërisë kundër KO	15
Identifikimi i mangësive dhe sfidave kryesore	19
Rekomandime	20
Bibliografia	21

---

<b>Bosnja dhe Hercegovina</b>	<b>24</b>
Përmbledhje ekzekutive	25
Hyrje	26
Analiza e kornizës ligjore dhe strategjike	27
Bashkëpunimi në nivel rajonal dhe të BE-së dhe shkëmbimi i njohurive	29
Historiku i përpjekjeve kundër KO të qeverive të BP6	31
Identifikimi i mangësive dhe sfidave kryesore	33
Rekomandime	34
Bibliografia	35

---

<b>Косово</b>	<b>36</b>
Përmbledhje ekzekutive	37
Hyrje	38
Analiza e kornizës ligjore, strategjike dhe të politikave	38
Bashkëpunimi në nivel rajonal dhe të BE-së dhe shkëmbimi i njohurive	40
Historiku i përpjekjeve të institucioneve të Kosovës ...	42
Mangësitë dhe sfidat kryesore të përpjekjeve të Qeverisë së ...	44
Rekomandime	47
Bibliografia	48

---

<b>Mali i Zi</b>	<b>51</b>
Përmbledhje	52
Hyrje	52
Analiza e kornizës ligjore, strategjike dhe legjislativë	53
Bashkëpunimi në nivel rajonal dhe të BE-së	55
Rezultatet e Malit të Zi deri më tani në luftën kundër krimit të organizuar	56
Mangësitë dhe sfidat kryesore	58
Rekomandime	61
Bibliografia	62

---


<b>Maqedonia e Veriut</b>	<b>63</b>
Hyrje	64
Analiza e kornizës ligjore, strategjike dhe të politikave	64
Bashkëpunimi në nivel rajonal dhe të BE-së dhe shkëmbimi i njohurive	67
Historiku i përpjekjeve të Maqedonisë së Veriut kundër KO	69
Konkluzione dhe rekomandime	73
Bibliografia	74

---

<b>Serbia</b>	<b>76</b>
Përmbledhje ekzekutive	77
Hyrje	77
Analiza e kornizës ligjore, strategjike dhe të politikave	78
Bashkëpunimi në nivel rajonal dhe të BE-së dhe shkëmbimi i njohurive	80
Historiku i përpjekjeve të Serbisë kundër KO	81
Mangësitë dhe sfidat kryesore	82
Konkluzion	83
Rekomandime	84
Bibliografia	84

# Shqipëria

Autorë: **Redion Qirjazi, Romario Shehu**



Ky raport fokusohet në ofrimin e një pasqyre të përpjekjeve të Shqipërisë për të luftuar krimin e organizuar, duke analizuar kuadrin ligjor dhe përpjekjet institucionale dhe strategjike të vendit. Qëllimi i këtij raporti është të analizojë përpjekjet aktuale të Shqipërisë dhe ndikimin e tyre në luftimin e krimit të organizuar, për të identifikuar mangësitë dhe për të dhënë rekomandime në këtë drejtim.

Krimi i organizuar është bërë një nga sfidat kryesore në vend që nga fillimi i tranzicionit politik dhe ekonomik në fillim të viteve 1990 dhe vazhdimisht ka arritur nivele më të larta. Autoritetet shqiptare filluan përpjekjet e tyre për të luftuar krimin e organizuar rreth një dekadë pas shfaqjes së tij - kur në fillim të viteve 2000 Shqipëria u bë një Shtet Palë në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe transpozoi dispozitat e saj në Kodin Penal të vendit. Dispozitat e tjera ligjore përkatëse u zbatuan më vonë. Shqipëria mori një qasje më strategjike në fund të viteve 2000, kur miratoi Strategjinë e parë Ndërsektoriale për Luftimin e Krimit të Organizuar 2008-2013, të pasuar nga dokumente të tjerë të rëndësishëm politikë dhe Strategjia e dytë Ndërsektoriale 2013-2020.

Miratimi dhe zbatimi i të dy strategjive nuk ka qenë i rregullt dhe as i qëndrueshëm. Ekzistojnë mbivendosje dhe dyfishime midis strategjisë kundër krimit të organizuar dhe strategjive të ndryshme sektoriale. Ka pasur një rënie në numrin e grupeve të shkatërruara të krimit të organizuar që nga viti 2015. Megjithë përpjekjet e saj, Shqipëria ka ende performancë të dobët në luftën kundër kultivimit të kanabisit dhe trafikut të drogës. Një performancë e krahasueshme e ulët është vërejtur në lidhje me korrupsionin. Procedimet e pastrimit të parave kanë vazhduar nga viti 2015 deri në vitin 2019. Perceptimi i përgjithshëm i qytetarëve për sigurinë publike në vend është ulur gjithashtu që nga viti 2015.

Në këtë kontekst, institucionet e drejtësisë penale duhet të përmirësojnë më tej koordinimin e tyre institucional, por gjithashtu të punojnë më afër me OSHC-të dhe të përdorin në tërësi marrëveshjet operacionale me Bashkimin Evropian. Për vite me radhë nuk ka pasur vlerësim të kërcënimeve të krimit të organizuar në Shqipëri, i cili është i rëndësishëm për t'u publikuar rregullisht pasi ndihmon në kuptimin e kërcënimeve dhe hap rrugën për adresimin e tyre.



Krimi i organizuar (KO) është shfaqur si një nga sfidat më të rëndësishme për Shqipërinë që nga fillimi i tranzicionit politik dhe ekonomik të vendit në fillim të viteve 1990. Duke pasur parasysh rëndësinë e problemit, lufta efektive kundër KO është vendosur të jetë prioritet kyç i rezultatit për Shqipërinë përpara hapjes së negociatave të pranimit me Bashkimin Evropian (BE).<sup>1</sup> Megjithëse KO u shfaq në fillim të viteve 90, Shqipëria ishte kryesisht e papërgatitur për përballje me këto sfida gjatë asaj kohe dhe ishte në gjendje të miratojë vetëm Strategjinë e saj të parë Ndërsektoriale për të Luftuar Krimin e Organizuar, Trafikimin e Paligjshëm dhe Terrorizmin në vitin 2008,<sup>2</sup> që u rinovua në vitin 2013. Raportet dhe statistikat ndërkombëtare nga institucionet kombëtare zbulojnë zgjerimin e konsiderueshëm të KO shqiptar në Shqipëri dhe jashtë saj. Rrjetet e KO shqiptar janë tani në gjendje të kryejnë operacione transkontinentale në shkallë të gjerë nga transportimi i drogës dhe kontrolli i tregjeve të drogës në të gjithë Evropën, deri në ndërmarrjen e operacioneve të suksesshme të pastrimit të parave duke përdorur Shqipërinë si platformë.<sup>3</sup> Autoritetet shqiptare kanë bërë përpjekje për të luftuar KO duke përmirësuar infrastrukturën dhe kapacitetet ligjore, institucionale dhe strategjike, por ende nuk janë parë rezultate të prekshme.

Qëllimi i këtij raporti është të analizojë përpjekjet aktuale dhe ndikimin e Qeverisë së Shqipërisë në trajtimin e çështjes së KO, për të shqyrtuar sfidat dhe për të dhënë rekomandime. Më konkretisht, raporti i) analizon kuadrin legjislativ, institucional dhe strategjik për të luftuar KO, ii) vlerëson bashkëpunimin dhe shkëmbimin e njohurive midis Shqipërisë dhe BE-së, si dhe bashkëpunimin rajonal, iii) analizon historikun e përpjekjeve të Shqipërisë kundër KO, iv) identifikon mangësitë kryesore që parandalojnë përpjekje më efektive kundër KO, dhe v) propozon rekomandime për të adresuar çështjet.

Raporti është përgatitur bazuar në metodën cilësore të hulumtimit, duke përdorur të dhëna primare dhe sekondare, të mbledhura përmes hulumtimit të tryezës.

---

1 Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2013-2014. [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2013/package/strategy\\_paper\\_2013\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2013/package/strategy_paper_2013_en.pdf). Qasur më 1 janar 2021.

2 CSDG Shqipëria, 2020. Vlerësimi Bazë: Strategjia Ndërsektoriale për Luftimin e Krimin të Organizuar 2013-2020, Tiranë: Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes. Në dispozicion në <http://csdgalbania.org/wp-content/uploads/2020/12/Baseline-assessment-Organized-Crime.pdf>.

3 Dyrmishi dhe Kamolli, 2018. Qasja administrative në luftimin e krimin të organizuar: Eksplorimi i mundësisë së zbatimit në Shqipëri. CSDG Shqipëria.

# Analiza e kuadrit ligjor, strategjik dhe të politikave

Shqipëria është nënshkruese e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (UNTOC)<sup>4</sup> dhe tre protokolleve të saj që nga viti 2002. Dispozitat e UNTOC mbi krimin e organizuar u transpozuan në Kodin Penal në vitin 2003.<sup>5</sup> Përveç ndryshimeve të legjislacionit penal në vitin 2017<sup>6</sup> - i cili prezantoi vepra të reja penale dhe teknika të veçanta hetimore - ligje të tjera të reja përkatëse u miratuan gjithashtu.<sup>7</sup> Kuadri ligjor shqiptar është përafëruar pjesërisht me Vendimin Kuadër të Këshillit të BE-së për luftën kundër KO.<sup>8</sup> Ndryshime të tjera në lidhje me kuadrin ligjor të përmendur nga Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE)<sup>9</sup> 2020-2022 përfshinë miratimin e disa urdhrave nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë të cilat synojnë të forcojnë përpjekjet institucionale drejt luftimit të KO.

Shqipëria nisi praktikat për të luftuar pastrimin e parave nga njerëz të lidhur me krimin dhe terrorizmin në vitin 2009, kur qeveria miratoi ligjin “Anti-Mafia”,<sup>10</sup> që përmbante dispozita të qarta në lidhje me parandalimin dhe sekuestrimin e pasurive. Megjithëse u bënë disa ndryshime në ligj, ai mbeti kryesisht i pasuksesshëm për shkak të mungesës së koordinimit institucional dhe kapaciteteve të pamjaftueshme.<sup>11</sup>

Pas joefikasitetit të tij, në fillim të vitit 2020 Shqipëria miratoi një paketë të posaçme për futjen e masave të përkohshme parandaluese për të rritur kapacitetin e saj për t’iu kundërvënë KO dhe terrorizmit (referuar gjerësisht si paketa anti “Kap Ça të Kapësh”, ose “KÇK”).<sup>12</sup> Këto masa u përqendruan kryesisht në kapjen dhe konfiskimin e pasurive, duke kufizuar kështu lëvizjet e kriminelëve të dyshuar dhe duke kufizuar aktivitetet e tyre ekonomike. Mekanizmi përmes të cilit “KÇK” po zbatohet nga një strukturë e veçantë (OFL) brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit të ngarkuar me parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe kundërveprimin e krimit të rëndë dhe të organizuar.<sup>13</sup> Para miratimit të tij, akti normativ u kritikua nga organizatat e shoqërisë

4 Ligji 8920/2002. Për ratifikimin e “Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar” dhe dy protokolleve të saj shtesë.

5 Ligji 8733/2001 dhe Ligji 9086/2003

6 Ligji Nr. 7895 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar me ligjin 36/2017 dhe ligjin 89/2017.

7 Ligji 60/2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”; Ligji Nr. 9205/2004 për Bashkëpunëtorët e Drejtësisë dhe Mbrojtjen e Dëshmitarëve ndryshuar në 2009 me ligjin 10173/2009 “Për Bashkëpunëtorët e Drejtësisë dhe Mbrojtjen e Dëshmitarëve”

8 Vendimi i Këshillit të Bashkimit Evropian për luftën kundër krimit të organizuar. Në dispozicion në <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32008F0841&from=EN>.

9 Urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë përfshijnë i) urdhrin 328/2018 për krijimin e Sektorit të Forcës Speciale Operative për Mbështetjen Hetimore, ii) krijimin e njësisë Fast Albania dhe iii) planin e veprimit 257/2019 “Për parandalimin dhe luftimin e aktivitetit kriminal të kultivimit të narkotikëve për vitin 2019.

10 Ligji 192/2009 “Për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit përmes masave parandaluese kundër pronës”. Në dispozicion në [http://www.pp.gov.al/web/ligj\\_per\\_parandalimin\\_dhe\\_goditjen\\_e\\_krimit\\_te\\_organizuar\\_dhe\\_trafikimit\\_nepermjet\\_masave\\_parandaluese\\_kunder\\_411.pdf](http://www.pp.gov.al/web/ligj_per_parandalimin_dhe_goditjen_e_krimit_te_organizuar_dhe_trafikimit_nepermjet_masave_parandaluese_kunder_411.pdf)

11 Prokuroria e Përgjithshme, 2020. Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Krimit për vitin 2019, Tiranë: Prokuroria e Përgjithshme.

12 Këshilli i Ministrave Akti Normativ “Masat parandaluese në kuadrin e forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të sigurisë publike. Tiranë: Këshilli i Ministrave.

13 Po aty.

civile (OSHC) të cilat iu drejtuan Kryetarit të Kuvendit për të përcjellë shqetësimet e tyre në një deklaratë të përbashkët:

“Akti Normativ (Anti-KÇK) anashkalon kuadrin kushtetues të vendit, shkel parimin e ndarjes dhe ekuilibrit të pushteteve, shkel të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, përfshirë lirinë e lëvizjes dhe të drejtën për proces të rregullt ligjor, dobëson ligjin dhe pavarësinë efektive të Prokurorisë dhe mund të minojë luftën kundër KO.”<sup>14</sup>

Avokati i Popullit gjithashtu kishte rezerva në lidhje me aktin normativ, pasi akti merrte përsipër sigurimin e mekanizmave të kompetencave paralele që krijojnë premisa për këtë akt normativ të jetë antikushtetues dhe në shkelje të të drejtave të njeriut.<sup>15</sup> Përkundër kritikave nga OSHC-të dhe Avokati i Popullit, akti normativ u miratua,<sup>16</sup> megjithëse nuk ka arritur rezultatet e pritura. Megjithatë, njëmbëdhjetë muaj nga themelimi i OFL, asnjë pronë e vetme nuk u konfiskua. Prandaj, praktikisht dështoi në misionin e vet për të konfiskuar pasuritë, ku vetëm arriti t'i konfiskonte ato përkohësisht.<sup>17</sup>

Përpjekjet e Shqipërisë për të konfiskuar dhe kapur pronat e KO kanë qenë të pasuksesshme, prandaj BE e ka nxitur Shqipërinë të krijojë ose të caktojë një zyrë të ngarkuar me identifikimin dhe gjurmimin e pasurive kriminale, të miratojë legjislacionin që shënjestron pasurinë e pajustificuar.<sup>18</sup>

Ka disa njësi të specializuara të drejtuara drejt luftës kundër KO në Shqipëri. Në nivelin taktik ekziston Departamenti i Krimit të Rëndë dhe të Organizuar brenda Policisë së Shtetit Shqiptar (PSH). Hetimet e KO mbikëqyren nga Prokuroria Speciale (PS). Lidhur me institucionet gjyqësore, ekziston një Gjykatë e Specializuar kundër Korrupsionit dhe KO e shkallës së parë dhe një Gjykatë e Apelit e Specializuar kundër Korrupsionit dhe KO. Në vitin 2018, u krijuan Këshilli i Lartë Prokurorial dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor,<sup>19</sup> që çoi në krijimin e Prokurorisë Speciale dhe Strukturës Kundër Korrupsionit dhe KO (SPAK),<sup>20</sup> të ngarkuara për të hetuar dhe gjykuar çështje të nivelit të lartë të korrupsionit dhe KO - parë gjithashtu si një mundësi efektive për të hetuar (të paprekshmit) zyrtarë të lartë dhe bosët e krimit në Shqipëri.<sup>21</sup>

14 Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 2020. Komiteti Shqiptar i Helsinkit. (Në internet)

Në dispozicion në: <https://ahc.org.al/oponence-ligjore-per-aktin-normativ-me-fuqine-e-ligjit-te-keshillit-te-ministrave-nr-1-dt-31-01-2020/>. [Qasur më 26 nëntor 2020].

15 Brakaj, 2020. Fakteje Albania. [Në internet] Në dispozicion në: <https://faktoje.al/spak-rrezon-legjitimitetin-e-aktit-normativ-anti-kck/>. [Qasur më 26 nëntor 2020].

16 Kuvendi Kombëtar i Republikës së Shqipërisë, 2020. Për Miratimin e Aktit Normativ “Për Masat Parandaluese në kuadër të Forcimit të Luftës kundër Terrorizmit, Krimit të Organizuar, Krimeve të Rënda dhe Konsolidimit të Sigurisë Publike. Tiranë: Këshilli i Ministrave.

17 Euronews Albania, 2020 [Në internet] Në dispozicion në <https://euronews.al/al/unpublished/2020/12/23/11-muaj-nga-krijimi-i-ofl-se-ende-as-nje-prone-e-konfiskuar>.

18 Komisioni Evropian, 2020. DOKUMENTI PUNUES I STAFIT TË KOMISIONIT: Raporti Shqipëri 2020, Bruksel: Komisioni Evropian. Në dispozicion në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf)

19 Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC), 2020. Matja e Krimit të Organizuar në Ballkanin Perëndimor (Vjenë) f. 62-63.

20 Ligji 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit”. Në dispozicion në [https://klp.al/wp-content/uploads/2020/02/lliqj\\_nr\\_95\\_2016\\_per\\_organizimin\\_dhe\\_funksionimin\\_e\\_institucioneve\\_per\\_te\\_luftuar\\_korrupsionin\\_dhe\\_krimin\\_e\\_organizuar\\_s\\_1728.pdf](https://klp.al/wp-content/uploads/2020/02/lliqj_nr_95_2016_per_organizimin_dhe_funksionimin_e_institucioneve_per_te_luftuar_korrupsionin_dhe_krimin_e_organizuar_s_1728.pdf)

21 Reporter.al, 2019. Në dispozicion në <https://www.reporter.al/ngrihet-struktura-e-posacme-per-luften-kunder-korrupsionit-dhe-krimit-te-organizuar/>

Nga fillimi i viteve 2000, Shqipëria ka miratuar një seri strategjish për të trajtuar korrupsionin dhe format e tjera të KO.<sup>22</sup> Në vitin 2008, Shqipëria miratoi strategjinë e parë kundër KO,<sup>23</sup> e cila u pasua nga strategjia e dytë në vitin 2013<sup>24</sup> si dokument kryesor strategjik kombëtar që synon të koordinojë përpjekjet e shtetit për t'iu kundërvënë KO - edhe pse përpjekje të tilla koordinimi nuk kanë qenë të suksesshme.<sup>25</sup> Dokumente shtesë të politikave që kontribuojnë në luftën kundër KO përfshijnë plane veprimi kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit,<sup>26</sup> ri-integrim të viktimave të trafikimit,<sup>27</sup> dhe siguri kibernetike.<sup>28</sup>

Shqipëria nuk ka publikuar një vlerësim kombëtar të kërcënimit të KO në vitet e fundit,<sup>29</sup> gjë që është e rëndësishme në dhënien e kuptimit të besueshëm të kërcënimeve dhe adresimin e duhur të tyre. Një metodologji e mirë për vlerësimin e KO është SOCTA.<sup>30</sup>

Përveç mungesës së vlerësimit të kërcënimit të KO, Shqipëria nuk kishte një raport monitorimi në lidhje me zbatimin e strategjisë deri në fund të vitit 2020.<sup>31</sup> Mungesa e një monitorimi të tillë pengon mundësinë e përmirësimit dhe shkakton mosdisponueshmëri të të dhënave.

Raporti i monitorimit të vitit 2020<sup>32</sup> vëren se procesi i miratimit dhe zbatimit të strategjive ka qenë i parregullt dhe jo konsistent, duke iu përgjigjur kryesisht kërkesave të BE-së, treguesit e tyre janë formuluar dobët dhe të dy strategjitë kundër KO nuk kanë arritur të prodhojnë plane veprimi për tre vjet, nga gjashtë, për të siguruar zbatimin e duhur të strategjive përkatëse.

---

22 Vendim i Këshillit të Ministrave 292/2004. Strategjia Kombëtare kundër Drogës 2004-2010; Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve Viktima të Trafikimit 2008-2010; Strategjia Kombëtare për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008-2010; Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin, Luftën Kundër Korrupsionit dhe Qeverisjen Transparente, 2008-2013; Strategjia e Integruar e Menaxhimit të Kufirit 2007-2013; Strategjia e Sektorit të Rendit Publik 2007-2013.

23 Vendim i Këshillit të Ministrave 1140/2008 "Strategjia Ndërsektoriale për Luftimin e Krimit të Organizuar, Trafikimit dhe Terrorizmit 2008-2013"

24 Vendimi 663/2013. Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Luftimin e Krimit të Organizuar, Trafikimit të Paligjshëm dhe Terrorizmit 2013-2020 dhe Planit të Veprimit 2013-2016

25 CSDG Shqipëria, 2020. Vlerësimi Bazë: Strategjia Ndërsektoriale për Luftimin e Krimit të Organizuar 2013-2020, Tiranë: Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes. Në dispozicion në <http://csdgalbania.org/wp-content/uploads/2020/12/Baseline-assessment-Organized-Crime.pdf>. f. 7-9.

26 Vendim i Këshillit të Ministrave 248/2017. Për miratimin e Planit të Veprimit kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit 2017-2020.

27 Vendim i Këshillit të Ministrave 115/2016. Për miratimin e Planit të Veprimit për Ri-Integrimin Socio-Ekonomik të Grave dhe Vajzave të Mundshme, Viktima të Trafikimit.

28 Vendim i Këshillit të Ministrave 973/2015. Në dispozicion në <https://cesk.gov.al/wp-content/uploads/2016/04/Dokumenti%20i%20Politikave%20per%20Sigurine%20Kibernetike%202015-2017.pdf>

29 Komisioni Evropian, 2020. DOKUMENTI PUNUES I STAFIT TË KOMISIONIT: Raporti Shqipëri 2020, Bruksel: Komisioni Evropian. Në dispozicion në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf)

30 Vlerësimi i Kërcënimit të Krimit të Rëndë dhe të Organizuar - SOCTA është një nga raportet kryesore, strategjike të EUROPOL-it, i cili shërben për të vlerësuar dhe dhënë përparësi ndaj kërcënimeve, dobësive dhe mundësive për krim.

31 CSDG Shqipëria, 2020. Vlerësimi Bazë: Strategjia Ndërsektoriale për Luftimin e Krimit të Organizuar 2013-2020, Tiranë: Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes. Në dispozicion në <http://csdgalbania.org/wp-content/uploads/2020/12/Baseline-assessment-Organized-Crime.pdf>

32 Po aty. f. 28-29

## Bashkëpunimi në nivelin rajonal dhe të BE-së dhe shkëmbimi i njohurive

Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër KO është një nga objektivat strategjikë të strategjisë kombëtare.<sup>33</sup> Ndërsa ka prova të mjaftueshme që tregojnë bashkëpunimin e Shqipërisë me BE-në në lidhje me luftën kundër KO, pak informacion u gjet në lidhje me bashkëpunimin rajonal në këtë drejtim. Duke pasur parasysh natyrën rajonale dhe transnacionale të bashkëpunimit midis grupeve të organizuara kriminale (GOK), dhe faktin se të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) janë të shqetësuara për ta luftuar atë,<sup>34</sup> bashkëpunimi rajonal është një mundësues i rëndësishëm drejt këtij qëllimi.

Shqipëria ka ndërmarrë hapa për të forcuar bashkëpunimin policor me BE-në deri në lejimin e monitorimit nga ajri nga Guardia di Finanza Italiane, duke intensifikuar bashkëpunimin me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Zbatimin e Ligjit (EUROPOL) dhe Agjencinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim për Drejtësi Penale (EUROJUST) - duke çuar në një numër operacionesh të suksesshme të zbatimit të ligjit në shkallë të gjerë.<sup>35</sup> Shqipëria ka nënshkruar gjithashtu marrëveshje për bashkëpunim operacional me Qendrën Evropiane të Monitorimit të Narkotikëve dhe Varësisë nga Drogat (EMCDDA) dhe Agjencinë Evropiane të Kufirit dhe Rojës Bregdetare (FRONTEX). Kjo e fundit nisi operacionin e saj të parë të përbashkët të plotë jashtë BE-së, në kufirin Greko-Shqiptar në maj 2019,<sup>36</sup> si rezultat i të cilit, 7087 imigrantë të parregullt (77.8% e imigrantëve të parregullt të kapur në Shqipëri) janë kapur dhe përpunuar në pikat e hyrjes për migrantët e parregullt.<sup>37</sup>

Shqipëria ka një marrëveshje për bashkëpunim strategjik dhe operacional me EUROPOL, të ratifikuar në vitin 2014 dhe të përditësuar në vitin 2018.<sup>38</sup> Kjo marrëveshje lejon shkëmbimin e të dhënave personale midis palëve, gjë që bëhet përmes Rrjetit të Sigurt të Shkëmbimit të Informacionit (SIENA). Numri i operacioneve të përbashkëta ndërkombëtare ka pasur një rritje të lehtë në vitin 2019, gjë që korrespondon me nënshkrimin e marrëveshjes midis Shqipërisë dhe EUROPOL përmes ligjit 60/2018 (Shih Grafikon 1).

33 Vendimi 663/2013. Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Luftimin e Krimit të Organizuar, Trafikimit të Paligjshëm dhe Terrorizmit 2013-2020 dhe Planit të Veprimit 2013-2016. f. 13.

34 Grupi Këshillimor i Politikave të Ballkanit në Evropë (BiEPAG) (2019). Forcimi i Sundimit të Ligjit në Ballkanin Perëndimor: Thirrje për një Revolucion kundër Partikularizmit. Studimi i politikave. Në dispozicion në <http://biepag.eu/wp-content/uploads/2019/03/Strengthening-the-Rule-of-Law.pdf>.

35 Komisioni Evropian, 2020. DOKUMENTI PUNUES I STAFIT TË KOMISIONIT: Raporti Shqipëri 2020, Bruksel: Komisioni Evropian. Në dispozicion në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf)

36 Frontex, 2019, "Frontex fillon operacionin e parë në Ballkanin Perëndimor". Në dispozicion në: <https://frontex.europa.eu/media-centre/news/news-release/frontex-launches-first-operation-in-western-balkans-znTNWM>

37 Policia e Shtetit Shqiptar, 2020. Raporti vjetor, Tiranë. Në dispozicion në: <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Policia-e-Shtetit-ANALIZA-VJETORE-2019.pdf>. f. 16-17.

38 Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2020-2022. Qendra për Publikime Zyrtare. Në dispozicion në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/02/19/151>.



*Tabela 1: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Marrë nga CSDG Shqipëria, 2020*

Ndërsa raporti BE 2020<sup>39</sup> tregon që numri dhe cilësia e mesazheve të shkëmbyera përmes SIENA është përmirësuar ndjeshëm që nga fundi i vitit 2019, gjithashtu sugjeron që agjencitë shqiptare të zbatimit të ligjit duhet të përdorin në tërësi marrëveshjen operationale me EUROPOL, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit më proaktiv dhe në kohë përmes SIENA, dhe të vihet në përdorim më të mirë të ekipeve të përbashkëta të hetimit. Marrëveshja midis Shqipërisë dhe EUROPOL (ligji 77/2018) ka mundësuar vendosjen e një Zyrtari Ndërlidhës të EUROPOL-it në mjediset e PSH që nga viti 2019,<sup>40</sup> i pari që operoi në BP. Zyrtari i ndërlidhjes ka ndihmuar në forcimin e bashkëpunimit të forcës policore midis Shqipërisë dhe Shteteve Anëtare të BE-së në luftën kundër KO, rritjen e shkëmbimit të informacionit dhe rritjen e kapaciteteve të PSH në vlerësimin e kërcënimeve kryesore të KO. Të dhënat nga raporti vjetor i Policisë së Shtetit<sup>41</sup> tregojnë se në vitin 2019, gjithsej 31,591 informacione u shkëmbyen me partnerë ndërkombëtarë, nga të cilat, 18,500 me Interpol, 8,645 me EUROPOL dhe 4,446 me Zyrtarë të Kontaktit. Në të njëjtin raport thuhet se shkëmbimi i informacionit është rritur me 5%.

Shqipëria ka nënshkruar gjithashtu një Marrëveshje Bashkëpunimi<sup>42</sup> me EUROJUST, të ratifikuar me ligjin 113/2018, qëllimi kryesor i të cilit është të lehtësojë më tej bashkëpunimin gjyqësor midis praktikuesve shqiptarë dhe të BE-së në luftën kundër krimeve të rënda, me një fokus specifik në KO dhe terrorizmin. Kjo marrëveshje ka rritur shumë numrin e përgjithshëm të hetimeve të përbashkëta ndërkombëtare në Shqipëri (Shih Grafikon 2).

39 Komisioni Evropian. 2020. DOKUMENTI PUNUES I STAFIT TË KOMISIONIT: Raporti Shqipëri 2020, Bruksel: Komisioni Evropian. Në dispozicion në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf)

40 Plan i Kombëtar për Integrimin Evropian 2020-2022. Qendra për Publikime Zyrtare. Në dispozicion në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/02/19/151>.

41 Policia e Shtetit Shqiptar, 2020. Raporti vjetor, f. 15. Tiranë. Në dispozicion në: <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Policia-e-Shtetit-ANALIZA-VJETORE-2019.pdf>.

42 Prokuroria e Përgjithshme, 2020. Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Krimit për vitin 2019, Tiranë: Prokuroria e Përgjithshme. f. 287-288.



*Tabela 2: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Marrë nga CSDG Shqipëria, 2020*

Vetëm në vitin 2019, Pika e Kontaktit në Prokurorinë e Përgjithshme ka marrë të paktën 23 kërkesa për ndihmë juridike nga Shtetet Anëtare si Italia, Greqia, Republika Çeke, Zvicra, Hungaria dhe Mali i Zi.<sup>43</sup> Shqipëria emëroi Prokurorin e Ndërlidhjes në EUROJUST në dhjetor 2020, sipas rekomandimit të BE-së.<sup>44</sup> Gjatë vitit 2020, bashkëpunimi me EUROJUST çoi në arrestimin e 37 anëtarëve të një GOK përgjegjës për trafikimin ndërkombëtar të sasive të mëdha të drogës,<sup>45</sup> si dhe në një operacion ndërkombëtar shumë të suksesshëm të pashembullt e të paparë që përfshinte autoritetet gjyqësore dhe të zbatimit të ligjit në dhjetë vende që rezultoi në asgjësimin e plotë të grupit kriminal shqipfolës 'Kompania Bello', një nga rrjetet më aktive të trafikut të kokainës në Evropë.<sup>46</sup>

## Historiku i përpjekjeve të Shqipërisë kundër KO

Meqenëse Shqipëria nuk ka publikuar një vlerësim kombëtar të kërcënimit të KO dhe të rëndë në vitet e fundit, i cili është i nevojshëm për të pasur një pasqyrë të besueshme të kërcënimeve, historiku i përpjekjeve të Shqipërisë kundër KO vlerësohet sipas disa fushave të KO ku të dyja janë tregues të strategjisë kombëtare,<sup>47</sup> dhe gjithashtu identifikohen nga dy raporte ndërkombëtare, Raporti i Strategjisë Ndërkombëtare të Kontrollit të Narkotikëve të Departamentit të Shtetit të SHBA 2020 dhe raporti i KE 2020 Shqipëri.

43 Po aty, f. 289-290

44 Prokuroria e Përgjithshme, 2020 "Prokurori i Ndërlidhjes së Shqipërisë në Eurojust është i komanduar." Në dispozicion në [http://www.pp.gov.al/web/Komandohet\\_Prokurori\\_nderlidhes\\_i\\_Shqiperise\\_prane\\_Eurojust\\_1518\\_1.php#\\_X\\_bpR9hKiUl](http://www.pp.gov.al/web/Komandohet_Prokurori_nderlidhes_i_Shqiperise_prane_Eurojust_1518_1.php#_X_bpR9hKiUl)

45 Eurojust, 2020 Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim me Drejtësinë Penale. (Në internet) Në dispozicion në: <https://www.eurojust.europa.eu/major-albanian-italian-drafficking-network-dismantled>. [Qasur më 17 nëntor 2020].

46 Po aty.

47 Vendimi 663/2013. Për miratimin e Strategjisë Ndërsëktoriale për Luftimin e Krimit të Organizuar, Trafikimit të Paligjshëm dhe Terrorizmit 2013-2020 dhe Planit të Veprimit 2013-2016





Tabela 3: Të dhënat e marra nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin, Matja e Krimin të Organizuar në Ballkanin Perëndimor, 2020.

Shpërbërja e GOK-ve të përfshira në aktivitetet e KO është një nga treguesit e brendshëm të strategjisë kombëtare. Në të vërtetë ka pasur një rënie në numrin e GOK-ve që janë shpërbërë gjatë gjithë viteve, që nga viti 2015 (Shih Grafikon 4). Kjo mund të jetë rezultat i rënies natyrore të numrit të grupeve GOK në Shqipëri, shkaktuar nga puna efektive e mekanizmave kundër KO, ose thjesht një tregues i performancës më pak efektive të këtyre institucioneve, veçanërisht kur merret parasysh që niveli i lartë i aktivitetit të KO është ende i pranishëm në Shqipëri.



Grafiku 4: Burimi: CSDG Shqipëria, 2020. Vlerësimi bazë: Strategjia Ndërsektorale për Luftimin e KO

Sekuestrimi i pasurive që rrjedhin nga aktivitete të paligjshme është një tregues tjetër i brendshëm i strategjisë kombëtare, ashtu siç edhe theksohet nga raportet ndërkombëtare. Procedurat e pastrimit të parave kanë qenë konstante nga viti 2015 deri në vitin 2019, me një rritje të lehtë në vitin 2017, dhe rënie graduale në vitet në vijim (Shih Grafikon 5). Duke marrë parasysh nivelin e lartë të pastrimit të parave në Shqipëri të treguar nga raportet ndërkombëtare, numri i procedurave penale në rënie, mund të interpretohet vetëm si një performancë e dobët e institucioneve shtetërore në këtë drejtim.



Grafiku 5: Grafiku tregon procedurat e regjistruara penale për pastrimin e parave nga Prokuroria e Përgjithshme (neni 287/a - llogari anonime dhe neni 287/b - keqpërdorim i parave ose i mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose aktiviteti kriminal.



Tregu i paligjshëm i narkotikëve është një tregues i strategjisë kombëtare, dhe gjithashtu i theksuar nga raportet ndërkombëtare. Trafikimi i drogës ka qenë sektori më fitimprurës për grupet kriminale në Shqipëri për 30 vitet e fundit. Kultivimi i kanabisit mbetet i fortë në vend, pavarësisht përpjekjeve të konsiderueshme për të frenuar prodhimin.<sup>48</sup> Raporti i Departamentit të Shtetit vëren se Shqipëria është në procesin e përpjekjes për të miratuar reforma gjithëpërfshirëse të drejtësisë penale për të ndjekur dhe dënuar në mënyrë më efektive kriminelët për trafik droge duke përdorur lidhjen e KO - dhe është jetike që qeveria shqiptare të vazhdojë zbatimin e reformës në drejtësi dhe të punojë për të çrrënjësuar ndikimin e KO.<sup>49</sup> Në një shënim më pozitiv, raporti i KE vëren se Shqipëria ka vazhduar të tregojë angazhim të fortë për të kundërshtuar prodhimin dhe trafikimin e drogës. Raporti i KE rekomandon që në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet të miratojë një strategji të re dhe një plan veprimi mbi drogën, të plotësojë boshllëkun legjislativ për prekursorët e drogës dhe të intensifikojë luftën kundër trafikut të drogës.<sup>50</sup> Më poshtë (Grafiku 6) tregon sasi të e lëndëve narkotike të sekuestruara gjatë viteve 2015-2019 në Shqipëri. Pavarësisht nga shumtë e sekuestruara, duke marrë parasysh kultivimin e përhapur të kanabisit dhe trafikimin e drogës në Shqipëri të treguar në raportet ndërkombëtare, performanca e institucioneve shtetërore në këtë drejtim është e dobët.




Tabela 6: Konfiskimet vjetore të drogës (ekuivalentët në kg) në Shqipëri 2015 - 2018. Burimi: Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin. Të dhënat për vitin 2019 janë marrë nga CSDG Shqipëria

Minimizimi i korrupsionit dhe renditja e Shqipërisë në vendet që luftojnë korrupsionin në mënyrë efektive është një tjetër tregues i strategjisë kombëtare, dhe gjithashtu i theksuar nga raportet ndërkombëtare. Situata e korrupsionit në Shqipëri është përkeqësuar nga viti 2016 deri në vitin 2019 (Shih Grafikon 7), prandaj, ISCOG 2013-2020 nuk ka arritur rezultatin e parashikuar në këtë tregues.

48 Reitano dhe Amerhauser, 2020. Rrjedhat e Paligjshme Financiare në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Nisma Globale. Gjenevë. faqe 52.


49 Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara: Byroja për Narkotikët Ndërkombëtarë dhe Çështjet e Ruajtjes së Ligjit, 2020. Raporti Ndërkombëtar i Strategjisë së Kontrollit të Narkotikëve, Vëllimi I. Kontrolli i Drogës dhe Kimikateve, Uashington DC: Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara: Byroja për Narkotikët Ndërkombëtarë dhe Çështjet e Ruajtjes së Ligjit.

50 Komisioni Evropian, 2020. DOKUMENTI PUNUES I STAFIT TË KOMISIONIT: Raporti Shqipëri 2020, Bruksel: Komisioni Evropian. Në dispozicion në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf)



Grafiku 7: Renditja dhe rezultati i Shqipërisë në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të TI

Garantimi i sigurisë dhe rendit në vend është një nga treguesit e brendshëm të strategjisë kombëtare. Pavarësisht nga kjo, perceptimi i sigurisë publike në vend ka rënë gjatë viteve nga 49% që ndihen të sigurt në vitin 2015 në vetëm 35% që ndihen të sigurt në vitin 2019 (Shih Grafikon 8). Nga njëra anë është shumë sfiduese për të matur këtë objektiv specifik përmes treguesve institucionalë pasi nuk ka pasur asnjë raport për të vlerësuar nivelin e sigurisë publike. Shumica e të dhënave të siguruar vijnë nga sondazhet e opinionëve të bëra nga OSHC-të që punojnë në terren. Ka pak prova të prekshme nga institucionet që tregojnë se sa është përmirësuar siguria dhe rendi publik gjatë viteve - që është një tjetër përkujtesë e nevojës për të zhvilluar strategji me objektiva të matshëm.



Grafiku 8: Të dhënat janë marrë nga Sondazhi i Opinionit i IDM Shqipëria. Në dispozicion në <https://idmalbania.org/trust-in-governance/>. Shumica e të anketuarve thanë se kriminaliteti (67%), çështjet shëndetësore (49%), padrejtësia (36%) dhe pasiguria e punësimit (36%) ishin shqetësime të përditshme.

Në një shënim të ngjashëm, numri i veprave penale të regjistruara është rritur gjithashtu gjatë viteve që nga viti 2015, duke mbështetur gjetjen e sondazheve të opinionit që tregojnë se publiku ndihet më pak i sigurt në vitin 2019 sesa 4 vjet më parë (Shih Grafikon 9).



Grafiku 9: Të dhënat janë marrë nga Instituti i Statistikave, 2020. Statistikat Vjetore të Krimin, Tiranë.

## Identifikimi i mangësive dhe sfidave kryesore

Ky raport ka identifikuar disa mangësi dhe sfida të përpjekjeve aktuale të shtetit për të luftuar KO.

Ka objektiva të përsëritura strategjike të ISCOC 2013-2020 me strategjitë e tjera përkatëse sektoriale kombëtare. Kjo ka shkaktuar mbivendosje dhe dyfishime që mund të jenë një barrë për institucionet zbatuese dhe që çojnë në humbje të burimeve.

Procesi i miratimit dhe implementimit të ISCOC-ve ka qenë i parregullt dhe jo konsistent. Treguesit në ISCOC 2013-2020 janë formuluar pa informacion bazë, me objektiva të ndërprera (e jo vjetore), pa dispozita për mbledhjen e të dhënave dhe pa dispozita për metodën e llogaritjes për matjen e rezultateve.

Shqipëria nuk ka publikuar një vlerësim kombëtar të kërcënimeve të KO dhe të rënda në vitet e fundit, gjë që është e nevojshme për të pasur një pasqyre të besueshme të kërcënimeve me të cilat përballet vendi dhe për të hartuar ndërhyrje për t'i adresuar ato.

Raportet e monitorimit dhe vlerësimit janë të rëndësishme sepse ato ofrojnë rekomandime për tejkalimin e ngarkesave dhe dyfishimeve të strategjisë dhe kontribuojnë në zbatim më të mirë. Sidoqoftë, nuk ka pasur raport shtetëror dhe as të pavarur mbi zbatimin e ISCOC 2013-2020 në Shqipëri deri në fund të vitit 2020.

GOK-të zakonisht tejkalojnë kufijtë shtetërorë dhe bashkëpunojnë ndërkombëtarisht, gjë që e bën luftën kundër KO sfida për shtete të ndryshme dhe bashkëpunimin e tyre të rëndësishëm. Megjithëse ka informacion të disponueshëm për bashkëpunimin e Shqipërisë me BE-në në këtë drejtim, pak informacion u gjet në lidhje me bashkëpunimin rajonal.

Pavarësisht nga përpjekjet e saj për të kapur dhe konfiskuar pronat e KO, Shqipëria mbetet e pasuksesshme në këtë drejtim sepse i) numrat dhe vlerat e disponueshme të pasurive të kapura dhe të konfiskuara nuk korrespondojnë me nivelin e kriminalitetit në vend, ii) mekanizmat e vendosur praktikisht kanë dështuar në misionin e tyre për të konfiskuar pasuritë, ndërsa kanë arritur vetëm t'i konfiskojnë ato përkohësisht, dhe iii) numri i zvogëluar i procedimeve penale kundër pastrimit të parave reflekton performancën e dobët të institucioneve shtetërore në këtë drejtim.

Megjithëse lufta kundër KO paraqet sfida të mëdha për Shqipërinë, si për shumë kombe të tjera në rajon, për shkak të burimeve të kufizuara, kapaciteteve joadekuata dhe madje mungesës së kuptimit dhe koordinimit në thellësi të kërcënimit. Si e tillë është e domosdoshme që Shqipëria të anojë për të maksimizuar përpjekjet e saj, për të shmangur humbjen e burimeve dhe për të zhvilluar një strategji të thjeshtë dhe të lehtë kundër KO. Në këtë drejtim, disa rekomandime specifike për institucionet shqiptare do të ishin:

Shqipëria duhet të publikojë vlerësimin e rrezikut kombëtar nga KO dhe i rëndë rregullisht duke miratuar metodologjinë e BE-së SOCTA. Kjo do të ndihmojë për të pasur një pasqyrë të besueshme të kërcënimeve me të cilat përballet dhe për të vendosur mbi masat operacionale për t'i adresuar ato dhe veçanërisht në hartimin e ISCOG-së së ardhshme.

Shqipëria duhet të shtojë më tej përpjekjet e saj për të luftuar pastrimin e parave dhe për të miratuar legjislacionin që shënjestron pasurinë e pajustificuar, sepse hetimet financiare nuk shoqërojnë sistematikisht procedimet penale që nga fillimi, dhe efektiviteti i tyre mbetet i kufizuar.

Shqipëria duhet të krijojë një zyrë të ngarkuar me identifikimin dhe gjurmimin e pasurive kriminale, në përputhje me acquis të BE-së.

Agjencitë shqiptare të zbatimit të ligjit duhet të përdorin në tërësi marrëveshjen operacionale me EUROPOL, duke përfshirë shkëmbimin më proaktiv dhe në kohë të informacionit përmes SIENA, dhe të përdorin më shumë ekipet e përbashkëta të hetimit për të kryer hetime me homologët e BE-së.

Duke pasur parasysh bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar të GOK-ve dhe peshën e tyre në BP, është e rëndësishme të forcohet bashkëpunimi rajonal kundër KO.

Shqipëria duhet të zhvillojë një mekanizëm monitorimi më efektiv për zbatimin e strategjive. Kjo do të sigurojë zvogëlimin e mbivendosjes dhe përmirësimin e vazhdueshëm të objektivave strategjike përmes vendimmarrjes së informuar.

Shqipëria duhet të rrisë shkëmbimin e informacionit midis institucioneve të drejtësisë penale për të luftuar në mënyrë efikase rrjetet e KO.

Institucionet shtetërore duhet të punojnë me shoqërinë civile për të pasuruar gjetjet e tyre dhe për të përmirësuar monitorimin përmes pasqyrës së jashtme të aktiviteteve shtetërore të lidhura me KO.

Të rriten kapacitetet teknike të personelit të sistemit të drejtësisë penale për të luftuar KO. Kjo përfshin trajnime të specializuara për prokurorë, gjyqtarë, zyrtarë policie dhe institucione të tjera të ndërlidhura.

## Scholarly and media articles

Albanian Helsinki Committee, 2020. [Online] Available at: <https://ahc.org.al/aponence-ligjore-per-aktin-normativ-me-fugine-e-ligjit-te-keshillit-te-ministrave-nr-1-dt-31-01-2020/>. [Accessed 26 November 2020].

Balkans in Europe Policy Advisory Group (BiEPAG) (2019). Strengthening the Rule of Law in the Western Balkans: Call for a Revolution against Particularism. Policy Study. Available at <http://biepag.eu/wp-content/uploads/2019/03/Strengthening-the-Rule-of-Law.pdf>.

Brakaj, 2020. Faktoje Albania. [Online] Available at: <https://faktoje.al/spak-rrezon-legjitimitetin-e-aktit-normativ-anti-kck/>. [Accessed 26 November 2020].

CSDG Albania, 2020. Baseline Assessment: Intersectoral Strategy on Countering Organized Crime 2013-2020, Tirana: Center for the Study of Democracy and Governance. Available at <http://csdgalbania.org/wp-content/uploads/2020/12/Baseline-assessment-Organized-Crime.pdf>.

Dyrmishi and Kamolli, 2018. The administrative approach in fighting organized crime: Exploring the possibility of implementation in Albania. CSDG Albania.

Euronews Albania, 2020 [Online] Available at <https://euronews.al/al/unpublished/2020/12/23/11-muaj-nga-krijimi-i-ofi-se-ende-as-nje-prone-e-konfiskuar>.

Reitano and Amerhauser, 2020. Illicit Financial Flows in Albania, Kosovo and North Macedonia. Global Initiative. Geneva.

Reporter.al, 2019. Available at <https://www.reporter.al/ngrihet-struktura-e-posacme-per-luften-kunder-korrupsionit-dhe-krimet-te-organizuar/>

## Official reports and documents

Albanian State Police, 2020. Annual report, Tirana. Available at: <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Policia-e-Shtetit-ANALIZA-VJETORE-2019.pdf>.

Enlargement Strategy and Main Challenges 2013-2014. [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2013/package\\_strategy\\_paper\\_2013\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2013/package_strategy_paper_2013_en.pdf). Accessed on January 1, 2021.

European Commission, 2020. COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT: Albania 2020 Report, Brussels: European Commission. Available at: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf)

Frontex, 2019, "Frontex launches first operation in Western Balkans." Available at: <https://frontex.europa.eu/media-centre/news/news-release/frontex-launches-first-operation-in-western-balkans-znTNWM>

General Prosecutor Office, 2020. Report of the General Prosecutor on Crime Situation for 2019, Tirana: General Prosecutor Office.

National Plan for European Integration 2020-2022. Center for Official Publications. Available at: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/02/19/151>.

United Nations Office on Drugs and Crime (UNODC), 2020. Measuring Organized Crime in the Western Balkans (Vienna).

United States Department of State: Bureau for International Narcotics and Law Enforcement Affairs, 2020. International Narcotics Control Strategy Report, Volume I. Drug and Chemical Control, Washington D.C.

## Legal sources and official websites

Council of the European Union decision on the fight against organized crime. Available at <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32008F0841&from=EN>.

Decision of the Council of Ministers 1140/2008 "Intersectoral Strategy on Combating Organized Crime, Trafficking and Terrorism 2008-2013"

Decision of the Council of Ministers 115/2016. On the approval of the Action Plan on Socio-Economic Re-Integration of Potential Women and Girls, Victims of Trafficking.

Decision of the Council of Ministers 248/2017. On the approval of the Action Plan against Cannabis Cultivation and Trafficking 2017–2020.

Decision of the Council of Ministers 616/2019. Adopting the action plan for 2019–2020, implementing the Cross-cutting Strategy on Combating Organized Crime, Illegal Trafficking and Terrorism 2013–2020)

Decision of the Council of Ministers 663/2013. On the adoption of the Intersectoral Strategy for Combating Organized Crime, Illicit Trafficking and Terrorism 2013-2020 and the Action Plan 2013-2016

Decision of the Council of Ministers 973/2015. Available at <https://cesk.gov.al/wp-content/uploads/2016/04/Dokumenti%20i%20Politikave%20per%20Sigurine%20Kibernetike%202015-2017.pdf>

Decision of the Council of Ministers, 2020. Preventive Measures in the framework of Strengthening the Fight against Terrorism, Organized Crime, Serious Crimes and Consolidation of Public Security.

Eurojust, 2020. European Union Agency for Criminal Justice Cooperation. [Online] Available at: <https://www.eurojust.europa.eu/major-albanian-italian-drug-trafficking-network-dismantled>. [Accessed 17 November 2020].

General Prosecutor Office, 2020. "The Liaison Prosecutor of Albania at Eurojust is commanded." Available at [http://www.pp.gov.al/web/Komandohet\\_Prokurori\\_nderlidhes\\_i\\_Shqiperise\\_prane\\_Eurojust\\_1518\\_1.php#.X\\_bpR9hKiU](http://www.pp.gov.al/web/Komandohet_Prokurori_nderlidhes_i_Shqiperise_prane_Eurojust_1518_1.php#.X_bpR9hKiU)

Law 192/2009 “On preventing and countering organized crime and trafficking through preventive measures against property.” Available at [http://www.pp.gov.al/web/ligj\\_per\\_parandalimin\\_dhe\\_goditjen\\_e\\_krimet\\_te\\_organizuar\\_dhe\\_trafikimit\\_nepermjet\\_masave\\_parandaluese\\_kunder\\_411.pdf](http://www.pp.gov.al/web/ligj_per_parandalimin_dhe_goditjen_e_krimet_te_organizuar_dhe_trafikimit_nepermjet_masave_parandaluese_kunder_411.pdf)

Law 60/2016 “Whistleblowing and Whistleblower Protection”

Law 7895 on Criminal Code of the Republic of Albania, amended by law 36/2017 and law 89/2017

Law 8733/2001 and Law 9086/2003

Law 8920/2002. On the ratification of the “United Nations Convention against International Organized Crime” and its two additional protocols.

Law 9205/2004 on Justice Collaborators and Witness Protection amended in 2009 by law 10173/2009 “On Justice Collaborators and Witness Protection”

Law 95/2016 “On the organization and functioning of the institutions for countering organized crime and corruption.” Available at [https://klp.al/wp-content/uploads/2020/02/lligj\\_nr\\_95\\_2016\\_per\\_organizimin\\_dhe\\_funksionimin\\_e\\_institucioneve\\_per\\_te\\_luftuar\\_korrupsionin\\_dhe\\_krimin\\_e\\_organizuar\\_s\\_1728.pdf](https://klp.al/wp-content/uploads/2020/02/lligj_nr_95_2016_per_organizimin_dhe_funksionimin_e_institucioneve_per_te_luftuar_korrupsionin_dhe_krimin_e_organizuar_s_1728.pdf)

Ministry for Europe and Foreign Affairs, National Plan for European Integration 2018-2020, pp. 168-170. Available at <https://punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/vkm-nr-246-date-9-5-2018-2-plani-kombetar-per-integrimin-evropian-2018-2020.pdf>

National Assembly of the Republic of Albania, 2020. On the Approval of the Normative Act, Law 1/2020 of the CoM “On Preventive Measures in the framework of Strengthening the Fight against Terrorism, Organized Crime, Serious Crimes and Consolidation of Public Security.


National Strategy against Drugs 2004-2010. Decision of the Council of the Ministers 292/2004

National Strategy for Combating Trafficking in Human Beings 2008-2010

National Strategy for the Fight against Child Trafficking and the Protection of Child Victims of Trafficking 2008-2010.

# Bosnja dhe Hercegovina

Autorë: **Benjamin Plevljak, Imer Dulaš**





## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qëllimi i këtij studimi empirik është të analizojë përpjekjet aktuale dhe ndikimin e qeverisë së Bosnjës dhe Hercegovinës në trajtimin e krimit të organizuar, identifikimin e qasjeve të suksesshme dhe ekzaminimin e sfidave. Përveç kësaj, qëllimi është të krijojë dhe propozojë rekomandime për të forcuar, mbështetur dhe promovuar praktikën e mira në trajtimin e krimit të organizuar si dhe identifikimin e mangësive dhe sfidave në trajtimin e krimit të organizuar.

Metoda e analizës cilësore të përmbajtjes së dokumenteve u përdor për të analizuar kornizën ligjore kombëtare, planet e veprimit dhe dokumente të tjera strategjike në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar, si dhe për të shqyrtuar historikun e dënimeve. Dokumentet në lidhje me bashkëpunimin rajonal dhe evropian ishin gjithashtu në fushëveprimin e hulumtimit. Intervistat gjysmë të strukturuar u zhvilluan me 5 përfaqësues të sistemit të drejtësisë penale në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Bosnja dhe Hercegovina bashkëpunon si me BE-në ashtu edhe me qeveritë në Ballkanin Perëndimor. Marrëveshja Strategjike për Bashkëpunim ndërmjet Këshillit të Ministrave të BeH dhe Zyrës Evropiane të Policisë (EUROPOL) është një shembull i bashkëpunimit në nivelin ndërkombëtar, ndërsa bashkëpunimi në nivelin rajonal më së shpeshti arrihet përmes hetimeve të përbashkëta nga agjencitë policore, si dhe përmes Konventave të nënshkruara siç është Konventa e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore.

Të dhënat e aktgjyqimeve dhe dokumentet e tjera historike të Gjykatës së Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Prokurorisë së Bosnjës dhe Hercegovinës gjithashtu u morën parasysht dhe ato paraqesin efektivitetin e institucioneve të përmendura më lart.

Duke pasur parasysht situatën e përgjithshme në lidhje me pandeminë e koronavirusit, disa prej intervistave duhej të kryheshin përmes një platforme komunikimi në internet. Në aspekte të tjera të hulumtimit, nuk kishte asnjë kufizim të hulumtimit.

Kjo analizë do të shërbejë për të fituar njohuri për punën e institucioneve shtetërore që merren me luftën kundër krimit të organizuar, si dhe statusin e bashkëpunimit rajonal dhe bashkëpunimit me BE-në. Njohuritë do të fitohen përmes intervistimit të përfaqësuesve të sistemit të drejtësisë penale, duke kryer analiza të dokumenteve strategjike kombëtare, raporteve dhe dokumenteve të historikut.

Krimi i organizuar është një nga format më të theksuara të rrezikimit të sigurisë së pothuajse çdo vendi. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, ekziston një numër jashtëzakonisht i madh i aktiviteteve të krimit të organizuar, por ato më dominuese janë trafikimi i drogës, pastrimi i parave, trafikimi i qenieve njerëzore dhe forma të tjera të krimit të organizuar.<sup>1</sup>

Duke marrë parasysh dokumentet e Bashkimit Evropian në lidhje me situatën në krimin e organizuar dhe korrupsionin në BeH, mund të konkludohet se këto fenomene janë vazhdimisht më mbizotëruese në shoqërinë e BeH. Në dokumentet e tyre lidhur me BeH për tri vitet e fundit, ata deklarojnë se korrupsioni është ende shumë i pranishëm,<sup>2</sup> ndërsa përpjekjet kundër krimit të organizuar kërkojnë përmirësim në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve. Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, kontrabandimit të migrantëve, trafikimit të armëve të zjarrit dhe terrorizmit kërkon përshtetshmëri më efikas të kompetencave dhe pushteteve.<sup>3</sup> Bosnja dhe Hercegovina është në një fazë të hershme / në një nivel të caktuar të gatishmërisë në parandalimin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ata gjithashtu deklarojnë se nuk ka pasur progres në zbatimin e prioriteteve kryesore të Opinionit të Komisionit për Aplikimin e Bosnjës dhe Hercegovinës për anëtarësim në Bashkimin Evropian 2019, të rekomandimeve të vitit 2019 në këtë fushë dhe gjetjeve të Raportit të Ekspertëve mbi Sundimin e Ligjit në BeH.<sup>4</sup>

Bashkëpunimi rajonal, si dhe bashkëpunimi me Bashkimin Evropian, është faktor kyç në luftën kundër krimit të organizuar. *Krimi i organizuar si fenomen shpesh nuk njej kufij, kështu që vetëm një shtet shpesh nuk është në gjendje të merret me të.* Pjesëtarët e grupeve të organizuara kriminale rrallë janë nga një shtet, zakonisht ky bashkëpunim është rajonal në mënyrë që të mbulojë sa më shumë hapësirë territoriale dhe për pasojë të rrisë fitimin e organizatës. Është e qartë se bashkëpunimi midis qeverive ekziston, ekzistojnë mekanizma rajonale bashkëpunimi dhe bashkëpunimi me dokumentet e nënshkruara nga BE të tilla si Marrëveshja Strategjike për Bashkëpunim midis Këshillit të Ministrave të BeH dhe Zyrës Evropiane të Policisë (EUROPOL), urdhër-arresteve ndërkombëtare dhe dokumenteve të bashkëpunimit rajonal siç është Konventa e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore.

Ndërsa raporti vazhdon, fokusi do të jetë në analizën e kornizave ligjore dhe strategjive dhe dokumenteve të tjera në lidhje me luftën dhe bashkëpunimin në luftën kundër krimit të organizuar, në kapacitetet e njohurive të sistemit të drejtësisë penale dhe në qeveritë dhe praktikën dhe sfidat e tyre. Do të konsiderohet shkëmbimi i njohurive rajonale dhe në nivelin e BE-së si dhe historiku i qeverisë së Bosnjës dhe Hercegovinës në ndjekjen penale të krimit të organizuar dhe dënimet e tij përfundimtare. Në fund, do të identifikohen dhe prezantohen mangësitë, si dhe rekomandimet në lidhje me bashkëpunimin në nivelin kombëtar dhe rajonal.

1 Qendra për Studime të Sigurisë Sarajevë, Studim mbi Krimin e Organizuar në Bosnjë dhe Hercegovinë, Sarajevë 2014

2 Raporti i Komisionit Evropian, Bosnjë dhe Hercegovinë 2020

3 Opinion i Komisionit për Aplikimin e Bosnjës dhe Hercegovinës për anëtarësim në Bashkimin Evropian 2019.

4 Raporti i Komisionit Evropian, Bosnjë dhe Hercegovinë 2020.

## Analiza e kornizës ligjore dhe strategjike

Në nivelin e Bosnjës dhe Hercegovinës, ndër të tjera, brenda Ministrisë së Sigurisë të Bosnjës dhe Hercegovinës, ekziston Agjencia Shtetërore e Hetimit dhe Mbrojtjes (SIPA) dhe Policia Kufitare e BeH (PK BeH), të cilat merren me punën operacionale në luftimin e krimit të organizuar, si dhe Gjykata dhe Prokuroritë e Bosnjës dhe Hercegovinës. Gjithashtu brenda Ministrisë së Sigurimit të BeH, Shërbimi për Çështjet e të Huajve si një organizatë administrative është përfshirë gjithashtu në luftën kundër krimit të organizuar. Agjencia e Inteligjencës-Sigurisë e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Autoriteti i Tatimeve Indirekte gjithashtu kanë një rol të rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar.

Lidhur me nivelet e entiteteve, ka edhe institucione të tilla si Ministria Federale e Punëve të Brendshme (MFPB), Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës Serbe (MPB RS) dhe Policia e Qarkut Brçko. Ekzistojnë gjithashtu prokurori të çarkut / themelore dhe kantonale / komunale, ndërsa brenda Qarkut Brçko të BeH ekziston Prokuroria e Qarkut Brçko të BeH.

Në Bosnjë dhe Hercegovinë, ekzistojnë katër ligje penale, si dhe katër Kode të Procedurës Penale. Ato janë krijuar në nivelin e Bosnjës dhe Hercegovinës,<sup>5</sup> në nivelin e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës,<sup>6</sup> në nivelin e Republikës Serbe<sup>7</sup> dhe në nivelin e Qarkut Brçko.<sup>8</sup> Këto ligje përfshijnë rregullime ligjore dhe mekanizma për luftimin e të gjitha formave të krimit, ku ndoshta më të rëndësishmet në luftën kundër krimit të organizuar janë veprimet speciale hetimore të rregulluara në Kodet e Procedurave Penale të lartpërmendura.<sup>9</sup>

Përveç Kodeve Penale, një qasje aktive ndaj kësaj çështje është zhvillimi i Vlerësimit të Kërcënimit nga Krimi i Organizuar, Strategjive dhe Planeve të Veprimit për Luftën kundër Krimit të Organizuar në Bosnjë dhe Hercegovinë<sup>10</sup> si dhe Strategjive dhe Planeve të Veprimit për Luftën kundër Korrupsionit.<sup>11</sup>

Këshilli i Ministrave i Bosnjës dhe Hercegovinës ka miratuar katër Strategji për Luftën kundër Krimit të Organizuar, por ekziston edhe Strategjia për Luftën kundër Korrupsionit e BeH e cila është nxjerrë nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit dhe Koordinimin e Luftës kundër Korrupsionit.

Gjykata e Bosnjë dhe Hercegovinës nxjerrë gjithashtu një dokument strategjik të quajtur plani afatmesëm i Gjykatës së BeH, i cili përfshin një plan dy-vjeçar. Plani më i fundit afatmesëm i Gjykatës së BeH mbulon vitet nga 2019 deri në 2021. Gjithashtu, Gjykata e BeH nxjerrë Planin Kundër Korrupsionit, ku i fundit është Plani Kundër Korrupsionit për periudhën 2018-2019.

---

5 Kodi Penal i Bosnjës dhe Hercegovinës.

6 Kodi Penal i Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës.

7 Kodi Penal i Republikës Serbe.

8 Kodi Penal i Qarkut Brçko të Bosnjës dhe Hercegovinës.

9 Kodi i Procedurës Penale të Bosnjës dhe Hercegovinës.

10 Strategjia për Luftën kundër Krimit të Organizuar në Bosnjë dhe Hercegovinë për periudhën 2017-2020. f. 3

11 Strategjia për Luftën kundër Korrupsionit në Bosnjë dhe Hercegovinë (2015-2019)

Duke analizuar Strategjinë për Luftën kundër Krimin të Organizuar në BeH, midis parimeve të tjera, ato më të rëndësishmet janë “parimi i vullnetit politik”, i cili nënkupton që një luftë aktive kundër krimin të organizuar është një aktivitet me prioritet i institucioneve në Bosnjë dhe Hercegovinë gjithashtu si “parimi i ligjshmërisë” që nënkupton respektimin e Kushtetutës dhe ligjeve të brendshme, si dhe dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare (instrumente juridike ndërkombëtare), për të cilat Bosnja dhe Hercegovina është nënshkruese. Lidhur me bashkëpunimin rajonal dhe të nivelit të BE-së, “parimi i bashkëpunimit ndërkombëtar proaktiv dhe sigurimi i rolit aktiv të Bosnjës dhe Hercegovinës në nivelin ndërkombëtar” është parimi që nënkupton angazhimin e BeH për të marrë pjesë në luftën kundër krimin të organizuar si në nivelin rajonal ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Duke marrë parasysh kornizën ligjore strategjike dhe politike në nivel kombëtar, përfaqësuesit e institucioneve të së drejtës penale dhanë mendime nëse ata vërtet po punojnë dhe nëse duhen përmirësuar dhe dhanë pikëpamjen e tyre mbi nivelin e bashkëpunimit si në nivelin kombëtar ashtu edhe në atë rajonal. Shumica e përfaqësuesve besojnë se korniza ligjore ekzistuese është e mirë, por ka gjithmonë hapësirë për ta bërë luftën kundër krimin të organizuar më efektive, ku ajo mund të përmirësohet përmes zbatimit të plotë të ligjit dhe zbatimit të normave tashmë ekzistuese.

Një nga përfaqësuesit beson se strategjitë nuk janë absolutisht të nevojshme nëse kemi profesionistë që e bëjnë punën e tyre në mënyrën e duhur, dhe sidomos nëse ata punojnë për drejtësi dhe e zbatojnë Ligjin.

Lidhur me policinë, ata zbatojnë rregullore ligjore pozitive që janë miratuar në nivelin shtetëror dhe të entiteteve, të cilat harmonizohen me rekomandimet dhe standardet ndërkombëtare, si dhe dispozitat e dokumenteve të pranuar ndërkombëtare.

Kur kemi parasysh vlerësimin e politikës aktuale në luftën kundër krimin të organizuar dhe efektivitetin e saj në drejtim të të dhënave të ndjekjes penale, dënimit dhe mbështetjes ndaj viktimave, përfaqësuesit e institucioneve të caktuara përfshihen në zhvillimin institucional të një dokumenti që përcakton rreziqet e kësaj forme të krimin dhe që dallon prioritetet që do të shkaktonin efekte të mundshme anësore.

Përveç këtyre strategjive dhe në lidhje me bashkëpunimin rajonal, Konventa e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore është një dokument shumë i rëndësishëm që tregon bashkëpunimin rajonal. Kjo Konventë lindi nga dëshira për të çuar përpara interesat e përbashkëta të sigurisë së Shqipërisë, Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Maqedonisë Veriore, Moldavisë, Rumanisë dhe Malit të Zi.<sup>12</sup>

Vlerësimi i Kërcënimit të Krimin të Organizuar (OCTA) është një vlerësim që shtjellon kërcënimet e paraqitura nga krimi i organizuar dhe u jep përparësi atyre që parashikohet të shkaktojnë dëmin më të madh (ndikimi i drejtpërdrejtë negativ në buxhet), i cili është gjithashtu baza për zhvillimin e dokumenteve strategjike në këtë fushë dhe ofron udhëzime për të gjitha organet përkatëse në luftën kundër kësaj forme të krimin.

Nevoja për një dokument të tillë, i cili sigurisht është i orientuar drejt së ardhmes, lind nga analiza e vlerësimit të kërcënimit të krimin të rëndë dhe të organizuar në Bashkimin Evropian (BE SOCTA), e cila u bë nga EUROPOL dhe tregoi se grupet e krimin të organizuar, në zona të caktuara, përbëjnë kërcënim serioz për sigurinë e Bashkimit Evropian dhe vendeve anëtare të tij.<sup>13</sup>

12 Konventa e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore

13 Vlerësimi i Kërcënimit të Krimin të Organizuar në Bosnjë dhe Hercegovinë, 2016, f. 2

Miratimi i OCTA është i një rëndësie më të gjerë për të gjithë qytetarët e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe është hap i rëndësishëm në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, por gjithashtu angazhim i qartë i institucioneve në Bosnjë dhe Hercegovinë për të kontribuar në luftën kundër problemit të dukshëm global.

Gjatë vitit 2007, Marrëveshja Strategjike për Bashkëpunim midis Këshillit të Ministrave të BeH dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPOL) u nënshkrua dhe ratifikua midis EUROPOL dhe Bosnjës dhe Hercegovinës, e cila parashikon shkëmbimin e informacionit ekskluzivisht jo-operacional. Marrëveshja për Bashkëpunimin Operacional dhe Strategjik midis BeH dhe EUROPOL (Marrëveshja Operative) u nënshkrua më 31 gusht 2016 dhe hyri në fuqi në mars 2017. Sidoqoftë, përkundër kësaj, Marrëveshja Operative nuk është zbatuar plotësisht sepse Pika e Përbashkët e Kontaktit për BeH (PPK) e parashikuar në Marrëveshje nuk është krijuar.<sup>14</sup>

## Bashkëpunimi në nivel rajonal dhe të BE-së dhe shkëmbimi i njohurive

Bashkëpunimi rajonal është një segment i rëndësishëm në përmirësimin e marrëdhënieve midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, si dhe përgjigjes së përbashkët ndaj sfidave me të cilat përballet rajoni. Pas viteve 1990, iniciativa të ndryshme u nisën për të përmirësuar bashkëpunimin e këtyre vendeve dhe për të sjellë përfitime në aspektin socio-ekonomik, dhe në rastin e këtij studimi, në aspektin e sigurisë. Disa nga këto strategji, iniciativa dhe marrëveshje janë Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Procesi i Berlinit, SEE2020, etj.

Strategjia e Evropës Juglindore 2020 thotë se “Objektivat dhe masat e politikës të parashikuara nga Strategjia duhet të kontribuojnë në krijimin e rreth një milion vendeve të reja të punës gjatë dekadës aktuale. Duke bashkuar forcat në arritjen e qëllimeve të përbashkëta dhe të bashkuara nga vlerat e përbashkëta Evropiane, Evropa Juglindore do të ketë sukses”,<sup>15</sup> gjë që tregon gatishmërinë dhe përkushtimin për të përmirësuar situatën e përgjithshme në Ballkanin Perëndimor. Në vijim, do të paraqiten mënyrat dhe mekanizmat e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në lidhje me sektorin e sigurisë në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Lidhur me bashkëpunimin e institucioneve në nivelin rajonal dhe/ose të BE-së dhe përmes të cilave platforma/organe zhvillohet ky bashkëpunim, përfaqësuesit deklaruan se ky bashkëpunim ekziston në forma të ndryshme. Lidhur me Gjykatën e Bosnjës dhe Hercegovinës, ata marrin pjesë në shumë konferenca, takime ekspertësh, iniciativa dhe çdo formë tjetër të rrjeteve profesionale, të gjitha me qëllim të përparimit, miratimit të praktikave të mira dhe zgjidhjeve të mira, dhe përfaqësuesi i tyre deklaroi se kjo ka pasur një ndikim në zbatimin e rekomandimeve të mira të konventës në ligjin e BeH.

<sup>14</sup> Strategjia për Luftën kundër Krimin të Organizuar në Bosnjë dhe Hercegovinë (2017-2020), f. 19

<sup>15</sup> Strategjia e Evropës Juglindore 2020 (SEE2020), Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, f. 6

Gjykata e Bosnjës dhe Hercegovinës është gjithashtu anëtare e Rrjetit Evropian të Gjykatave Supreme për Shkëmbimin e Praktikave Gjyqësore në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, dhe ata marrin pjesë në projekte të ndryshme dhe botojnë praktikatat e tyre përmes një buletini vjetor.

Njëri nga përfaqësuesit veçoi Programin e Shkëmbimit të Praktikës së Mirë, i cili u zhvillua në bashkëpunim me USAID përmes Rrjetit të Praktikës së Mirë, Projektit Drejtësia Kundër Korrupsionit, që synonte kryesisht shkëmbimin e praktikave dhe materialeve të ekspertëve në fushën e korrupsionit, krimit ekonomik dhe krimit të organizuar, midis prokurorëve partnerë nga e gjithë Bosnja dhe Hercegovina.

Në lidhje me bashkëpunimin e Administratës Federale të Policisë me organet e Policisë Evropiane dhe Rajonale, ai realizohet çdo ditë me Zyrat Qendrore Kombëtare të INTERPOL, EUROPOL, SELEC, atashetë e policisë dhe oficerët e ndërlidhjes.

Përveç sa më sipër, ekziston një platformë për shkëmbimin e informacionit e krijuar brenda Drejtorisë për Koordinimin e Organeve Policore të BeH, Sektori për Bashkëpunim Operacional Ndërkombëtar Policor, Departamenti i NCB Interpol Sarajevë.

Ekziston gjithashtu një kornizë e veçantë për bashkëpunimin rajonal të siguruar nga Konventa për Bashkëpunimin Policor në Evropën Juglindore, e cila përveç përcaktimit të shkëmbimit të informacionit dhe të dhënave, siguron mundësinë e bashkëpunimit përmes formimit të ekipeve të përbashkëta të hetimit të vendeve nënshkruese.

Ata gjithashtu marrin pjesë në programe përmes projekteve të organizuara brenda fondeve IPA, TAIEX, OSBE, iPROCEEDS, trajnime të organizuara nga Qendra për Edukimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të FBeH, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial të BeH, Ministrisë së Sigurimit të BeH etj.

Lidhur me bashkëpunimin me aktorë joqeveritarë, angazhimi për bashkëpunim në luftën kundër krimit të organizuar me aktorë jo-shtetërorë shprehet gjithashtu në parimet për hartimin dhe zbatimin e Strategjisë për Luftën kundër Krimit të Organizuar në BeH, Strategjisë për Luftën kundër Korrupsionit dhe dokumenteve të tjera strategjike, që parashikojnë qartë konceptin e bashkëpunimit midis sektorit publik dhe privat, shoqërisë civile dhe qytetarëve. Përfaqësuesit e institucioneve të së drejtës penale thanë se ata ofrojnë mbështetje dhe inkurajim për gazetari hulumtuese profesionale, të pavarur dhe të paanshme, organizata të shoqërisë civile njohuritë e disponueshme të të cilave do të çonin në identifikimin e kërcënimeve reale që lindin nga krimi i organizuar ose tregojnë për gjurmët dhe kryesit e krimit të organizuar.

Jo të gjithë pjesëmarrësit kishin mendime të njëjta në lidhje me OSHC-të, pasi një nga përfaqësuesit beson se organizatat e shoqërisë civile, me përjashtim të disa prej tyre, kanë një shtrirje të kufizuar, sepse financimi i tyre duket se varet kryesisht nga ata, punën e të cilëve duhet të monitorojnë.

## Historiku i përpjekjeve kundër KO të qeverive të BP6

Kur merren në konsideratë dokumentet e përdorura për të mbledhur informacione historike, çdo vit, Prokuroria e Bosnjës dhe Hercegovinës boton një Informacion mbi punën e saj, në të cilin mund të gjendet një pjesë e veçantë në lidhje me krimet e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Vitet 2017 dhe 2018 janë marrë parasysh. Raporti i tyre i punës për vitin 2019 nuk është ende i disponueshëm. Dokumentet dhe raportet nga Gjykata e BeH për vitet 2018 dhe 2019 u miratuan si dhe Raporti Vjetor i vitit 2018 i Agjencisë Shtetërore të Hetimit dhe Mbrojtjes së BeH.

Së pari, do të përqendrohemi në rezultatet e punës së Prokurorisë së Bosnjës dhe Hercegovinës në vitet 2017 dhe 2018, më saktësisht Departamentit të saj nr. 2 (Departamenti Special për Krimin e Organizuar, Krimin Financiar dhe Korrupsionin).

Në vitet 2017 dhe 2018, Prokurorët e Departamentit II ngritën gjithsej 203 aktakuza kundër 416 personave. Në rastet e trajtuara në Departamentin II, Gjykata e BeH vendosi burgim për një kohëzgjatje totale prej 231 vjet e 8 muaj.

	<b>Aktakuzat</b>	<b>Individët</b>	<b>Kohëzgjatja e dënimit me burg</b>
<b>2017</b>	96	210	136 vjet + 8 muaj
<b>2018</b>	107	206	95 vjet

*Tabela 1: Prokuroria e Bosnjës dhe Hercegovinës*

Sipas Informacionit të Punës së Prokurorisë, në vitin 2017 shuma totale prej: 5,089,244.80 KM, 120,900.00 €, 800.00 HRK dhe 446.00 USD, si dhe një numër i madh i pasurive të patundshme, automjete dhe sende të tjera të luajtshme, janë konfiskuar.<sup>16</sup> Ndërsa në vitin 2018, shuma totale e konfiskuar e pasurisë së përfituar në mënyrë të paligjshme ishte 4,042,383.62 KM.<sup>17</sup>

Mund të vërehet se numri i aktakuzave të Departamentit II të Prokurorisë së Bosnjë dhe Hercegovinës po rritet çdo vit, por është interesante që numri i viteve për të cilët u dënuan kryesit e veprave po zvogëlohet.

Lidhur me punën e Gjykatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, më saktësisht Departamentit II, i cili merret mes të tjerash me raste të krimit të organizuar, nga viti 2018 deri në vitin 2019, Gjykata nxori një total prej 262 vendimesh të shkallës së parë, me një total prej 251 rastesh të përfunduara. Kur kemi parasysh Divizionin e Apelit të Departamentit 2, kishte gjithsej 44 aktgjykime të apelit, ndërsa kishte gjithsej 4 vendime të shkallës së tretë.<sup>18</sup>

<sup>16</sup> Raporti i Prokurorisë për vitin (2017) f. 29


<sup>17</sup> Informacioni për Punën e Prokurorisë (2018) f. 27

<sup>18</sup> Gjykata e Bosnjës dhe Hercegovinës, Departamenti për Administratën Gjyqësore të Gjykatës së BeH, prezantimi në powerpoint.

	Vendimet e shkallës së parë	Rastet e përfunduara	Aktgjykimet e Apelit	Vendimet e shkallës së tretë
<b>2018</b>	127	126	26	1
<b>2019</b>	135	125	18	3

*Tabela 2: Gjykata e Bosnjës dhe Hercegovinës*

Sa i përket Agjencisë Shtetërore të Hetimit dhe Mbrojtjes, në vitin 2018, rastet në lidhje me krimin e organizuar kanë të bëjnë me subjektet e trafikut të drogës, trafikimit të qenieve njerëzore, trafikimit të armëve dhe pastrimit të parave.



*Tabela 1 : Rastet që lidhen me krimin e organizuar në vitin 2018<sup>19</sup>*

Duke analizuar të dhënat, mund të konkludohet se nga të gjitha çështjet që ishin trajtuar në lidhje me krimin e organizuar, një total prej rreth 20% ishte përfunduar. Shumica e rasteve kanë përfunduar në lidhje me veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore (30%), ndërsa rastet më të pakta janë përfunduar kur bëhet fjalë për pastrim të parave (2%).

Hetimet e veprave penale të pastrimit të parave vërtetuan se 59,419,391,28 KM të parave të marra në mënyrë të paligjshme u futën në rrjedhën e parave të ligjshme përmes sistemit financiar të Bosnjës dhe Hercegovinës, ndërsa dëmi material i shkaktuar nga veprat penale të raportuara arriti në 56,791,027.20 KM.<sup>20</sup>

Është e rëndësishme të theksohet se bashkëpunimi ndërkombëtar është arritur në një total prej shtatë rasteve në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore, shtatë raste në lidhje me krimin e organizuar dhe 18 raste në lidhje me trafikimin e drogës. Nga veprimet në të cilat bashkëpunimi ndërkombëtar kontribuoi në realizim, mund të veçojmë “CD1/13 Oqeanet”, “Trashëgimtari”, “Damari”, “Albatrosi” dhe “Tymi”. Gjithashtu, një segment i rëndësishëm në luftimin e veprimtarive kriminale është bashkëpunimi midis agjencive brenda Bosnjës dhe Hercegovinës, i cili ka rezultuar efektiv në disa raste dhe veprime të zgjidhura.

<sup>19</sup> Raporti Vjetor i Agjencisë Shtetërore të Hetimit dhe Mbrojtjes për vitin 2018

<sup>20</sup> Raporti Vjetor i Agjencisë Shtetërore të Hetimit dhe Mbrojtjes për vitin 2018, f. 6



## Identifikimi i mangësive dhe sfidave kryesore

Mund të vërehet se një pjesë e mirë e publikut ka një perceptim se gjyqësori drejtohet nga politika dhe kjo duhet të ndryshohet. Besimi i shoqërisë është shkelur, që do të thotë se qytetarët nuk janë të gatshëm të raportojnë krimet si dhe të dëshmojnë. Gjithashtu, qytetarët dekurajohen nga fakti që proceset gjyqësore ndonjëherë mund të zgjasin me vite, duke humbur kështu vullnetin dhe dëshirën për të ngritur padi. Për shembull, sipas një studimi të bërë në vitin 2017,<sup>21</sup> qytetarët kanë më pak besim në prokurori dhe gjyqësor.

Politika e luftës kundër krimit të organizuar duhet të mbështetet në nivelin e saj institucional për të vepruar në mënyrë më progresive, për të ndjekur penalisht kryesit e krimeve në mënyrë më efikase dhe për të forcuar politikën penale, veçanërisht për autorët e krimeve në fushën e korrupsionit. Është e nevojshme që shteti të bëjë një angazhim strategjik për të luftuar në mënyrë efektive krimin e organizuar, i cili duhet të shoqërohet me aktivitete konkrete legjislative dhe aktivitete të degës ekzekutive.

Një i intervistuar e konsideron kornizën aktuale ligjore, strategjike dhe politike në nivelin e Bosnjës dhe Hercegovinës si absolutisht të papërshtatshme, kryesisht si rezultat të strukturës ekzistuese kushtetuese të shteteve, e cila po dëshmohet katastrofike në luftën kundër krimit të organizuar. Ekzistenca paralele e 4 sistemeve të drejtësisë penale, praktika e pabarabartë si në zbatimin e ligjit material dhe procedural, mungesa e veprimit të harmonizuar në fushën e ndërhyrjeve legjislative (ndryshimet në ligj), kanë çuar në një nivel shqetësues të pasigurisë ligjore për qytetarët e BeH. Ekzistonte gjithashtu një mendim se është e nevojshme të theksohet se sukseset e regjistruara në ndjekjen penale të kryesve të caktuar të këtij lloji të krimit janë kryesisht rezultat i entuziazmit dhe angazhimit individual të prokurorëve dhe zyrtarëve të policisë, dhe pothuajse kurrë të sistemit.

Ka raste kur ligjet duhet të harmonizohen në nivelin e entitetit. Një nga përfaqësuesit vërejt se Ligji i Federatës së BeH për Kundërvajtjet është plot me mangësi në lidhje me një ligj të tillë në Republikën Serbe dhe vendet e rajonit, gjë që rezulton në praktikë të pabarabartë gjyqësore dhe situata ku sjellje dhe veprime të caktuara në një entitet janë kundërvajtje ndërsa në tjetrin nuk janë.

Dy nga të anketuarit vunë re se ka mungesë të kompetencës dhe arsimimit të pjesëmarrësve në sistemin e drejtësisë penale. Një prej të anketuarve deklaroi se hendek në sistemin e së drejtës penale është gjithashtu pamundësia e palës së dëmtuar për të ndikuar në hetimin, akuzën dhe rrjedhën e mëtejshme të procedurës penale. Në atë rast, e gjithë përgjegjësia i transferohet Kryeprokurorit. Meqenëse një vështirësi e caktuar me të cilën përballen zyrtarët e policisë është kryesisht vepra penale e krimit të organizuar dhe ndër-kantonal, është e mundur të veçohet mungesa e një prokurori special dhe një gjykate kompetente për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet e kryera në dy ose më shumë kantone si dhe krimet që fillojnë në një dhe përfundojnë në një kanton tjetër.

Përfaqësuesit theksuan se hetimi, si fazë e procedimit penal, është segmenti më i ndjeshëm i drejtësisë penale, sepse në atë kohë mblidhen prova nga të cilat varet

<sup>21</sup> Raporti Pointpulse - Opinioni i Qytetarëve për Policinë: Rezultatet e Hulumtimit të Opinioni Publik në Bosnjë dhe Hercegovinë (2017)

e gjithë procedura penale pasuese para gjykatës. Fatkeqësisht, shumë shpesh ka mungesë të provave, ka prova me cilësi të dobët ose ka prezantim joefektiv të këtyre provave në gjykatë.

Lidhur me mangësitë në aspektin e OSHC-ve, siç u tha nga një i anketuar, OSHC-të varen shumë nga donatorët në punën e tyre, dhe kjo mund të jetë një pengesë për objektivitetin në punën e OSHC-ve, që në fund të fundit mund të ketë një ndikim të madh në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Një prej të anketuarve deklaroi se “Kur çdo individ në shoqëri nuk i shikon më gjërat ‘sikurse nuk e shqetësojnë atë’, dhe kur sistemi mbron ata që guxojnë të raportojnë krimin dhe të dëshmojnë për këtë - atëherë reagimi i shtetit do të jetë më i fortë. Që ky model të jetë më efikas, qytetarët duhet të kenë besim tek institucionet”.

## Rekomandime

Policia dhe OSHC-të duhet të inkurajojnë qytetarët të jenë të gatshëm të raportojnë veprimtarinë kriminale në mënyrë që të forcohet bashkëpunimi, si dhe besimi midis shoqërisë dhe policisë. Për qëllim të arritjes së të njëjtit qëllim, gjyqësori dhe prokuroria duhet të rikthejnë besimin e qytetarëve në institucionet e tyre dhe vullnetin e tyre për të dëshmuar përmes shembujve dhe praktikave pozitive, siç janë veprimi më i shpejtë, shtrëngimi i politikës penale etj.

Agjencitë policore duhet të përqendrohen më shumë në policimin në komunitet. Faktorët ndërkombëtarë mund të kenë një ndikim të madh në aspektin e trajnimit dhe edukimit në mënyrë që të shkëmbejnë praktikatat më të mira.

Shteti duhet të forcojë kapacitetet e prokurorive dhe gjykatave, veçanërisht në trajtimin e krimeve të kryera në dy ose më shumë kantone, si dhe krimet që fillojnë në një kanton dhe përfundojnë në një kanton tjetër.

Të përmirësohet arsimimi dhe profesionalizmi në kapacitetet policore, gjyqësore dhe prokuroriale pasi mungesa e kompetencës ndikon ndjeshëm në efikasitetin e luftës kundër krimit të organizuar. Sipas gjetjeve, është e nevojshme të arsimohen zyrtarët e policisë në trajtimin e pastrimit të parave.

Legjislaturat në shtet duhet të përipiqen të harmonizojnë ligjet brenda shtetit për luftë më të mirë dhe më të baraspeshuar kundër krimit të organizuar sepse ekzistenca paralele e 4 sistemeve të drejtësisë penale, praktikës së pabarabartë si në zbatimin e ligjit material ashtu edhe procedural kanë çuar në nivel shqetësues të pasigurisë ligjore për qytetarët e BeH.

Është e nevojshme që niveli shtetëror të investojë më shumë përpjekje në lidhje me krijimin e një pike kontakti për bashkëpunim me EUROPOL, në mënyrë që të forcohet bashkëpunimi ndërkombëtar policor që do të çonte në veprime më efikase në lidhje me shtypjen e krimit të organizuar.

## Bibliografija

Council of Ministers of Bosnia and Herzegovina, Strategy for the Fight against Organised Crime in Bosnia and Herzegovina for the period 2017-2020, Sarajevo, September 2017.

Police Cooperation Convention for Southeast Europe.

Centre for Security Studies Sarajevo, Study on Organised Crime in Bosnia and Herzegovina, Sarajevo 2014.

Strategy for the Fight against Corruption in Bosnia and Herzegovina (2015-2019)

European Commission, Commission staff working document, Report on Bosnia and Herzegovina for 2018.

Opinion of the Commission on the Application of Bosnia and Herzegovina for membership in the European Union 2019.

The Southeast Europe 2020 Strategy (SEE2020), Regional Cooperation Council.

State Investigation and Protection Agency Annual Report 2018.

European Commission, Bosnia and Herzegovina 2020 Report.

Pointpulse Report – The Citizens’ Opinion of the Police: Results of the Public Opinion Research in Bosnia and Herzegovina (2017)

The Prosecutors Office Work Information for the years 2017 and 2018.

Organised Crime Threat Assessment in Bosnia and Herzegovina, 2016.

Criminal Code of Bosnia and Herzegovina, “Official Gazette of BiH” No. 3/03, 32/03, 37/03, 54/04, 61/04, 30/05, 53/06, 55/06, 32/07, 8 / 10. The Criminal Code of Bosnia and Herzegovina was imposed by a decision of the High Representative and published in the Official Gazette of BiH no. 3/03. These corrections to the imposed law were published in the “Official Gazette of BiH” no. 32/03.

Criminal Code of the Federation of Bosnia and Herzegovina (“Official Gazette of the Federation of BiH”, No. 36/2003, 21/2004 - corrigendum, 69/2004, 18/2005, 42/2010, 42/2011, 59/2014, 76/2014, 46/2016 and 75/2017).

Criminal Code of the Republic of Srpska (Official Gazette of the RS, No. 49/2003, 108/2004, 37/2006, 73/2010, 1/2012, 67/2013).


Criminal Code of the Brčko District of Bosnia and Herzegovina (“Official Gazette of the Brčko District of BiH”, No. 33/2013 - consolidated text, 47/2014 - correction 26/2016, 13/2017 and 50/2018).

Criminal Procedure Code of Bosnia and Herzegovina.

Court of Bosnia and Herzegovina, Department for Judicial Administration of the Court of BiH, powerpoint presentation.

# Kosova

Autorë: **Plator Avdiu, Shpat Balaj**



## Përmbledhje ekzekutive

Lufta efektive kundër KO në Kosovë vazhdon të jetë sfidë për sundimin e ligjit dhe proceset e forcimit të tij. Sfidat dhe mangësitë në këtë drejtim janë të pranishme në forma të ndryshme. Institucionet kryesore që formojnë zinxhirin e reagimit të drejtësisë penale përballen me sfida të veçanta që vijnë nga korrupsioni, organizimi i dobët, kapacitetet e kufizuara ose mungesa e përgjegjësisë dhe kompetencës institucionale. Nga ana tjetër, ka edhe probleme të zakonshme që lidhen kryesisht me nivelin politik, mungesën e vullnetit politik për të adresuar nevojat dhe sfidat e organizatave ose zhvillimet e përgjithshme politike në Kosovë dhe rajon në tërësi. Rrjedhimisht, si rezultat i sfidave dhe mangësive të pa adresuara, historiku i Kosovës në luftën kundër krimit të organizuar mbetet i dobët dhe ekziston një mospërputhje midis kornizës ligjore dhe strategjike dhe zbatimit të saj në praktikë.

Korniza kushtetuese dhe ligjore e Kosovës në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar dhe aktiviteteve të tjera kriminale është solide. Kodi Penal ka dispozita të veçanta ligjore që përcaktojnë grupet e organizuara kriminale si dhe dënimin e veprimtarive të lidhura me krimin e organizuar. Sa i përket dokumenteve strategjike të institucioneve të Kosovës, Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër Krimit të Organizuar 2018-2022 është në fuqi, megjithatë ka mungesë të informacionit për zbatimin e saj në praktikë dhe përmbushjen e objektivave strategjike kundër krimit të organizuar. Kosova ka bashkëpunim të mirë gjyqësor me vendet fqinje, me përjashtim të Serbisë. Sa i përket bashkëpunimit policor, Policia e Kosovës ka lidhur marrëveshje bilaterale me vendet e Ballkanit Perëndimor, duke përjashtuar Serbinë dhe Bosnjën dhe Hercegovinën. Vlerësohet se Policia e Kosovës ka nënshkruar 93 marrëveshje ndërkombëtare të bashkëpunimit policor. Përveç vendeve në Ballkanin Perëndimor, disa nga këto marrëveshje përfshijnë bashkëpunimin bilateral me Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian në ekipe të përbashkëta hetimore, si dhe në shkëmbimin e informacionit për rastet civile dhe penale. Që nga viti 2016, Kosova e ka të nënshkruar Marrëveshjen e Punës me Agjencinë Evropiane të Kufirit dhe Rojës Bregdetare (Frontex) për migracionin e parregullt, krimet ndërkufitare, sigurinë kufitare dhe menaxhimin e përgjithshëm të kufirit, përfshirë shkëmbimin ditor të të dhënave. Për më tepër, një Marrëveshje Pune e lidhur ndërmjet Kosovës dhe Agjencisë së Bashkimit Evropian për Bashkëpunim për Zbatimin e Ligjit (Europol) në vitin 2020 ka zyrtarizuar bashkëpunimin midis këtyre palëve. Ajo hap rrugën për bashkëpunim ndërmjet Kosovës, BE-së dhe shteteve anëtare të saj në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, të rëndë dhe formave të tjera të krimit.

Zhvillimet politike dhe socio-ekonomike në Ballkanin Perëndimor kanë bërë që grupet e organizuara kriminale të shtrijnë aktivitetet e tyre në rajon, ndërsa prania e korrupsionit dhe ndikimit politik në gjyqësor ka lehtësuar ndikimin e tyre në Kosovë dhe rajon në përgjithësi. Bazuar në indikatorët e Sundimit të Ligjit të Projektit Botëror të Drejtësisë, Kosova u rendit e dyta në zbatimin dhe respektimin e sundimit të ligjit në rajonin e Evropës Lindore, duke i lënë pas të gjitha vendet e tjera të BP.<sup>1</sup> Sidoqoftë, kur bëhet fjalë për hetime efektive nga sistemi i drejtësisë penale, Kosova mbetet nën mesataren e rajonit të BP. Përveç sa më sipër, mungesa e drejtësisë dhe bashkëpunimit të policisë së Kosovës me disa nga vendet e Ballkanit Perëndimor (p.sh., Serbi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë) dhe pengesat aktuale politike për anëtarësimin e saj në Interpol (përfshirë organizatat e tjera rajonale/ndërkombëtare të sigurisë) po e pengon bashkëpunimin policor ndërkombëtar të vendit në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar ndërkombëtar. Sidoqoftë, marrëveshja e fundit e punës, e lidhur midis Kosovës dhe Europol-it, është zhvillim pozitiv.

Përkundër faktit se korniza ligjore në Kosovë është mjaft solide, dhe që - të paktën në teori - i plotëson nevojat e luftës efektive kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, përdorimi praktik i saj lë shumë për të dëshiruar. Analizat e ndryshme të institucioneve ndërkombëtare dhe organizatave të shoqërisë civile tregojnë se Kosova ka për të bërë ende shumë progres në adresimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, dhe se elementë të ndryshëm të sistemit të drejtësisë penale vuajnë nga mangësi serioze që dëmtojnë progresin e Kosovës në këtë drejtim. Në përgjithësi, ekziston një mungesë e profilizimit dhe specializimit të aktorëve institucionalë dhe shoqërisë civile në fushën e krimit të organizuar, gjë që e zvogëlon të kuptuarit dhe efektivitetin e luftës nga njëra anë, ndërsa e lehtëson funksionimin dhe zhvillimin e grupeve të organizuara kriminale nga ana tjetër.

## Analiza e kornizës ligjore, strategjike dhe të politikave

Sa i përket kornizës ligjore, Kodi Penal i Republikës së Kosovës<sup>2</sup> përmban disa dispozita ligjore mbi aktivitetet e krimit të organizuar. Sipas këtij dokumenti ligjor, grup kriminal i organizuar është bashkimi i strukturuar, që ekziston për një kohë të caktuar, i tre apo më shumë personave për kryerjen e veprave të caktuara penale, që vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave të rënda penale për përfitim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore.<sup>3</sup> Neni 277 i Kodit përcakton se kushdo që me dashje dhe me dijeni qoftë të qëllimit dhe veprimtarisë së përgjithshme të grupit kriminal të organizuar ose qëllimit të grupit për të kryer

1 Projekti Botëror i Drejtësisë, 2020 *Indeksi i Sundimit të Ligjit 2020*. Në dispozicion në: [https://worldjusticeproject.org/sites/default/files/documents/WJP-ROLI-2020-Online\\_0.pdf](https://worldjusticeproject.org/sites/default/files/documents/WJP-ROLI-2020-Online_0.pdf)

2 Kodi Nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

3 Paragrafi 13 i nenit 113, Kodi Nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

një apo më shumë vepra penale të cilat janë të dënueshme me dënim maksimal prej të paktën katër (4) vjet ose më shumë aktivisht merr pjesë në veprimtaritë kriminale të grupit duke ditur se pjesëmarrja e tillë do të kontribuojë në realizimin e veprimtarive kriminale të grupit, dënohet me gjobë deri në 250.000 Euro dhe me burgim prej së paku 7 vjet.<sup>4</sup> Për më tepër, çdo person që organizon, themelon, mbikëqyr, menaxhon ose drejton veprimtaritë e grupit kriminal të organizuar, dënohet me gjobë deri në 500.000 Euro dhe me burgim prej së paku dhjetë 10 vjet.<sup>5</sup>

Ligje të tjera që ndikojnë në luftën kundër krimit të organizuar janë: Ligji për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar,<sup>6</sup> Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë,<sup>7</sup> Ligji për Deklarimin e Pasurisë dhe Dhuratave të të gjithë Zyrtarëve Publik,<sup>8</sup> Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funkcionit Publik,<sup>9</sup> dhe Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.<sup>10</sup> Ekzistojnë gjithashtu ligje të tjera specifike që synojnë të luftojnë aktivitetet në lidhje me krimin e organizuar. Ato mund të gjenden duke përdorur linkun e dhënë në fusnotë.<sup>11</sup>

Një nga dokumentet e rëndësishme ligjore është Kodi i Procedurës Penale.<sup>12</sup> Kodi i ri është hartuar së fundmi nga Ministria e Drejtësisë e Kosovës, me mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë<sup>13</sup> por ende nuk është miratuar dhe vënë në fuqi nga institucionet përkatëse (Qeveria dhe Kuvendi). Ndër risitë më të rëndësishme që ofron projektligji janë pezullimi i zyrtarëve publik të cilët janë dënuar nga gjykata për çdo vepër penale që përfshin korrupsionin dhe shpërdorimin e detyrës zyrtare. Një ndryshim tjetër është harmonizimi i kodit të ri me Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë për të rritur kapacitetet e institucioneve të zbatimit të ligjit në Kosovë drejt konfiskimit të pasurisë.<sup>14</sup>

Sa i përket dokumenteve strategjike, Strategjia Shtetërore dhe Plani i Veprimit kundër Krimit të Organizuar 2018-2022 njih KO si kërcënim për sigurinë e brendshme dhe të jashtme.<sup>15</sup> Ajo synon të përdorë burimet materiale, financiare dhe njerëzore në mënyrë sa më racionale të jetë e mundur dhe të zhvillojë politika për marrjen e përgjegjësive

4 Po aty, paragrafi 1 i nenit 277

5 Po aty, paragrafi 2 i nenit 277

6 Ligji Nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12360>.

7 Ligji Nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18337>.

8 Ligji Nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2767>.

9 Ligji Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funkcionit Publik. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16314>.

10 Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18303>.

11 Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës. (2018). *Strategjia Shtetërore dhe Plani i Veprimit kundër Krimit të Organizuar*, f. 10-14. Në dispozicion në: <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/48/STRATEGJIA%20SHTET%20C3%8BRORE%20KUND%20C3%8BR%20KRIMIT%20T%20C3%8B%20ORGANIZUAR%20DHE%20PLANI%20I%20VEPRIMIT%202018%20%E2%80%93%202022.pdf>.

12 Kodi i Procedurës Penale Nr. 04/L-123. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>.

13 Për më shumë informacion, shihni linkun vijues: <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,15,2396>.

14 Po aty;

15 Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës. (2018). *Strategjia Shtetërore dhe Plani i Veprimit kundër Krimit të Organizuar*, f. 5 Në dispozicion në: <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/48/STRATEGJIA.pdf>.

për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe mbrojtjen e individëve dhe shoqërisë nga ky fenomen.<sup>16</sup> Strategjia e Kosovës kundër Krimit të Organizuar rendit tri objektiva thelbësore: i) parandalimin dhe luftimin e formave të krimit të organizuar, ii) forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar, dhe iii) vendosjen e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar.<sup>17</sup> Institucioni i ngarkuar me koordinimin e zbatimit të objektivave të strategjisë është Koordinatori Kombëtar kundër Krimit të Organizuar, i cili monitoron gjithashtu indikatorët e këtij dokumenti strategjik. Përveç këtij organi, ministritë e linjës, institucionet e zbatimit të ligjit (policia, Prokuroria, etj.) janë përgjegjëse për monitorimin dhe kryerjen e vlerësimeve të aktiviteteve të përshkruara në planin e veprimit të Strategjisë.<sup>18</sup>

## Bashkëpunimi në nivel rajonal dhe të BE-së dhe shkëmbimi i njohurive

Sa i përket bashkëpunimit rajonal në fushën e aktiviteteve kundër krimit të organizuar, policia dhe institucionet e drejtësisë në Kosovë kanë bashkëpunim të fortë dhe të shëndoshë me vendet fqinje (të tilla si Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia Veriore). Bashkëpunimi me Serbinë, megjithatë, mbetet ende sfidë politike. Kosova aktualisht ka marrëveshje bilaterale mbi bashkëpunimin gjyqësor me të gjithë fqinjët e saj, duke përfshirë Serbinë.<sup>19</sup> Përkundër gatishmërisë së Kosovës për të bashkëpunuar me Serbinë në çështjet gjyqësore dhe të lidhura me policinë, kjo e fundit refuzon të krijojë bashkëpunim policor dhe gjyqësor bilateral dhe/ose rajonal me Kosovën, kryesisht për arsye politike dhe për shkak të faktit se Serbia refuzon të njohë pavarësinë e Kosovës.<sup>20</sup>

Policia e Kosovës gjithashtu ka nënshkruar marrëveshje bilaterale të bashkëpunimit me disa nga vendet e Ballkanit Perëndimor, por sfida e saj më e madhe mbetet bashkëpunimi bilateral policor me Serbinë dhe Bosnjën dhe Hercegovinën shkaktuar nga mungesa e shkëmbimit të informacionit në fushën e sigurisë me këto vende.<sup>21</sup> Kjo në mënyrë të pashmangshme kufizon përpjekjet e institucioneve të sundimit të ligjit në Kosovë për të parandaluar dhe luftuar në mënyrë proaktive krimin e organizuar transnacional dhe grupet e krimit të organizuar që veprojnë në rajon. Është e rëndësishme të theksohet se Policia e Kosovës ka nënshkruar 93 marrëveshje ndërkombëtare të bashkëpunimit

<sup>16</sup> *Po aty*, f. 6

<sup>17</sup> *Po aty*, f. 14

<sup>18</sup> *Po aty*, f. 16

<sup>19</sup> Qendra për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (2019). *Bashkëpunimi Rajonal Gjyqësor në Çështjet Penale: Përmbledhje e Praktikave Krahasuese të Vendeve të Ballkanit Perëndimor*, Qendra për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut, Podgoricë, f. 59. Në dispozicion në: <http://www.cedem.me/en/publications/studies-and-public-politics/send/71-studies-and-public-politics/1931-regional-judicial-cooperation-in-criminal-matters-overview-of-comparative-practices-in-western-balkans>.

<sup>20</sup> Dragojlo, S. dhe Isufi, P. (2021). *Vrasja e pazgjidhur e Oliver Ivanoviqit shoqërohet me pretendime për fshehje provash*. BIRN, 15 janar 2021. Në dispozicion në: <https://balkaninsight.com/2021/01/15/vrasja-e-pazgjidhur-e-oliver-ivanovicit-shoqerohet-me-pretendime-per-fshehje-provash/?lang=sq>.

<sup>21</sup> Aliu, L. dhe Avdiu, P. (2016). *Nyja e Gordianit: Pengesat e Kosovës për Anëtarësim në Organizatat Ndërkombëtare të Sigurisë: Rasti i INTERPOL-it, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Prishtinë*, f. 13. Në dispozicion në: [http://www.qkss.org/repository/docs/QKSS\\_INTERPOL\\_Nentor\\_2016\\_655429.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/QKSS_INTERPOL_Nentor_2016_655429.pdf).



policor, që përfshijnë 20 vende, dhe se bashkëpunon me Shtetet Anëtare të BE-së mbi baza bilaterale (përmes ekipeve të përbashkëta hetimore dhe shkëmbimit të informacionit për rastet civile dhe penale).<sup>22</sup>

Që nga viti 2011, Qeveria e Kosovës ka themeluar Njësine Ndërkombëtare për Koordinimin e Zbatimit të Ligjit (ILECU) brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës.<sup>23</sup> ILECU është iniciativë e bazuar në BE për të krijuar një mekanizëm efektiv të bashkëpunimit ndërkombëtar për zbatimin e ligjit midis vendeve përfituese të Ballkanit Perëndimor dhe për të përmirësuar bashkëpunimin ndërkombëtar në zbatimin e ligjit në rajon.<sup>24</sup> Ky mekanizëm, i cili është i integruar në modelet kombëtare të inteligjencës penale, është krijuar gjithashtu për të mbështetur shkëmbimin e informacionit në hetimet ndërkombëtare dhe për të lehtësuar kontaktet në nivelin operativ.<sup>25</sup> Vlen të përmendet gjithashtu që ILECU është pika qendrore e kontaktit të Policisë së Kosovës kur bëhet fjalë për bashkëpunimin policor ndërkombëtar, që nënkupton që informacioni i bashkëpunimit policor kalon përmes ILECU.<sup>26</sup> Një Memorandum Mirëkuptimi midis Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Prokurorisë së Shtetit u nënshkrua në vitin 2011, me qëllim të koordinimit të veprimeve dhe rritjes së efektivitetit të kësaj njësie në Kosovë.<sup>27</sup>

Bashkëpunimi i institucioneve të Kosovës me mekanizmat e bazuar në BE filloi pas Marrëveshjes së Punës me Agjencinë Evropiane të Kufirit dhe Rojës Bregdetare (Frontex), e cila u nënshkrua nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Frontex në vitin 2016 me qëllim të krijimit të bashkëpunimit operacional, Partneri zbatues i marrëveshjes së punës është Departamenti i Kufirit i Policisë së Kosovës.<sup>28</sup> Kjo mundëson gjithashtu bashkëpunim të ngushtë për migracionin e parregullt, krimin ndërkufitar, sigurinë kufitare dhe menaxhimin e përgjithshëm të kufirit, përfshirë shkëmbimin ditor të të dhënave. Brenda Frontex, Kosova merr pjesë në rjetin e analizës së rrezikut të Ballkanit Perëndimor dhe ushtrime të tjera rajonale të organizuara nga Frontex.<sup>29</sup>

Një zhvillim i madh ndodhi në vitin 2020, kur Kosova lidhi një Marrëveshje Pune me Europol-in, agjencinë e BE-së për zbatimin e ligjit,<sup>30</sup> duke zyrtarizuar kështu bash-

22 Komisioni Evropian. (2020). *Raporti Kosova 2020*, f. 42 Në dispozicion në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf).

23 Qeveria e Kosovës. (2011) *Memorandum Mirëkuptimi për koordinimin dhe mbështetjen e ofruar për Njësine Ndërkombëtare për Koordinimin e Zbatimit të Ligjit*, f. 2 Në dispozicion në: <http://kpk.spinagency.com/assets/cms/uploads/files/Memorandumet/2011/ILECU.pdf>.

24 Për më shumë informacion, shihni deklaratën për shtyp të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal në linkun vijues: <https://www.rcc.int/press/59/establishment-of-international-law-enforcement-coordination-units-in-western-balkans-launched-in-vienna-today>.

25 Po aty.

26 Kursani, Sh. (2015). Bashkëpunimi policor mes Kosovës dhe Serbisë, Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë dhe Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Beograd dhe Prishtinë, f. 6. Në dispozicion në: [http://www.qkss.org/repository/docs/Bashkepunimi\\_policor\\_ne\\_mes\\_te\\_Kosoves\\_dhe\\_Serbise\\_856214.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Bashkepunimi_policor_ne_mes_te_Kosoves_dhe_Serbise_856214.pdf).

27 Qeveria e Kosovës: 2011 *Memorandum Mirëkuptimi për koordinimin dhe mbështetjen e ofruar për Njësine Ndërkombëtare të Koordinimit të Zbatimit të Ligjit*, f. 2 Në dispozicion në: <http://kpk.spinagency.com/assets/cms/uploads/files/Memorandumet/2011/ILECU.pdf>.

28 FRONTEx. (2016), "Frontex nënshkruan marrëveshjen e punës me Kosovën", në dispozicion në: <https://frontex.europa.eu/media-centre/news-release/news-release/frontex-signs-working-arrangement-with-kosovo-u1FpiJ>.

29 Komisioni Evropian. (2020). *Raporti Kosova 2020*, f. 49. Në dispozicion në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf).

30 Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës. (2020), "Ministri Veliu nënshkruajti marrëveshjen e bashkëpunimit me EUROPOL-in", në dispozicion në: <https://mpb.rks-gov.net/f/57/420/Ministri-Veliu-nenshkruajti-marreveshjen-e-bashkepunimit-me-EUROPOL-in>.

këpunimin ndërmjet Kosovës dhe Europol-it. Qëllimi i marrëveshjes është të krijojë marrëdhënie bashkëpunimi midis Europol-it dhe institucioneve të zbatimit të ligjit të Kosovës që mbështesin Shtetet Anëtare të BE-së dhe Kosovën në parandalimin dhe luftimin e krimit të rëndë, krimit të organizuar, terrorizmit dhe ekstremizmit.<sup>31</sup> Përveç kësaj, Policia e Kosovës merr pjesë në Platformën e Europol-it për Prokurorët e Mbrojtjes së Dëshmitarëve, dhe BE ka rekomanduar që gjyqtarët të ndërmarrin trajnime se si të mbrojnë në mënyrë efektive dëshmitarët.<sup>32</sup> Është e rëndësishme të theksohet se Kosova është tashmë anëtare e iniciativave të caktuara rajonale të sigurisë, duke përfshirë SEESAC (South Eastern and Eastern Europe Clearinghouse for the Control of Small Arms and Light Weapons – Sistemi i Pastrimit i Evropës Juglindore dhe Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe Armëve të Lehta), MARRI (Migrimi, Azili, Iniciativa Rajonale e Refugjatëve), etj. Sidoqoftë, nuk është ende anëtare e plotë e një numri të organizatave të tjera rajonale të sigurisë, përfshirë RACVIAC (Qendra për Bashkëpunim të Sigurisë) ose SELEC (Qendra e Zbatimit të Ligjit në Evropën Juglindore). Përkundër faktit se Kosova dhe Serbia arritën një marrëveshje teknike për përfaqësimin rajonal të Kosovës (në vitin 2012, përmes lehtësimit të BE-së),<sup>33</sup> Serbia bën ashpër fushata për të bllokuar anëtarësimin e Kosovës në nismat rajonale, përfshirë ato që merren me sigurinë. Si pasojë, Kosova aktualisht nuk është as anëtare dhe as pjesëmarrëse në këto nisma.

## Historiku i përpjekjeve të institucioneve të Kosovës kundër KO

Që nga viti 2008, institucionet vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë kanë bërë përpjekje për të dhënë përgjigje efektive ndaj krimit të organizuar (KO) dhe korrupsionit. Pavarësisht se ekzistojnë disa mekanizma të vendosur që merren me KO dhe korrupsionin, në dekadën e fundit Kosova është vlerësuar se nuk ka bërë shumë përparim në trajtimin e KO. Raporti i auditimit i Gjykatës Evropiane të Auditorëve për EULEX-in<sup>34</sup> ka theksuar zhvillimet e ngadalta dhe joefikasitetin e EULEX-it në përmirësimin e sundimit të ligjit, veçanërisht në lidhje me luftimin e KO dhe korrupsionit.<sup>35</sup> Në mënyrë të ngjashme, transferimi i KO dhe rasteve të nivelit të lartë të korrupsionit nga EULEX në institucionet lokale<sup>36</sup> gjithashtu është karakterizuar nga

31 EUROPOL. (2020). *Marrëveshja e punës që krijon marrëdhënie bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve të zbatimit të ligjit të Kosovës dhe Agjencisë së Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit*. Në dispozicion në: <https://www.europol.europa.eu/partners-agreements/working-arrangements>.

32 Komisioni Evropian. (2020). *Raporti Kosova 2020*, f. 43. Në dispozicion në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf).

33 Për më shumë informacion, shihni marrëveshjen teknike të dialogut të lehtësuar nga BE-ja për Përfaqësimin dhe Bashkëpunimin Rajonal të arritur mes Kosovës dhe Serbisë në linkun vijues: [https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/agreement\\_0210\\_representation.pdf](https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/agreement_0210_representation.pdf).

34 EULEX është një mision i BE-së i themeluar në Kosovë. Një nga detyrat e tij kryesore ishte të sigurojë që (ndër të tjera) rastet e KO dhe korrupsionit, krimet ekonomike dhe krime të tjera të rënda të hetohen, ndiqen dhe zbatohen siç duhet. Për një përshkrim të hollësishëm të misionit EULEX, shihni: *Aksioni i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i 4 shkurt 2008 mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX Kosovë, Neni 3*. Në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32008E0124&from=EN>

35 Gjykata Evropiane e Auditorëve, *Raporti special nr. 12 – Asistenca e Bashkimit Evropian për Kosovën në lidhje me sundimin e ligjit*.

36 Për më shumë mbi ndryshimet në mandatin e EULEX-it dhe transferimin e rasteve të tyre tek institucionet lokale, shih: <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,44,197> dhe [http://www.qkss.org/repository/docs/Decon\\_eulex\\_paper\\_alb\\_\(1\)\\_220806.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Decon_eulex_paper_alb_(1)_220806.pdf)

një grumbullim i madh në trajtimin e këtyre rasteve dhe nuk ka pasur pothuajse asnjë dënim për veprat penale nga koha e transferimit deri më sot.<sup>37</sup> Për të prishur 'traditën' e historikut të dobët në luftimin e KO, Parlamenti i Kosovës miratoi Ligjin e ri për Gjykatat në vitin 2018, i cili themeloi departamente speciale brenda Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit të Prishtinës<sup>38</sup> që merren ekskluzivisht me veprat e ngritura nga Prokuroria Speciale.<sup>39,40</sup> Sipas Prokurorisë Speciale, krijimi i këtyre departamenteve ka lehtësuar dhe bërë punën e tyre më të lehtë dhe ka hapur rrugën për një efikasitet më të mirë.<sup>41</sup>

Sidoqoftë, në periudhën 2013-2019, hetimet u ndërpre në pothuajse gjysmën e rasteve totale të trajtuara nga Prokuroria Speciale. Numri i lartë i hetimeve të ndërprera dhe kallëzimeve penale të hedhura poshtë është veçanërisht i pranishëm në rastet që përfshijnë krimin e organizuar. Nga numri i përgjithshëm i rasteve të tilla të proceduara, hetimet janë ndërprerë ose kallëzimet penale janë hedhur poshtë në 46 përqind të rasteve.<sup>42</sup> Sa për rastet e korrupsionit, në 54 përqind të tyre hetimet janë pezulluar ose kallëzimet penale janë hedhur poshtë.<sup>43</sup>

Rastet e trajtuara nga Prokuroria Speciale	% e hetimeve të pezulluara dhe/ose kallëzimeve penale të hedhura poshtë	% e aktakuzave
Rastet në lidhje me armët (p.sh. Trafikimi)	<b>43%</b>	<b>57%</b>
Rastet në lidhje me narkotikët (p.sh. Trafikimi)	<b>47%</b>	<b>53%</b>
Kontrabanda e migrantëve	<b>36%</b>	<b>64</b>
Krimi i organizuar	<b>46%</b>	<b>54%</b>
Korrupsioni	<b>54%</b>	<b>46%</b>
Pastrimi i parave	<b>78</b>	<b>22%</b>
Kontrabanda e qenieve njerëzore	<b>43%</b>	<b>57%</b>
Krimet ekonomike	<b>35%</b>	<b>65%</b>
Nxitja e urrejtjes	<b>25%</b>	<b>75%</b>

Figura 1 - Performanca e Prokurorisë Speciale në periudhën 2013-2019. Burimi: <https://bit.ly/38ePclf>, f. 42

Gjatë periudhës janar-shtator 2020, Prokuroria Speciale trajtoi 38 raste me vepra penale në lidhje me KO, duke përfshirë 204 persona.<sup>44</sup> Nga totali, 34 raste u transferuan nga vitet e mëparshme, ndërsa katër kallëzime të reja penale u ngritën gjatë periudhës së

37 Intervistë me një prokuror nga Prokuroria Speciale, 15 dhjetor 2020, Prishtinë.

38 Megjithëse Departamentet Speciale janë themeluar brenda Gjykatës Themelore dhe të Apelit në Prishtinë, mandati i tyre shtrihet në nivelin kombëtar.

39 Prokuroria Speciale në Kosovë është themeluar në vitin 2008, me një mandat të veçantë për ndjekjen penale të disa veprave penale, me fokus të veçantë në ato që lidhen me KO.

40 Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat. Neni 13. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302>

41 Intervistë me një prokuror nga Prokuroria Speciale, 15 dhjetor 2020, Prishtinë.

42 Këshilli Prokurorial i Kosovës, 2020. *Raport krahasimor dhe analitik për veprat penale karakteristike të mekanizmit përcjellës ndërinstitucional për periudhën kohore: 2013-2019. Në dispozicion në: Raporti krahasimor dhe analitik për veprat penale karakteristike 2013-2019.pdf* (prokuroria-rks.org)

43 Po aty;

44 Këshilli Prokurorial i Kosovës, 2020. *Raporti periodik për veprat penale karakteristike të mekanizmit përcjellës ndërinstitucional për janar-shtator 2020. Në dispozicion në: RAPORTI JANAR-SHTATOR 2020, I MEKANIZMIT PËRCJELLES NDERINSTITUCIONAL.pdf* (prokuroria-rks.org)

mësipërme. Në të njëjtën periudhë, prokuroria speciale arriti të zgjidhte gjashtë raste që përfshinin 29 persona. Hetimet kanë përfunduar në 14 prej tyre, ndërsa aktakuzat janë ngritur në 15.<sup>45</sup> Megjithëse institucionet e drejtësisë penale përgjithësisht kanë mbetur prapa kur bëhet fjalë për procedimin efektiv të rasteve të KO dhe korrupsionit, konfiskimi i pasurisë është sfidë edhe më e madhe. Ndërsa ngrirja e përkohshme e pasurisë gjatë procedurave penale është diçka pozitive, konfiskimi përfundimtar lë për të dëshiruar.<sup>46</sup> Ky problem mund të jetë rezultat i numrit të lartë të rasteve të korrupsionit dhe KO të hedhura poshtë.

Rastet e transferuara nga vitet e kaluara		Rastet e reja të marra në periudhën janar - shtator 2020		Gjithsej rastet (transferuar + të reja)		Rastet e procedurara (të përfunduar/ zgjidhura)		Rastet që do të procedohen/të mbetura	
Rastet	Njerëzit e përfshirë	Rastet	Njerëzit e përfshirë	Rastet	Njerëzit e përfshirë	Rastet	Njerëzit e përfshirë	Rastet	Njerëzit e përfshirë
34	177	4	27	38	204	6	29	32	175

Figura 2 - Performanca e Prokurorisë Speciale në periudhën Janar - Shtator 2020.

Burimi: <https://bit.ly/3v5nhob>, f. 32

Progresi i ngadaltë dhe i dobët i Kosovës në luftën kundër krimit të organizuar dhe prania e korrupsionit janë gjithashtu pengesë për standardizimin e praktikave të mira me BE-në. Parlamenti Evropian i ka bërë thirrje Kosovës për të përmirësuar masat rregullatore për dënimet përfundimtare në rastet e profilit të lartë të korrupsionit dhe KO, dhe ka theksuar nevojën për të rritur përpjekjet në luftimin e këtyre fenomeneve.<sup>47</sup> Raporti i Komisionit Evropian, Kosova 2020, pranon se ka pasur një progres të kufizuar në luftën kundër KO në vitin 2020, por ai hedh dritë edhe mbi dënimin e butë në rastet e korrupsionit të profilit të lartë dhe KO.<sup>48</sup>

## Mangësitë dhe sfidat kryesore të përpjekjeve të Qeverisë së Kosovës kundër KO

Një nga sfidat kryesore me të cilat përballen institucionet e Kosovës në lidhje me luftën kundër KO është ndikimi politik dhe korrupsioni në organet dhe institucionet e pavarura. Strukturat gjyqësore janë të ekspozuara ndaj ndikimit politik dhe varësisë nga subjekte dhe figura të caktuara politike.<sup>49</sup> Prokuroria speciale është e vetëdijshme për këtë problem dhe beson se ndikimi politik është më i theksuar në rastet që përfshijnë korrupsionin dhe KO.<sup>50</sup> Përveç gjyqësorit, ndikimi politik dhe korrupsioni janë gjithashtu

45 Po aty;

46 EULEX, 2020. Raporti i Monitorimit të Drejtësisë i Misionit të Sundimit të Ligjit të BE-së: Gjetjet dhe Rekomandimet Shtator 2019 - Mesi i Marsit 2020.

47 Parlamenti Evropian, 2020. DRAFT RAPORT mbi Raportet e Komisionit 2019-2020 për Kosovën (2019/2172 (INI)). Në dispozicion në: [https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/AFET-PR-647076\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/AFET-PR-647076_EN.pdf)

48 Komisioni Evropian, (2020). Raporti Kosova 2020. Në dispozicion në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf)

49 Departamenti i Shtetit i SHBA, 2020. Raportet e Vendeve për vitin 2019 mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut: Kosova. Në dispozicion në: <https://www.state.gov/reports/2019-country-reports-on-human-rights-practices/kosovo/>

50 Intervistë me një prokuror nga Prokuroria Speciale, 15 dhjetor 2020, Prishtinë

të pranishëm në Policinë e Kosovës (PK). Megjithëse shumë zyrtarë policie u arrestuan për korrupsion në vitin 2019, këto arrestime përfunduan në mosndëshkim.<sup>51</sup> Në këtë drejtim, është e nevojshme të trajtohet mungesa e përgjegjësisë së zinxhirit komandues të këtij institucioni kur zyrtarët e tij arrestohen për korrupsion ose vepra të tjera penale. Duke pasur parasysh mënyrën e organizimit të PK-së, në disa raste është e vështirë për zyrtarët e policisë të kryejnë vepra penale pa dijeninë e eprorëve të tyre, dhe mos hetimi i mungesës së kompetencës ose përfshirjes së eprorëve është përgjithësisht i dëmshëm për sa i përket përgjigjes adekuate ndaj korrupsionit dhe krimit.<sup>52</sup> Për më tepër, në vitin 2020, zyrtarë të lartë të PK-së dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës janë vërejtur në shoqëri të ngushtë të personave të dyshuar dhe të dënuar për vepra të ndryshme penale.<sup>53</sup> Sidoqoftë, afërsia e zyrtarëve të lartë ndaj figurave të KO nuk është ekskluzive për Policinë së Kosovës ose Shërbimin Korrektues. Në vitin 2017, Ministri i atëhershëm i Punëve të Jashtme të Kosovës u pa duke u takuar miqësisht me kryesuesin e partisë serbe në Kuvendin e Kosovës i cili pretendohet gjithashtu të jetë figurë e fuqishme e KO në rajon. Kjo tregon afërsinë e subjekteve të caktuara politike në Kosovë me krimin e organizuar dhe reflektimin që mund të ketë ky fenomen në përpjekjet kundër KO.<sup>54</sup>

Përveç sfidave që dalin nga aspekti politik dhe korrupsioni, të cilat nuk janë domosdoshmërisht të lidhura ose të zgjidhshme nga një institucion, sfidat janë gjithashtu të pranishme në lidhje me kapacitetet dhe kompetencat e institucioneve të drejtësisë penale. Para krijimit të Departamentit Special brenda Gjykatës Themelore, aktakuzat për rastet e KO ngritëshin në gjykata në rajonet përkatëse ku ishin kryer veprat penale.<sup>55</sup> Trajtimi i aktakuzave nga këto gjykata është karakterizuar nga mungesa e kompetencës së gjyqtarëve të tyre dhe një numër i madh rastesh të pazgjidhura.<sup>56</sup> Vonesa në zgjidhjen e rasteve të vjetra është akoma e pranishme, pasi Departamenti Special është përgjegjës vetëm për aktakuzat e reja të paraqitura nga Prokuroria Speciale. Aktakuzat e vjetra gjykohen në gjykatat që i morën ato përpara krijimit të Departamentit Special.<sup>57</sup>

Nga ana tjetër, vetë Prokuroria Speciale ka mangësi në drejtim të luftës efektive kundër krimit të organizuar sepse prokurorët e saj nuk janë ende të profilizuar dhe të specializuar në KO.<sup>58</sup> Duke pasur parasysh ndjeshmërinë dhe rrezikun e hetimit dhe adresimit të KO, ky ka qenë rekomandim i vazhdueshëm i shoqërisë civile, ndërsa sipas përfaqësuesve të Prokurorisë Speciale, procesi i profilizimit dhe specializimit të mëtejshëm pritet së shpejti.<sup>59</sup> Nga ana tjetër, mënyra e organizimit të PK-së paraqet herë pas here pengesa për efikasitetin e saj në luftimin e KO. Ndërsa, në parim, rastet e KO trajtohen nga Drejtoria e Hetimeve të Krimit të Organizuar e PK-së, ndonjëherë ka mbivendosje të paqëllimtë të kompetencave midis drejtorive të ndryshme përgjegjëse për hetimin

51 Departamenti i Shtetit i SHBA, 2020. *Raportet e Vendeve për vitin 2019 mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut: Kosova*. Në dispozicion në: <https://www.state.gov/reports/2019-country-reports-on-human-rights-practices/kosovo/>

52 Intervistë me përfaqësuesit e Departamentit të Hetimeve, Agjencia Kundër Korrupsionit, 2 dhjetor 2020, Prishtinë

53 Insajderi, 2020. *Pas raportimit të Insajderit, suspendohet Komandanti i Njësisë Speciale dhe Drejtori i Burgut të Sigurisë së Lartë*. Në dispozicion në: <https://insajderi.com/pas-raportimit-te-insajderit-suspendohen-komandanti-i-njesise-speciale-dhe-drejtori-i-burgut-te-sigurise-se-larte/>

54 Pavlović, B. dhe Dojčinović, S., 2019. *Si një takim në jaht mund të ketë ndryshuar historinë politike të Kosovës*. OCCRP. Në dispozicion në: <https://www.occrp.org/en/investigations/how-a-meting-on-a-yacht-may-have-changed-kosovos-political-history>

55 Intervistë me një prokuror nga Prokuroria Speciale, 15 dhjetor 2020, Prishtinë

56 *Po aty*;

57 *Po aty*;

58 Gashi, L. dhe Thaqi, M., 2020. *Krimet Speciale në Kosovë*. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Në dispozicion në: <https://kli-ks.org/krimet-speciale-ne-kosove/>

59 *Po aty*;

e llojeve të ndryshme të krimeve.<sup>60</sup> Në disa raste, kjo rezulton në hetime paralele nga departamentet që janë më pak kompetente për të hetuar KO. Kjo ka ndikuar siç duket edhe në punën e Prokurorisë Speciale. Sipas tyre, kallëzimet penale të paraqitura nga PK shpesh nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht KO.<sup>61</sup> Kjo tregon mungesën e kompetencës dhe thekson nevojën për specializim të mëtijshëm dhe profilizim të zyrtarëve të PK-së. Ndërkohë, puna e institucioneve vështirësohet, në një farë mase, nga Kodi i Procedurës Penale, i cili parashikon që nëse brenda dy vjetësh hetimi nuk rezulton në aktakuzë ose pezullim, ai automatikisht ndërpritet.<sup>62</sup> Sipas përfaqësuesve të institucioneve të drejtësisë penale, periudha e hetimit e parashikuar në Kodin e Procedurës Penale nuk adreson në mënyrë efektive KO, pasi në shumë raste KO është kompleks dhe si i tillë kërkon hetime të gjera dhe afatgjata.<sup>63</sup>

Një sfidë e madhe e sistemit të drejtësisë penale është mungesa e anëtarësimit në mekanizmat kryesorë ndërkombëtarë të zbatimit të ligjit dhe drejtësisë si EUROPOL dhe EUROJUST, dhe mungesa e bashkëpunimit zyrtar me vendet e rajonit si Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina. Grupet e organizuara kriminale kapërcejnë kufijtë shtetërorë dhe dëmi i tyre shpesh shtrihet në nivelin rajonal.<sup>64</sup> Për vite, Kosova ka dështuar në përpjekjet e saj për t'u bërë anëtare e INTERPOL-it, proces i cili është penguar në mënyrë aktive gjithashtu nga Serbia.<sup>65</sup> Në këto rrethana, mungesa e anëtarësimit në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë dhe mungesa e bashkëpunimit rajonal me vende të caktuara pengon shkëmbimin e shpejtë të informacionit dhe rezulton në mos-komunikim dhe mos-unifikim të reagimit ndaj krimit ndërkombëtar.<sup>66</sup> Si pasojë, kjo ndikon në historikun e përpjekjeve të institucioneve të Kosovës dhe të rajonit në përgjithësi kundër KO, duke lënë gjithashtu një boshllëk për grupet e organizuara kriminale për të përdorur proceset politike në avantazhin e tyre.

---

60 Intervistë me Drejtorinë e Hetimeve të Krimit të Organizuar, Policia e Kosovës. 8 dhjetor 2020. Prishtinë.

61 Intervistë me Prokurorin e Prokurorisë Speciale. 15 dhjetor 2020. Prishtinë.

62 Kodi i Procedurës Penale. Neni 159. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

63 Intervistë me Prokurorin e Prokurorisë Speciale dhe Intervistë me Drejtorinë e Hetimeve të Krimit të Organizuar, Policia e Kosovës. 8 dhe 15 dhjetor 2020. Prishtinë.

64 Për një shembull që forcon këtë argument, shih: <https://www.occrp.org/ru/investigations/503-naser-kelmendi-from-kosovo-inmate-to-sarajevo-businessman>

65 Avdiu, P., 2017. *Rruga me pengesa drejt INTERPOL-it*. Sbunker. Në dispozicion në: <https://sbunker.net/siguria-blllogje-tematike/88982/rruga-me-pengesa-drejt-interpol-it/>

66 Intervistë me Drejtorinë e Hetimeve të Krimit të Organizuar, Policia e Kosovës, 8 dhjetor 2020, Prishtinë.

## Rekomandime

Pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vitin 2021, institucionet e sapo krijuara të Kosovës (Qeveria dhe Kuvendi) duhet të miratojnë dhe vënë në fuqi Kodin e Procedurës Penale të sapo hartuar sa më shpejt të jetë e mundur.

Prokuroria Speciale duhet të sigurojë që prokurorët e saj të janë të specializuar dhe të profilizuar në krimin e organizuar, në mënyrë që të rritet efektiviteti i punës së këtij institucioni dhe të sigurojë rezultate konkrete.

Departamenti Special brenda Gjykatës Themelore të Prishtinës duhet të rrisë kapacitetet e tij në mënyrë që të parandalojë grumbullimin e rasteve, siç ishte rasti me gjykatat e tjera para themelimit të këtij departamenti.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të kryejë një vlerësim gjithëpërfshirës të kapaciteteve dhe kompetencave aktuale të gjyqtarëve në Gjykatat Themelore në rajonin e Kosovës për të adresuar grumbullimin e rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Policia e Kosovës duhet t'i nënshtrohet riorganizimit të brendshëm në mënyrë që të përcaktojë më tej rolin e mekanizmave të saj të brendshëm në luftën kundër krimit të organizuar.

Institucionet e drejtësisë penale në përgjithësi duhet të forcojnë më tej praktikat në konfiskimin e pasurisë së paligjshme, ndërsa mekanizmat e tjerë përgjegjës duhet të rrisin efektivitetin e përdorimit të pasurisë së konfiskuar për nevojat e vendit.

Qeveria e Kosovës dhe niveli politik në përgjithësi duhet të përmbahen nga ndikimi i papërshtatshëm në sistemin e drejtësisë penale dhe duhet të adresojnë në mënyrë efektive nevojat e tyre për kapacitete në mënyrë që të përmirësojnë historikun kundër krimit të organizuar.

Qeveria e Kosovës duhet të shtojë përpjekjet e saj për të siguruar anëtarësimin e Kosovës në mekanizma ndërkombëtarë siç është INTERPOL-i.

Institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë, kryesisht Policia e Kosovës, duhet të përdorin plotësisht marrëveshjet e punës me FRONTEX dhe EUROPOL për të thelluar bashkëpunimin e ndërsjellë në parandalimin dhe luftimin e krimit të rëndë dhe të organizuar, përfshirë krimin e organizuar ndërkombëtar.

Qeveritë e vendeve në rajon duhet të përmbahet nga politizimi i bashkëpunimit me Kosovën në fushën e sundimit të ligjit dhe perspektivës së saj për t'u bërë anëtare e INTERPOL-it dhe mekanizmave të ngjashëm. Duke pasur parasysh efektet e krimit të organizuar në rajon dhe bashkëpunimin e grupeve të organizuara kriminale në të gjitha vendet e BP6, bashkëpunimi dhe zhvillimi në këtë drejtim duhet të mbetet i pakushtëzuar nga zhvillimet politike.

## Bibliografia

Aliu, L. and Avdiu, P., 2016. Gordian Knot: Kosovo's Obstacles towards Membership into International Organisations: INTERPOL Case, Kosovar Centre for Security Studies, Prishtina. Available at: [http://www.qkss.org/repository/docs/KCSS\\_INTERPOL\\_November\\_2016\\_904229.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/KCSS_INTERPOL_November_2016_904229.pdf)

Avdiu, P., 2017. *Rruga me pengesadreja INTERPOL-it*. Sbunker. Available at: <https://sbunker.net/siguria-bllogje-tematike/88982/rruga-me-pengesa-dreja-interpol-it/>

Centre for Democracy and Human Rights, 2019. *Regional Judicial Cooperation in Criminal Matters: Overview of Comparative Practices of Western Balkan Countries*. Centre for Democracy and Human Rights, Podgorica. Available at: <http://www.cedem.me/en/publications/studies-and-public-politics/send/71-studies-and-public-politics/1931-regional-judicial-cooperation-in-criminal-matters-overview-of-comparative-practices-in-western-balkans>.

Criminal Code no. 06/L-074 of the Republic of Kosovo. Available at: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

Criminal Procedure Code no. 04/L-123. Available at: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

Constitution of the Republic of Kosovo. Available at: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

Council joint action 2008/124/CFSP of 4 February 2008 on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo, EULEX Kosovo. Available at: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32008E0124&from=EN>

Dragojlo, S. and Isufi, P., 2021. *Cover-Up Claims Shadow Unsolved Murder of Kosovo Serb Politician*. BIRN, 15 January 2021. Available at: <https://balkaninsight.com/2021/01/15/cover-up-claims-shadow-unsolved-murder-of-kosovo-serb-politician/>

EULEX, 2020. *EU Rule of Law Mission Justice Monitoring Report: Findings and Recommendations September 2019 - Mid-March 2020*

European Commission, 2020. Kosovo 2020 Report. Available at: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf)

European Court of Auditors, 2012. *Special report no. 12 - European Union assistance to Kosovo related to the rule of law*

European Parliament, 2020. *DRAFT REPORT on the 2019-2020 Commission Reports on Kosovo (2019/2172(INI))*. Available at: [https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/AFET-PR-647076\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/AFET-PR-647076_EN.pdf)



EUROPOL, 2020. *Working Arrangement establishing cooperative relations between the law enforcement authorities of Kosovo and the European Union Agency for Law Enforcement Cooperation*. Available at: <https://www.europol.europa.eu/partners-agreements/working-arrangements>

FRONTEX, 2016. "Frontex signs working arrangement with Kosovo". Available at: <https://frontex.europa.eu/media-centre/news-release/news-release/frontex-signs-working-arrangement-with-kosovo-u1FpiJ>

Gashi, L. and Thaqi, M., 2020. *Krimet Speciale në Kosovë*. Kosovo Law Institute. Available at: <https://kli-ks.org/krimet-speciale-ne-kosove/>

Government of Kosovo, 2011. *Memorandum of Understanding on coordination and support provided to the International Law Enforcement Coordination Unit*. Available at: <http://kpk.spinagency.com/assets/cms/uploads/files/Memorandumet/2011/ILECU.pdf>.

Insajderi, 2020. *Pas raportimit të Insajderit, suspendohen Komandanti I Njësisë Speciale dhe Drejtori I Burgut të Sigurisë së Lartë*. Available at: <https://insajderi.com/pas-raportimit-te-insajderit-suspendohen-komandanti-i-njesise-speciale-dhe-drejtori-i-burgut-te-sigurise-se-larte/>

Interview with a prosecutor from the Special Prosecutor's Office, 15 December 2020, Prishtina

Interview with the Directorate of Organised Crime Investigations, Kosovo Police, 08 December 2020, Prishtina

Interview with the Investigation Department, Anti-Corruption Agency, 2 December 2020, Prishtina

Interview no. 2 with the Directorate of Organised Crime Investigation, Kosovo Police, 8 December 2020, Prishtina

Interview no. 3 with the Directorate of Organised Crime Investigation, Anti-Narcotics Unit, Kosovo Police, 7 December 2020, Prishtina

Kosovo Prosecutorial Council, 2020. *Comparative and analytical report on characteristic criminal offences of the inter-institutional transmission mechanism for the period 2013-2019*. Available at: <Raportikrahasimordheanalitikpervepratpenalekarakteristike 2013-2019.pdf> ([prokuroria-rks.org](http://prokuroria-rks.org))

Kosovo Prosecutorial Council, 2020. *Periodical report on characteristic criminal offences of the inter-institutional transmission mechanism for January-September 2020*. Available at: <RAPORTI JANAR-SHTATOR 2020, I MEKANIZMIT PËRCJELLES NDERINSTITUCIONAL.pdf> ([prokuroria-rks.org](http://prokuroria-rks.org))

Kursani, Sh., 2015. *Police cooperation between Kosovo and Serbia*, Belgrade Centre for Security Policy and Kosovar Centre for Security Studies, Belgrade and Prishtina. Available at: [http://www.qkss.org/repository/docs/Police\\_cooperation\\_between\\_Kosovo\\_and\\_Serbia\\_749694.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Police_cooperation_between_Kosovo_and_Serbia_749694.pdf)

Law no. 03/L-052 on the Special Prosecutor's Office of the Republic of Kosovo.

Available at: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2526>

Law no. 06/L-054 on Courts. Available at: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302>

Ministry of Internal Affairs of Kosovo, 2020. "Minister Veliu signs a cooperation agreement with EUROPOL", available at: <https://mpb.rks-gov.net/f/57/420/Ministri-Veliu-nenshkruajti-marreveshjen-e-bashkepunimit-me-EUROPOL-in>.

Ministry of Internal Affairs of the Republic of Kosovo, 2018. *State Strategy and Action Plan against Organised Crime*. Available at: <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/EN/48/STATE%20STRATEGY%20AND%20ACTION%20PLAN%20AGAINST%20ORGANIZED%20CRIME%202018%20%E2%80%93%202022.pdf>

Pavlović, B. and Dojčinović, S., 2019. *How a Meeting on a Yacht May Have Changed Kosovo's Political History*. OCCRP. Available at: <https://www.occrp.org/en/investigations/how-a-meeting-on-a-yacht-may-have-changed-kosovos-political-history>

US State Department, 2020. *2019 Country Reports on Human Rights Practices: Kosovo*. Available at: <https://www.state.gov/reports/2019-country-reports-on-human-rights-practices/kosovo/>

World Justice Project, 2020. *Rule of Law Index 2020*. Available at: [https://worldjustice-project.org/sites/default/files/documents/WJP-ROLI-2020-Online\\_0.pdf](https://worldjustice-project.org/sites/default/files/documents/WJP-ROLI-2020-Online_0.pdf)



# Mali i Zi

Autorë: **Dina Bajramspahić, Dragana Jaćimović**

Krimi i organizuar (KO) është një nga problemet kryesore, jo vetëm në Malin e Zi, por edhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, dhe në Evropë. Megjithëse KO është i përhapur, numri i organizatave kriminale që veprojnë në Malin e Zi nuk është i përcaktuar saktësisht. Duke pasur parasysh që grupet e organizuara kriminale veprojnë jashtë kufijve të një vendi, nuk mjafton që vetëm Mali i Zi të përfshihet në luftën kundër aktiviteteve të tyre. Është e nevojshme të bashkëpunohet me institucionet e vendeve të tjera, veçanërisht me policinë, por edhe me organizatat ndërkombëtare që merren me këtë temë. Mali i Zi ka një kornizë ligjore të vendosur për luftën kundër KO, e cila është në përputhje me *acquis*. Shumica e informacioneve mbi rezultatet në këtë fushë janë në dispozicion falë detyrimit për të raportuar në BE mbi rezultatet, në kontekstin e negociatave të pranimit. Megjithëse Mali i Zi ka bërë disa përpertime në këtë fushë, ka shumë probleme dhe sfida me të cilat përballlet në praktikë.

## Hyrje

Numri i saktë i organizatave kriminale që veprojnë në Malin e Zi nuk është përcaktuar saktësisht, por sipas të dhënave zyrtare, vlerësohet se ekziston një trend në rënie i numrit të grupeve të organizuara kriminale. Në vitin 2011, u vlerësua se kishte 35 grupe kriminale, në vitin 2013, 20 prej tyre, ndërsa vlerësohet se gjatë vitit 2017, 11 prej tyre ishin aktive në Malin e Zi.<sup>1</sup> Dy grupet më të njohura kriminale nga Mali i Zi janë kryesisht klani Shkalari dhe Kavaç. Nuk ka informacion të mjaftueshëm në të dhënat zyrtare nëse kishte një konsolidim të grupeve kriminale, lidhje të tyre ose çfarë ndodhi me anëtarët e madje 24 grupeve kriminale.

Grupet e organizuara kriminale nga Mali i Zi veprojnë jashtë kufijve të vendit dhe janë të përfshira kryesisht në kontrabandën e drogës nga Amerika Latine për në Evropë dhe identifikohen nga luftërat e dhunshme ndërmjet bandave, të shtënat në të gjithë Evropën dhe dhunës së madhe në rajon.<sup>2</sup> Pothuajse 50 persona humbën jetën në luftën pesë-vjeçare të zhvilluar në të gjithë Evropën midis dy klaneve kriminale malazeze, klaneve Shkalari dhe Kavaç.<sup>3</sup>

Që nga hapja e negociatave të pranimit me Bashkimin Evropian në vitin 2012, një nga prioritetet në fushën e sundimit të ligjit ka qenë lufta kundër KO. Në të gjitha raportet e mëparshme, Komisioni Evropian (KE) thekson nevojën për një qasje më proaktive në luftën kundër KO. Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se në Malin e Zi, në vitin 2020, pas tridhjetë vjetësh, qeveria ndryshoi në zgjedhje dhe se pritet një dinamikë e re në këtë fushë.

1 SOCTA (versioni publik), 2017.

2 Walter Kemp, Making a killing: What assassinations reveal about the Montenegrin drug war, 2020.

3 Seri e hulumtimit dokumentar "Ruga e hakmarrjes", TV Vijesti, 2020.

Një nga dokumentet më të rëndësishme strategjike në këtë fushë është Strategjia për Luftën Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit për periudhën 2010-2014. Për zbatimin e Strategjisë, janë zhvilluar Plane Veprimi (PV) për periudhën 2010-2012. dhe PV për periudhën 2013-2014. Për të kontrolluar zbatimin e Strategjisë dhe planet e saj, në vitin 2010 u krijua Komisioni Kombëtar për Zbatimin e Strategjisë për Luftën Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit<sup>4</sup> anëtarët e së cilit ishin gjithashtu përfaqësues të organizatave joqeveritare dhe Parlamentit të Malit të Zi. Falë pranisë së OJQ-ve, ky organ filloi të merrte më shumë vëmendje në media dhe publik.

Grupi i dytë i dokumenteve strategjike përbëhet nga PV për Kapitullin 23<sup>5</sup> si dhe PV për Kapitullin 24<sup>6</sup> të cilët indirekt kanë të bëjnë me luftën kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit të lartë.<sup>7</sup> Në vend të një strategjie të re për luftën kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit, masat nga Strategjia që nuk u zbatuan përmes shtojcës janë përfshirë në PV për Kapitullin 23.<sup>8</sup> Qeveria e Malit të Zi raporton për rezultatet në fushën e luftës kundër KO përmes raporteve mbi zbatimin e planeve të përmendura, *tabelës së historikut* ku paraqitet bilanci i rezultateve të arritura dhe ato dërgohen si shtojcë e raporteve dhe përmes bashkëngjitjeve speciale për Raportin e KE për Malin e Zi. Rekomandimet e hollësishme dhe precize të publikuara nga KE në dokumentin *non paper* për statusin joformal në Kapitujt 23 dhe 24, janë udhëzimet kryesore për përmirësimin e luftës kundër KO.<sup>9</sup>

Përveç sa më sipër, dokumente të tjerë strategjikë kanë të bëjnë me luftën kundër KO: Strategjia për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2019-2024, Strategjia për Parandalimin dhe Luftimin e Radikalizimit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm 2020-2024, Strategjia e Zhvillimit e Drejtorisë së Policisë 2016- 2020, Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Malit të Zi, Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2020-2024, Strategjia për Luftimin e Mbajtjes së Paligjshme, Abuzimit dhe Tregtisë së Armëve të Vogla dhe Armëve të Lehta dhe Municionit 2019-2025, dhe të tjera.

Korniza strategjike e Malit të Zi në luftën kundër KO plotëson dokumentin që analizon rreziqet ekzistuese dhe rreziqet e krimin të organizuar. SOCTA (ang. *Serious and Organized Crime Threat Assessment – shqip: Vlerësimi i Kërcënimeve të Krimin të Rëndë dhe të Organizuar*) synon të theksojë rëndësinë e një qasjeje strategjike në luftën kundër KO, si dhe të tregojë gjendjen aktuale dhe natyrën alarmante të formave të caktuara të krimin në rajon dhe ndikimit të tyre në Malin e Zi. Në periudhën nga viti 2010, u zhvilluan OCTA 2010, SOCTA 2013 (e cila u ndryshua në vitin 2015) dhe SOCTA 2017. Një pjesë e këtij dokumenti është publik, ndërsa pjesa e klasifikuar ka për qëllim Policinë, Prokurorinë dhe organet dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit në Malin e Zi.

4 Komisioni përbëhej nga 13 anëtarë, dy prej të cilëve ishin nga sektori i OJQ-ve.

5 Plani i Veprimit për Kapitullin 23 është në dispozicion në këtë link: <https://bit.ly/2LOtlvV>

6 Plani i Veprimit për Kapitullin 24 është në dispozicion në këtë link: <https://bit.ly/3pwNecl>.

7 Qeveria e Malit të Zi i miratoi ato në vitin 2013, dhe versioni i rishikuar me përparësi afatgjata u miratua në vitin 2015.

8 Dokumenti Operacional për Parandalimin e Korrupsionit në Zonat me Rrezik të Veçantë identifikon fushat e mëposhtme: Prokurimi Publik, Privatizimi, Urbanizmi, Arsimi, Shëndetësia, Pushteti Lokal dhe Policia. Dokumenti operacional është në dispozicion në: <https://bit.ly/3aix3JE>

9 Mund të lexoni më shumë rreth mënyrës së raportimit të reformave në fushën e sundimit të ligjit në botimin e Institutit të Alternativave “Boshllëqet në raportimin e reformave në fushën e sundimit të ligjit”, në dispozicion në linkun: <http://bit.ly/3nvWDQI>

Sipas Komisionit Evropian, korniza ligjore për të luftuar KO është kryesisht e krijuar dhe e harmonizuar me *acquis* të BE-së.<sup>10</sup> Aktet kryesore ligjore që njohin ose trajtojnë veprat penale në fushën e KO janë Kodi Penal i Malit të Zi,<sup>11</sup> Kodi i Procedurës Penale (KPP),<sup>12</sup> Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit<sup>13</sup> dhe Ligji për Konfiskimin e Pasurive Penale.<sup>14,15</sup>

Ndryshimet në Kodin Penal në vitin 2010 për herë të parë përshkruajnë një vepër të veçantë penale të krimit të organizuar - krijimin e një organizate kriminale (neni 401a).<sup>16</sup> Sipas këtyre ndryshimeve, përgjegjësia penale ekziston tashmë kur organizohet ose kur i përket një organizate kriminale. Më parë, kjo përgjegjësi ekzistonte vetëm kur një tjetër vepër penale specifike ishte kryer në organizim.<sup>17</sup> Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se në vitin 2009 koncepti i hetimit prokurorial u fut në Kodin Penal, i cili filloi të zbatohet në vitin 2010 në procedurat për krimin e organizuar, korrupsionin, terrorizmin dhe krimet e luftës, ndërsa zbatimi i plotë i hetimeve prokuroriale filloi në vitin 2011.<sup>18</sup>

Në aspektin institucional, tri hallkat kryesore në sistemin e drejtësisë penale malazeze të ngarkuara me luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar janë Departamenti Special i Policisë (DSP) dhe Sektori i Policisë Kriminale, Prokuroria Speciale e Shtetit (PSSH) dhe Departamenti i Specializuar i Gjykatës së Lartë në Podgoricë.

PSSH u themelua nga Ligji për Prokurorinë Speciale në vitin 2015.<sup>19</sup> Pas themelimit të PSSH, në vitin 2016, u formua DSP, që është përgjegjës për çështjet e policisë dhe vepron sipas kërkesave të Kryeprokurorit Special dhe Prokurorëve Special. Ky departament funksionon zyrtarisht brenda Sektorit për Luftën Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në Drejtorinë e Policisë (DP).<sup>20</sup> Departamenti i Specializuar

10 Raporti i Progresit i KE, Mali i Zi, 2020, faqe nr. 44.

11 Kodi Penal i Malit të Zi "Gazeta Zyrtare e RMZ", nr. 70/2003, 13/2004 - korrigjuar dhe 47/2006 dhe "Gazeta Zyrtare e MZ", nr. 40/2008, 25/2010, 32/2011, 64/2011 – ligj tjetër, 40/2013, 56/2013 - korrigjuar, 14/2015, 42/2015, 58/2015 – ligj tjetër, 44/2017, 49/2018 dhe 3/2020

12 Kodi i Procedurës Penale "Gazeta Zyrtare e MZ", nr. 57/2009, 49/2010, 47/2014 - Vendimi i GJK, 2/2015 - Vendimi i GJK, 35/2015, 58/2015 – ligj tjetër, 28/2018 - Vendimi i GJK dhe 116/2020 - Vendimi i GJK

13 Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit "Gazeta Zyrtare e MZ", nr. 033/14 datë 04.08.2014, 044/18 datë 06.07.2018

14 Ligji për konfiskimin e pasurisë së fituar nga veprat penale "Gazeta Zyrtare e MZ", nr. 58/15 dhe 47/19

15 Kjo fushë rregullohet pjesërisht edhe nga: Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve; Ligji për Punët e Brendshme; Ligji për Ndihmën Juridike Ndërkombëtare në Çështjet Penale; Ligjet për ratifikimin e marrëveshjeve bilaterale midis qeverisë së Malit të Zi dhe qeverive të vendeve të tjera mbi bashkëpunimin në fushën e luftimit të terrorizmit, krimit të organizuar, tregtimit të paligjshëm të narkotikëve, substancave psikotrope dhe prekursorëve, migracionit të paligjshëm dhe veprave të tjera penale.

16 Sipas nenit 401a të Kodit Penal, një organizatë kriminale është një organizatë e përbërë nga tre ose më shumë persona qëllimi i të cilëve është të kryejnë vepra penale për të cilat ligji mund të shqiptojë një dënim me burgim prej katër vjet ose më shumë, në mënyrë që të fitojë fitim të paligjshëm ose pushtet. Kush organizon një organizatë kriminale me qëllim të kryerjes së veprave penale për të cilat mund të shqiptohet një dënim me burg prej katër vjetësh ose një dënim më i rëndë me ligj, do të dënohet me burgim për një periudhë prej tri deri në pesëmbëdhjetë vjet.

17 MANS, Pas Statistikave 5 - Analiza e kornizës ligjore dhe aktgjykimeve të prera gjyqësore për veprat penale me elemente të krimit të organizuar, 2019.

18 Gjashtë vjet hetim prokurorial në Malin e Zi - Bashkëpunimi midis Policisë dhe Prokurorisë, Instituti i Alternativave, 2016.

19 Ligji për Prokurorinë Speciale të Shtetit "Gazeta Zyrtare e MZ", nr. 10/15 e 10.03. 2015.

20 Në vitin 2019, Drejtoria e Policisë u riorganizua për të pasur 8 sektorë, një prej të cilëve është Sektori për Luftimin e KO, i cili përfshin 5 njësi, përfshirë Departamentin Special të Policisë (DSP).

për Krimin e Organizuar, Korrupsionin, Terrorizmin dhe Krimet e Luftës, i cili vepron brenda Gjykatës së Lartë në Podgoricë, është i ngarkuar me ndjekjen penale të veprave penale në fushën e KO.

Në vitin 2019, pati gjithashtu një riorganizim ku Drejtoria për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit u bë pjesë e Drejtorisë së Policisë.<sup>21</sup>

## Bashkëpunimi në nivel rajonal dhe të BE-së

Autoritetet shtetërore të Malit të Zi kanë bashkëpunim të mirë me autoritetet e vendeve në rajon, si dhe me organizatat ndërkombëtare, si përmes marrëveshjeve për bashkëpunim ndërkombëtar, ashtu edhe përmes projekteve dhe programeve të përbashkëta.

Sipas përfaqësuesve të intervistuar të të gjitha institucioneve kompetente, organet shtetërore të Malit të Zi, sa i përket kompetencës lidhur me KO, kryesisht bashkëpunojnë me BE-në, në drejtim të përmbushjes së detyrimeve nga “agjenda evropiane”. Këto tri institucione (PSSH, DSP, Gjykata Speciale) vlerësojnë bashkëpunimin me rajonin si të mirë pasi zhvillohet përmes shkëmbimit të të dhënave në formën e ndihmës ndërkombëtare dhe rregullohet nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Në punën e saj, policia bashkëpunon me organizata të tilla si INTERPOL, EUROPOL, SELEC, FRONTEX. Gjithashtu, që nga viti 2019, Drejtoria e Policisë e Malit të Zi është anëtare e plotë e Ballkan Cartel-it, grupit operativ të EUROPOL-it që merret me grupe kriminale të organizuara që kontrabandojnë kokainë në nivel global.

Bashkëbiseduesit deklarojnë se, falë mbështetjes së Këshillit të Evropës, përmes programit *Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey (Mekanizmi horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë)*, Këshilli Gjyqësor, përmes disa projekteve, zbatoi aktivitete të shumta me qëllim të përmirësimit të kapacitetit të gjyqësorit.<sup>22</sup> Këshilli Gjyqësor bashkëpunon gjithashtu me Rrjetin Evropian të Këshillave Gjyqësorë (ENCJ), Zyrën Evropiane për Bashkëpunim Gjyqësor (EUROJUST), Komisionin Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), EUROL, GRECO, OSBE dhe të tjerë. Prokuroria beson se bashkëpunimi me rajonin dhe vendet e tjera në Evropë mund të përmirësohet në pjesën që lidhet me ekipet e përbashkëta të hetimit. “Është e nevojshme të hetohen mundësitë e kësaj mënyre të punës, dhe ne duhet të përcaktojmë mënyrën e përdorimit të provave të marra nga ekipet, si të veprojmë dhe të respektojmë ligjet e atyre vendeve, si dhe detaje të tjera në lidhje me kontratën,” përfundoi përfaqësuesi i prokurorisë.<sup>23</sup>

Për sa i përket trajnimeve, Qendra e Trajnimit Gjyqësor dhe Prokurorial (QTGJP) u hap në Mal të Zi në vitin 2015. Qendra ofron trajnime për të fituar dhe përmirësuar njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë e gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit në përputhje me parimet e pavarësisë dhe autonomisë dhe standardeve etike të profesionit. Prokurorët gjithashtu specializohen në fusha të caktuara dhe ndjekin programe dhe trajnime të organizuara nga institucione ndërkombëtare, ku ka një detyrim që prokurorët të

21 Këtë vit, brenda Policisë u krijua Zyra për Kthimin e Pronave, e ngarkuar me identifikimin dhe gjetjen e pasurisë së fituar përmes veprimtarisë kriminale.

22 Raporti mbi punën e Këshillit Gjyqësor dhe situatën e përgjithshme në gjyqësor në vitin 2019.

23 Intervistë me përfaqësuesin e PSSH-së.

raportojnë mbi trajnimet dhe seminarët në të cilat marrin pjesë.<sup>24</sup> Nga ana tjetër, sipas bashkëbiseduesve nga radhët e gjyqtarëve, trajnimi i gjyqtarëve nuk është thelbësor për kryerjen e punës. “Meqenëse gjyqtarët kanë si prioritet gjykimet, për shkak të vëllimit të punës, ata shpesh nuk marrin pjesë në trajnime deri në fund dhe nuk janë në gjendje t’i përgjigjen vazhdimisht bashkëpunimit me gjykata nga vendet e tjera përmes vizitave”, konsiderojnë bashkëbiseduesit.<sup>25</sup>

Trajnimi policor është përgjegjësi e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Vendoset se cilat trajnime do të realizohen nga policia, bazuar në konsultimet e drejtorit me menaxherët dhe bashkëpunëtorët e tyre, duke i propozuar MPB-së trajnimet që u nevojiten, dhe MPB-ja në koordinim me Akademinë e Policisë përcakton se cilat trajnime mund të realizohen. Përfaqësuesi i Ministrisë së Punëve të Brendshme beson se problemi me këto trajnime është se në fund të fundit, njerëzit që kanë vërtet nevojë për to nuk trajnohen, sepse ata janë të angazhuar në punë të rëndësishme.<sup>26</sup> Është gjithashtu e nevojshme të përmirësohet vlerësimi i trajnimeve dhe të monitorohet kënaqësia e pjesëmarrësve.

## Rezultatet e Malit të Zi deri më tani në luftën kundër krimit të organizuar

Sipas të dhënave të siguruara nga institucionet në lidhje me rezultatet në vitin 2020, ka pasur një rritje të numrit të kallëzimeve penale dhe rasteve për vepra penale në fushën e krimit të organizuar. Në 6 muajt e parë të vitit 2020, Drejtoria e Policisë dorëzoi në Prokurorinë Speciale të Shtetit (PSSH) 43 (19) kallëzime penale dhe raporte si shtesë e kallëzimeve penale (20), kundër 234 (203) personave fizikë dhe 96 (31) personave juridikë, për shkak të dyshimit të arsyeshëm se kanë kryer 346 (228) vepra penale në mënyrë të organizuar.<sup>27</sup>

Në 11 muajt e parë të vitit 2020, zyra e prokurorit special të shtetit lëshoi 27 urdhra për të kryer hetime kundër 198 personave fizikë dhe 43 aktakuza u ngritën kundër 339 personave fizikë për raste të krimit të organizuar, tha përfaqësuesi i PSSH.<sup>28</sup>

Sipas të dhënave të ofruara nga Këshilli Gjyqësor, për veprën penale të krijimit të një organizate kriminale, gjatë vitit 2020 ishin 59 (38) raste në pritje, dhe numri i rasteve të zgjidhura për periudhën e caktuar është 12 (2). Për këtë vepër, dënimet e shkallës së parë janë shqiptuar kundër 48 (13) personave, ndërsa në tri raste procedurat janë pezulluar. Dënimet e formës së prerë u shqiptuan kundër 33 personave dhe procedimet u pezulluan për tre persona. Gjatë vitit 2020, kishte 8 (12) raste në pritje dhe 2 (5) raste të zgjidhura për veprën penale të organizimit kriminal. Për këtë vepër, dënimet e shkallës së parë janë shqiptuar për 3 persona (2), dhe për të njëjtin numër personash, janë dhënë dënimet e formës së prerë.

24 Intervistë me përfaqësuesin e PSSH-së.

25 Intervistë me përfaqësuesit e Gjykatës së Lartë në Podgoricë.

26 Intervistë me përfaqësuesin e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

27 Të dhënat për tërë vitin 2020 do të jenë në dispozicion gjatë gjysmës së parë të vitit 2021.

28 Prezantimi i përfaqësuesit të PSSH-së në Konferencën në internet të Lajmeve mbi Luftën kundër Krimit të Organizuar. Regjistrimi i konferencës i disponueshëm në <http://bit.ly/3r5NwYO>



Në periudhën nga 3.7.2015 deri në shtator të vitit 2020, PSSH kishte ngritur 117 aktakuza kundër gjithsej 664 personave fizikë dhe 152 personave juridikë.

Sidoqoftë, nga sa më sipër mund të shihet se është e vështirë të monitorohen rezultatet e arritura për shkak të ndryshimeve në raportim. Problemi është se statistikat janë vendosur në mënyrë që puna e organeve të ndërlidhura të mos mund të monitorohet. Policia raporton statistikisht për veprat penale, ndjekjen penale për personat kundër të cilëve është ngritur procedimi penal, ndërsa gjykatat raportojnë për rastet (të cilat mund të përfshijnë më shumë se një person dhe disa vepra penale).<sup>29</sup>

Në raportin e vet të fundit, KE vuri në dukje se Mali i Zi ka arritur një nivel të caktuar gatishmërie për të luftuar KO dhe se është bërë përparim i kufizuar krahasuar me rekomandimet e raportit të mëparshëm.<sup>30</sup> Sipas gjuhës së Komisionit Evropian, Mali i Zi ka bërë më shumë për të krijuar një regjistër të centralizuar të llogarive bankare, për të forcuar kapacitetin policor dhe për të rritur numrin e procedurave të sekuestrimit. Është kryer riorganizimi i njësive brenda DP-së. Janë forcuar kapacitetet institucionale për të trajtuar trafikimin e qenieve njerëzore si dhe në fushën e krimit kibernetik. Gjithashtu, Mali i Zi ka përgatitur një raport kombëtar të drogave për herë të parë në pesë vjet. Numri i rasteve të hetuara të ndërlidhura me narkotikët vazhdoi të rritet por u rrit edhe numri i hetimeve të kontrabandës së narkotikëve.<sup>31</sup>

Sidoqoftë, raporti thekson se në skenën e krimit në Mal të Zi edhe më tej dominojnë vrasjet e shpeshta në lidhje me klanet kriminale. Vrasjet që përfshijnë grupe kriminale malazeze ndodhën gjithashtu jashtë vendit (9 që nga viti 2018), duke përfshirë Spanjën, Gjermaninë, Austrinë dhe Greqinë.

Non-paper i fundit për Kapitujt 23 dhe 24 thotë se organizimi dhe koordinimi i brendshëm i agjencive të zbatimit të ligjit është përmirësuar, gjë që është reflektuar në një numër në rritje të hetimeve, arrestimeve dhe konfiskimeve.

Nga ana tjetër, problemi më i madh është mënyra në të cilën zhvillohen procedurat penale në fushën e krimit të organizuar pranë gjykatave. "Procedurat gjyqësore janë tepër të gjata sepse ka vonesa të shpeshta e të shumta. Këto vonesa të gjata, por edhe mungesa e besimit midis prokurorisë dhe gjykatave, pas disa lirimeve të diskutueshme në vitet e fundit, kanë çuar në përdorimin e gjerë të marrëveshjeve të fajësisë nga prokuroria. Krimineli i dyshuar, i cili bëhet dëshmitar bashkëpunues në hetim, përjashtohet nga procedurat ligjore, pavarësisht nga rëndësia e krimit. Si rezultat, pavarësisht nga disa përjashtime të rëndësishme, përgjigjja e drejtësisë penale duket të jetë përgjithësisht e butë, ndërsa dënimet, gjobat dhe konfiskimi i pasurisë janë në mënyrë disproporcionale të ulëta krahasuar me peshën e krimit," përfundon raporti i KE.

---

29 Boshllëqet në raportimin e reformave të sundimit të ligjit, Instituti i Alternativave, 2018.

30 Komisioni Evropian, Raporti i Progresit i Malit të Zi, 2020.

31 Komisioni Evropian, Raporti i Progresit i Malit të Zi, 2020.

*Megjithëse është bërë një progres nga viti në vit, disa sfida mbeten kronike. Bashkëpunimi midis Prokurorisë Speciale të Shtetit dhe Departamentit Special të Policisë është i mirë dhe kjo ka përmirësuar "statistikat" e punës, por ka ende dyshime për një qasje selektive të punës. Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore është veçanërisht shqetësuese. Rastet që përfundojnë me një marrëveshje mbi pranimin e fajësisë dhe dënim të butë deri më tani kanë hasur në zemërim të publikut dhe përshtypjen e mungesës së drejtësisë në shoqëri. Masa të caktuara të mbikëqyrjes sekrete u shfuqizuan në vitin 2018 dhe kjo kishte një ndikim serioz negativ në rezultate.*

Meqenëse ka pasur ndryshim të qeverisë, një nga sfidat përpara është ndryshimi në pozitat kryesore në institucione, veçanërisht atyre që kanë nën juridiksion luftën kundër korrupsionit dhe KO. DP mund të menaxhojë vetëm përpjekjet për të luftuar KO deri në një nivel, ndërsa vendimet kryesore dhe përfundimtare janë përgjegjësi e PSSH dhe DSP vartëse të saj. Korniza ekzistuese legjislativ përcakton që kreu i DSP emërohet nga Drejtori i DP, me pëlqimin e Kryeprokurorit Special të Shtetit (KSSH). Në praktikë, ekziston një problem kur Drejtori i DP dhe KSSH nuk mund të arrijnë marrëveshje për këtë pozitë, dhe ne e patëm atë situatë kur ai u emërua në vitin 2016. Përveç DSP-së, ndryshimet e fundit organizative kanë krijuar një sektor të veçantë për luftën kundër krimit të organizuar (Sektori), i cili raporton te Drejtori i DP-së.<sup>32</sup> Problemi i ekzistencës së dy njësive që merren me luftën kundër krimit të organizuar, Sektorit dhe DSP-së, me drejtuesit e këtyre dy njësive që i përgjigjen eprorëve të ndryshëm, vë në dyshim përgjegjësinë dhe funksionimin hierarkik brenda sistemit.

Stafi cilësor në polici mbetet akoma sfidë. Policisë i mungojnë hetuesit e lartë për KO, trafikun e drogës, ekspertë të ngarkuar me masa të posaçme hetimore, ekspertë të krimit kompjuterik, krimit ekonomik dhe kriminalistikës.<sup>33</sup> Sipas DSP, është e nevojshme të forcohet kapaciteti njerëzor për të kryer hetime financiare (ekonomistë, avokatë), si dhe për të analizuar dhe ruajtur të dhëna.<sup>34</sup>

Pas aktgjykimit të vitit 2018 të Gjykatës Kushtetuese, një numër metodash hetimore speciale (MHS), thelbësore për kryerjen e hetimeve penale, nuk janë më të zbatueshme. Prokurorisë i është mohuar përdorimi i metodave hetimore speciale ose të ashtuquajturat "dërgesa të kontrolluara", kur zbulohet një ngarkesë e drogës dhe lejohet të lëvizë më tej në mënyrë që të sigurojë prova kundër kryesve. Kjo e pengon seriozisht luftën kundër krimit të rëndë dhe të organizuar. Rivendosja e përdorimit të plotë të metodave hetimore speciale, duke respektuar plotësisht parimet kushtetuese, duhet të sigurohet si çështje me prioritet.

Rekomandimet e mëparshme që hetimet financiare të kryhen paralelisht me procedurat penale mbeten të pa përmbyshura. Në shumicën e rasteve, hetimet financiare fillojnë shumë vonë dhe përqendrohen në kërkimin e pasurive, kryesisht me qëllim të konfiskimit të zgjeruar, dhe për këtë arsye nuk janë në përputhje me praktikën e BE-së dhe standardet e FATF. Në vend të kësaj, prokuroria po kryen një analizë financiare si pjesë e një hetimi penal për të vlerësuar të ardhurat e krimit, por jo aq sa të provojë krimin, të përmirësojë

32 D. Bajramspahić, S. Muk, "Qeveria e Re dhe Lufta Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar: Çfarë të bëhet në Prokurori dhe Polici?", Instituti i Alternativave, 2020.

33 Raporti i Progresit i KE, Mali i Zi, 2020.

34 Intervistë me përfaqësuesin e DSP-së.

njohuritë e rrjeteve kriminale, të bëjë zbulimin e rrjedhave financiare dhe të investimit të parave të pista në ekonomi. Sipas një zyrtari policie, përfaqësues i DSP-së, departamenti i tij ka mungesë të një zyrtari për të punuar në hetimet financiare. "DSP duhet të rrisë nivelin e hetimeve financiare, është e nevojshme të punësohen disa përmbarues të rinj që merren me të (ekonomistë, avokatë). Më shumë njerëz janë të nevojshëm gjithashtu për të analizuar dhe ruajtur të dhënat. Që do të thotë se mungojnë gjithsej 8-10 persona."

Problemet në punën e këtyre institucioneve, në aspektin teknik, krijohen nga mungesa e kapacitetit hapësinor. Gjegjësisht, Departamenti i Specializuar i Gjykatës së Lartë për Gjykimin e Krimit të Organizuar dhe Gjykata e Lartë e rregullt (e cila ka juridiksion mbi çështjet penale të shkallës së parë dhe të dytë dhe çështjet civile të shkallës së dytë) ndajnë dy salla gjyqësore, e cila është një nga arsytet e ngadalësisë së gjykatave në këto raste. Është e vështirë të organizohen gjykime me një numër të madh të të pandehurve edhe në kushtet kur nuk kishte epidemi të virusit covid-19. Është e nevojshme të mendohet për vendndodhjen dhe aspektin e sigurisë, pasi ndërtesa e kësaj gjykate është e vendosur në qendër të qytetit. Po ashtu, çështja e sigurimit të hapësirave të gjykatës, e cila aktualisht sigurohet nga policia, është e hapur. Gjatë viteve të mëparshme, filluan ndryshimet ligjore të cilat parashikonin formimin e një policie gjyqësore, por sistematizimi dhe kualifikimi i atyre vendeve të punës në atë kohë nuk i motivoi zyrtarët e policisë të aplikonin.<sup>35</sup> PSSH operon në hapësira me kushte shumë të pakta sepse ndodhet së bashku me Prokurorinë e Lartë të Shtetit në ndërtesën e Prokurorisë së Lartë të Shtetit. PSSH ka një problem veçanërisht të theksuar me hapësirat e punës, pasi përdor vetëm 17 zyra që janë pa kushte të duhura dhe jo të përshtatura me mënyrën e funksionimit të kësaj prokurorie. Meqenëse ka nga dy prokurorë specialë me këshilltarë dhe bashkëpunëtorë të tyre në hapësira, është e pamundur të kryhen veprime të caktuara procedurale në to, siç është mbledhja e informacionit nga qytetarët, ose mbajtja e takimeve të punës me policinë, ekspertët, palët dhe të tjerët.<sup>36</sup>

Kur bëhet fjalë për përgjegjësinë e prokurorëve të shtetit, ende nuk ka ndryshime të konsiderueshme. Asnjë prokuror nuk është mbajtur përgjegjës për parashkrimin ose për lëshimet në aktakuza që kanë çuar në aktgjykime të pafajësisë dhe refuzime. Asnjë gjyqtar nuk është disiplinuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, as për shkak të lëshimeve në konfirmimin e aktakuzave që kanë çuar në pafajësi në shumë raste të rëndësishme.<sup>37</sup>

Institucionet vazhdojnë të kenë qasje të kufizuar në bazat e të dhënave kryesore, gjë që pengon hetimet. Procedurat e gjata gjyqësore dhe më shumë vonesa në seanca vazhdojnë të pengojnë shqiptimin e aktgjykimeve në rastet e KO. Aktgjykimet e prera të bazuara në marrëveshje për pranimin e fajësisë mbeten normë, duke çuar në burg më të lehtë dhe gjobitje.<sup>38</sup>

Kur bëhet fjalë për bashkëpunimin e këtyre institucioneve me aktorë jo-shtetërorë, përfaqësuesit e prokurorisë dhe gjyqësorit besojnë se ata kanë bashkëpunim të mirë me sektorin joqeveritar. Ata nuk bashkëpunojnë me komunitetet lokale pasi puna e tyre lidhet kryesisht me veprime në nivelin shtetëror. Ministria e Punëve të Brendshme beson se marrëdhënia e një organi me aktorët jo-shtetërorë varet nga kush është në krye të atij organi në një moment të caktuar. Problemi ekziston kur kontributet e aktorëve jashtë

35 Intervistë me përfaqësuesit e Gjykatës së Lartë në Podgoricë.

36 D. Bajramspahić, "Pas numrave – Prerja tërthore e rezultateve të luftës speciale kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit "të lartë", Instituti i Alternativave, 2018.

37 MANS, Pas Statistikave 5 - Analiza e kornizës ligjore dhe aktgjykimeve të prera gjyqësore për veprat penale me elementë të krimit të organizuar, MANS, 2019.

38 KE, Dokumenti joformal punues mbi situatën në kapitujt 23 dhe 24, 2020.

sistemit shikohen vetëm si kritika, me rezistencë ndaj propozimeve të tilla.<sup>39</sup> Kur bëhet fjalë për mediat, prokuroria beson se ka raportime të polarizuara për punën e këtij organi. Si praktikë të mirë, prokuroria deklaroi organizimin e konferencave për shtyp në të cilat, përveç prezantimit të rezultateve të punës së PSSH-së, ata gjithashtu përgjigjen në pyetjet e gazetarëve.

Ekziston një mendim midis gjyqtarëve që për rezultate më të mira në fushën e KO, duhet të themelohet një Gjykatë Speciale në vend të Departamentit ekzistues, për shkak të një rritjeje të konsiderueshme të numrit të rasteve, zgjatjes së gjatë të procedimeve, nevojës për masa shtesë të sigurisë etj. Përveç kësaj, gjyqtari i intervistuar beson se të gjitha këto janë lëndë me materie ekzistuese të gjerë dhe se konfirmimi i aktakuzave është kërkuar dhe që jo të gjitha mund të kontrollohen me cilësi. Në atë pjesë, unë do të rekomandoja një qasje tjetër organizative të Këshillit Jashtëgjyqësor - për të formuar një Këshill të veçantë të përhershëm, i cili do ta kishte këtë detyrë të përhershme.

---

39 Intervistat me përfaqësuesit e MPB-së, DSP-së, PSSH-së dhe Gjykatës së Lartë në Podgoricë.

Të forcohen kapacitetet e DSP-së me 8-10 persona për të punuar në hetimet financiare, analizën dhe ruajtjen e të dhënave

Masat e mbikëqyrjes sekrete që janë shfuqizuar duhet të rishkruhen me disa ndryshime, në mënyrën e rekomanduar nga Gjykata Kushtetuese.

Të rritet efikasiteti i hetimeve penale: duke përmirësuar qasjen e institucioneve në bazat e të dhënave kryesore dhe duke krijuar një sistem ndërveprues me një funksion unik kërkimor;

Të zgjidhet çështja e kohëzgjatjes së gjykimeve dhe ndërprerjeve të shpeshta në rastet e krimit të organizuar; të sigurohet një mirëkuptim më i fortë reciprok midis gjykatave dhe prokurorive për disa koncepte kryesore ligjore siç janë pastrimi i parave dhe cilësia e provave;

Të përmirësohet mbikëqyrja strategjike e sistemit të drejtësisë penale duke krijuar një bazë të dhënash të centralizuar në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë, të mbledhur nga të gjitha autoritetet përkatëse, për qëllime analize dhe politikëbërje

Të përdoret në mënyrë strategjike SOCTA për të udhëhequr prioritetet operacionale në luftën kundër krimit të organizuar.

Të zhvillohet një strategji e re për zhvillimin e Administratës së Policisë, e udhëhequr nga ndryshimet organizative që kanë ndodhur brenda Administratës së Policisë.

Me ndryshimet në Ligjin për Prokurorinë Speciale të Shtetit të përmirësohet raporti gjashtëmuor dhe vjetor për punën e PSSH – me një pjesë të veçantë, e cila do të përmbajë një përmbledhje të punës dhe rezultateve të të gjithë prokurorëve specialë, si dhe informacione mbi hedhjen poshtë të kallëzimeve penale në raport me parashtruesit. Të avancohet gjithashtu raportimi me informacione mbi kompleksitetin e rasteve.

Për të përcaktuar dhe monitoruar plotësisht të dhënat zyrtare të organeve të ndryshme, është e nevojshme të përgatitet një analizë e situatës dhe ndryshimeve në raportimin statistikor të këtyre tri organeve, dhe të propozohen masa për harmonizimin gradual të statistikave, me afatet për zbatimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

Bajramspahić D. (2018) *Praznine u izvještavanju o reformama u oblasti vladavine prava*, Institut alternativa, dostupno na: <http://bit.ly/3nvWDQi>

Bajramspahić. D, Muk. S, (2020) *Nova Vlada i borba protiv korupcije i organizovanog kriminala: šta raditi u tužilaštvu i policiji?*, Institut alternativa, dostupno na: <https://bit.ly/3oCIJg4>

Bajramspahić.D, (2018) *Iza brojki- Presjek rezultata specijalne borbe protiv organizovanog kriminala i „visoke“ korupcije*, Institut alternativa, maj 2018. godine, dostupno na: <https://bit.ly/38Fqul5>

Evropska komisija (2020) *Izveštaj o napretku za Crnu Goru*, dostupno na: <https://bit.ly/3mRZmTA>

Evropska komisija (2020) *Nezvanični radni dokument o stanju u poglavljima 23 i 24, jun 2020*, dostupno na: <https://bit.ly/2WPFb9p>

Institut alternativa (2020) *Šest godina tužilačke istrage u Crnoj Gori- Saradnja Policije i Tužilaštva*, dostupno na: <https://bit.ly/3aiKERT>

Kemp. W. (2020) *Making a killing: What assassinations reveal about the Montenegrin drug war*, Globalna inicijativa protiv transnacionalnog organizovanog kriminala, jul. 2020. dostupno na: <http://bit.ly/3rD4XAR>

MANS (2019) *Iza statistike 5 - Analiza pravnog okvira i pravosnažnih sudskih presuda za krivična djela sa elementima organizovanog kriminala*,

Sudski savjet (2020) *Izveštaj o radu Sudskog savjeta i ukupnom stanju u sudstvu u 2019. godini*

TV Vijesti (2020) *Put osвете*, dostupno na <https://bit.ly/3aUmBu4>

TV Vijesti (2020) *Konferencija o borbi protiv organizovanog kriminala*, dostupno na <http://bit.ly/3r5NwYO>

## Spisak intervjuja:

Intervju sa predstavnicima Višeg suda u Podgorici, održan 10.12.2020. godine


Intervju sa predstavnikom Specijalnog policijskog odjeljenja, održan 25.11.2020. godine

Intervju sa predstavnikom Specijalnog državnog tužilaštva, održan 27.11.2020. godine

Intervju sa predstavnicom Ministarstva unutrašnjih poslova, održan 04.12.2020. godine

# Maqedonia e Veriut

Autorë: **Magdalena Lembovska**



Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit konsiderohet të jetë prioritet kryesor për Maqedoninë e Veriut. Ndërsa diskursi publik në vitet e fundit ka qenë kryesisht i përqendruar në korrupsion, keqpërdorim të detyrës dhe politizim të institucioneve, ka pasur vetëm analiza të kufizuara të llojeve të tjera të krimit të organizuar.

Ky punim synon të analizojë kornizën institucionale, strategjike dhe ligjore si parakushte për të luftuar krimin e organizuar, por gjithashtu të gjurmojë të dhënat dhe sfidat praktike të autoriteteve shtetërore për të demonstruar rezultate të prekshme në këtë fushë. Së fundmi, punimi jep një numër rekomandimesh për të përmirësuar luftën kundër krimit të organizuar dhe për të përkthyer zotimet retorike të nivelit politik në praktikë operacionale.

Punimi mbështetet në hulumtim të tryezës dhe të terrenit. Shqyrton dokumentet ligjore dhe strategjike në fushën e luftimit të krimit të organizuar, të dhënat zyrtare nga institucionet, raportet nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare dhe dokumente të tjera. Janë realizuar dy intervista me e-mail: një me një përfaqësues të Departamentit për Krimin e Organizuar dhe të Rëndë brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili gjithashtu dha rekomandime të vlefshme për përmirësimin e situatës, dhe një me Policinë Financiare.

Punimi hedh një vështrim më të afërt në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të drogave si një shembull i krimit të organizuar transnacional, në mënyrë që të nxjerrë në pah aspektet e ndryshme që duhet të merren parasysh kur vlerësohet "suksesi". Rekomandohen shumë hulumtime dhe përpjekje të mëtejshme për adresimin e llojeve të ndryshme të krimeve dhe grupeve të krimit të organizuar.

## | Analiza e kornizës ligjore, strategjike dhe të politikave

Korniza ligjore është vlerësuar në përgjithësi si e mjaftueshme për të mundësuar luftën kundër krimit të organizuar dhe është kryesisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Maqedonia e Veriut ka ratifikuar konventat relevante ndërkombëtare në këtë fushë, gjë që siguron bazën për luftimin e krimit të organizuar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe angazhimin në bashkëpunim ndërkombëtar në këtë drejtim.

Institucionet kyçe në luftën kundër krimit të organizuar janë Departamenti për Krimin e Rëndë dhe të Organizuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Prokuroria Publike për Ndjekjen Penale të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit brenda Prokurorisë Publike. Duke marrë parasysh që krimi i organizuar është i lidhur kryesisht me krimet financiare, Policia Financiare brenda Ministrisë së Financave është një tjetër palë e rëndësishme e interesit, që monitoron transaksionet e dyshimta financiare përmes kanaleve financiare ligjore. Administrata doganore, Njësia e Hetimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Zyra e të Ardhurave Publike gjithashtu kanë kompetenca në adresimin e krimeve financiare dhe pastrimin e parave. Së fundmi, Agjencia për Menaxhimin e Mallrave të Konfiskuara/Sekuestruara është një institucion i rëndësishëm që duhet të merret me të ardhurat dhe krimin.



Në vitet e fundit, ndodhën reforma të rëndësishme institucionale që ndikojnë në luftën kundër krimit të organizuar. Administrata për Siguri dhe Kundërzbulim (UBK) dikur ishte pjesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, mbante kompetenca policore dhe kishte monopolin e përgjimit të komunikimeve. Kjo njësi organizative dikur luante një rol të madh në hetimet në lidhje me krimin e rëndë të organizuar dhe terrorizmin. Në vitet 2018 - 2019, ajo kaloi një transformim të madh dhe u bë një Agjenci e pavarur për Siguri Kombëtare (ASK). ASK nuk ka kompetenca policore dhe nuk duhet të përfshihet më në hetime. Si rezultat i kësaj reforme, ekziston një Sektor i sapo formuar për luftën kundër terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit brenda Departamentit për Shtypjen e Krimit të Rëndë dhe të Organizuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Komisioni Evropian (KE) rekomandon që vendi duhet të sigurojë që reformat institucionale “të janë efektive dhe të përkthyer në një politikë proaktive të zbatimit të dokumenteve strategjike dhe arritjes së rezultateve të mëtejshme të prekshme”.<sup>1</sup>

Kur analizohet struktura institucionale, vlen të përmendet besimi i publikut në këto institucione si një element tregues i legjitimitetit të tyre në luftimin e krimit të organizuar. EUROMETRI<sup>2</sup> më i fundit tregon se besimi i publikut në institucione është përgjithësisht i dobët, pasi ato rrallë arrijnë të marrin besimin e të paktën gjysmës së popullatës. Ndërsa policia është një nga institucionet më të besueshme (43% thanë se ata kryesisht ose plotësisht i besojnë policisë, duke pasur ende parasysh se 30% nuk i besojnë asaj), rezultatet e prokurorisë publike dhe gjyqësorit janë veçanërisht dekurajuese. Vetëm 14% e të anketuarve u besojnë këtyre dy institucioneve, përkundër 68% që treguan mosbesim.<sup>3</sup>

Dokumenti strategjik më i rëndësishëm do të ishte Vlerësimi i Kërcënimit nga Krimi i Rëndë dhe i Organizuar (SOCTA). Sidoqoftë, dokumenti më i fundit i tillë i disponueshëm publikisht është SOCTA rajonal, i përgatitur nga autoritetet e Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe Serbisë në vitin 2016.<sup>4</sup> Megjithatë, qasja aktuale strategjike nuk është e harmonizuar dhe nuk ndjek metodologjinë e përcaktuar me ciklin e politikave të Europol/EMPACT.<sup>5</sup> Përfaqësuesi i intervistuar i MPB-së pranoi se qasja sistematike në luftimin e krimit të organizuar sipas standardeve evropiane mbetet një sfidë. Edhe pse ekzistojnë përcaktimet strategjike, ekziston një mungesë e koordinimit strategjik, drejtimit strategjik dhe sistemit të vendosur për dhënie të prioritetit si dhe monitorim dhe vlerësim.

Pas Raportit të Komisionit të BE-së 2020, ku u theksua se korniza strategjike duhet të përditësohet për të siguruar qëndrueshmëri me ciklin e politikës së Europolit/EMPACT, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut nxiti Ministrinë e Punëve të Brendshme të finalizojë SOCTA më të fundit në përputhje me ciklin e politikave të Europolit. Prandaj, kjo fushë duhet të monitorohet nga afër në të ardhmen.

Kur bëhet fjalë për kornizën strategjike, ka disa dokumente të veçanta strategjike lidhur me krimin e organizuar; megjithatë, shumë prej tyre skaduan në vitin 2020.

1 Komisioni Evropian: Raporti i Maqedonisë së Veriut 2020. Në dispozicion në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/north\\_macedonia\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/north_macedonia_report_2020.pdf)

2 EUROMETER është një sondazh i opinionit publik i kryer nga EUROTINK - Qendra për Strategjitë Evropiane. Sondazhi i fundit (në kohën e hartimit të këtij punimi) u krye në dhjetor 2020 dhe është në dispozicion në: <http://eurothink.mk/2020/12/31/4925/>

3 Po aty.

4 Në dispozicion në: [http://www.mvr.gov.mk/Upload/Editor\\_Upload/analizi-statistiki/Socta%20izvestaj%202016%20MK.pdf](http://www.mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/analizi-statistiki/Socta%20izvestaj%202016%20MK.pdf)

5 EMPACT qëndron për Platformën Evropiane Multidisiplinare kundër Kërcënimeve Kriminale. Është një cikël politik katër-vjeçar i vendosur nga Bashkimi Evropian në mënyrë që të krijojë një masë më të madhe të vazhdimësisë për luftën kundër krimit ndërkombëtar dhe të organizuar

Këto përfshijnë: Strategjinë e Zhvillimit të Policisë 2016-2020<sup>6</sup>; Strategjinë Kombëtare për Drogat e Paligjshme 2014-2020<sup>7</sup>; Strategjinë Kombëtare për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Migracionit të Paligjshëm 2017-2020,<sup>8</sup> Strategjinë për Forcimin e Kapacitetit për Kryerjen e Hetimit Financiar dhe Konfiskimin e Pasurisë 2018-2020 etj.<sup>9</sup> Fatkeqësisht, deri më tani asnjëra nga këto strategji nuk është vlerësuar dhe përditësuar në kohë dhe mënyrë të duhur. Gjithashtu, strategjitë e ndryshme nuk janë gjithmonë të harmonizuara ose nuk ofrojnë lidhje të qarta ndërmjet njëra-tjetrës. Mirëpo, Ministria e Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Shkup, miratoi tri strategji të reja të brendshme duke iu referuar periudhës 2020 - 2022: Strategjinë për menaxhimin e burimeve njerëzore,<sup>10</sup> Strategjinë për përfshirjen dhe komunikimin me komunitetin<sup>11</sup> dhe Strategjinë për Zhvillimin e Qendrës së Trajnimit të MPB-së.<sup>12</sup>

Ndërsa ekziston një lidhje e fortë midis krimit të organizuar dhe korrupsionit, Strategjia e fundit Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit (2021 - 2025)<sup>13</sup> nuk jep ndonjë përmendje të tillë. Një shpjegim i mundshëm mund të jetë fakti që kjo strategji ka një rol parandalues dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit që ka në pronësi këtë strategji nuk ka ndonjë kompetencë në lidhje me krimin e organizuar.

Në nivelin e politikave, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit konsiderohet të jetë prioritet kryesor, të paktën duke gjykuar nga deklaratat e Kryeministrit dhe ministrave kompetentë në raste të ndryshme. Megjithatë, një tregues për të vlerësuar vullnetin politik është gatishmëria për të fuqizuar institucionet relevante dhe organet e ndryshme me burimet e nevojshme për të përmbushur mandatet e tyre. Fatkeqësisht, shumë prej tyre po luftojnë me burimet financiare dhe po punojnë me më pak personel sesa parashikohet me Aktet e tyre të Sistemit të Vendeve të Punës. Për shembull, ambientet e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KShPK) nuk janë adekuate, dhe si rezultat, ata nuk mund të vënë në funksion pajisje të rëndësishme për ndërlidhje elektronike midis autoriteteve shtetërore përgjegjëse për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar (me vlerë 2,4 milion euro, të pranuar përmes fondeve IPA të BE-së). KShPK është dashur të zhvendoset në ambiente të reja; megjithatë, të njëjtat ambiente iu caktuan Ministrisë së re të Sistemit Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive.

Prokuroria Publike për Ndjekjen Penale të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit po përballet gjithashtu me sfida të rëndësishme. Akti i tyre i sistematizimit ka parashikuar

6 Në dispozicion në: [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor\\_Upload/Strategjia%20za%20razvoj%20na%20policijata%202016-2020.pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/Strategjia%20za%20razvoj%20na%20policijata%202016-2020.pdf)

7 Në dispozicion në: <http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2018/03/mkd-strategija-za-opojni-drogi-2014-2020.pdf>

8 Në dispozicion në: <http://nacionalnakomisija.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/Nacionalna-strategija-i-akciski-plan-za-borba-protiv-trgovija-so-lugje.pdf>

9 Strategji të tjera relevante përfshijnë: Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike 2018-2022; Strategjinë Kombëtare të Kontrollit të Armëve të Vogla dhe Armëve të Lehta (AVAL) 2017-2021; Strategjinë Kombëtare të Antiterrorizmit 2018-2022; Strategjinë Kombëtare për Luftimin e Ekstremizmit të Dhunshëm 2018-2022; dhe Strategjinë Kombëtare Kundër Mashtrimit 2019-2022. Në vitin 2020, Njësia e Inteligjencës Financiare, e cila është pjesë e Ministrisë së Financave, publikoi një Vlerësim të Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.

10 Në dispozicion në: [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor\\_Upload/FINAL%20HR%20STRATEGY\\_MK.pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/FINAL%20HR%20STRATEGY_MK.pdf)

11 Në dispozicion në: [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor\\_Upload/CE&C%20STRATEGY\\_MK.pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/CE&C%20STRATEGY_MK.pdf)

12 Në dispozicion në: [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor\\_Upload/TC%20STRATEGY\\_MK.pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/TC%20STRATEGY_MK.pdf)

13 Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit: Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit (2021 - 2025), dhjetor 2020. Në dispozicion në: <https://dksk.mk/wp-content/uploads/2021/01/Nacionalna-strategija-DKSK-KONECNA.pdf>

13 prokurorë publik, por 3 vende mbeten bosh (10 janë plotësuar). Në të njëjtën kohë, analiza e tyre ka treguar nevojën për të dyfishuar numrin ekzistues të prokurorëve, respektivisht ata kanë nevojë për një numër total prej 21 prokurorësh brenda këtij departamenti të specializuar në mënyrë që të jenë të gatshëm të përmbushin mandatin e tyre. Për më tepër, ata përballen me një mungesë serioze të personelit profesional për të mbështetur punën e tyre. Për shembull, akti i sistematizimit i kësaj zyre speciale parashikon 29 këshilltarë dhe bashkëpunëtorë, por ata punësojnë vetëm 9. Situata është e ngjashme me personelin administrativ (janë parashikuar 27, janë plotësuar 15).<sup>14</sup>

Një nga organet më të rëndësishme, Qendra Kombëtare e Koordinimit për Luftën kundër Krimin të Organizuar që u krijua nga Qeveria me qëllim të sigurimit të bashkëpunimit ndërmjet agjencive të ndryshme të zbatimit të ligjit në vitin 2014,<sup>15</sup> u bë pjesërisht operative në shtator 2017. Mungesa e kapacitetit të kësaj qendre për të përmbushur mandatin e saj u kritikua rregullisht në raportet kombëtare të Komisionit Evropian. Më në fund, ky organ u bë plotësisht funksional në vitin 2019, kur të gjitha institucionet relevante<sup>16</sup> caktuan përfaqësuesit e tyre dhe lidhën bazat e të dhënave me qendrën.

## Bashkëpunimi në nivel rajonal dhe të BE-së dhe shkëmbimi i njohurive

Krimi i organizuar shpesh ka një komponent transnacional, dhe bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar si dhe shkëmbimi i njohurive është i domosdoshëm. Raporte të ndryshme ndërkombëtare kanë treguar se peizazhi kriminal në Evropë po pëson ndryshime të shpejta dhe grupet e krimit të organizuar janë gjithnjë e më fleksibile, të ndërlidhura dhe bashkëpunuese, ndërsa gjithashtu bëhen më të forta financiarisht dhe politikisht.<sup>17</sup> Një nga mangësitë më të mëdha të vendeve të BP në luftën e tyre kundër KO konsiderohet të jetë dimensionin financiar i KO, veçanërisht duke marrë parasysh që paratë e pastruara nga operacionet e ndërlidhura me drogën përmes Ballkanit Perëndimor tejkalojnë mesataret evropiane.<sup>18</sup>

14 Prokuroria Publike e Maqedonisë së Veriut: Raporti Vjetor 2019, 2020. Në dispozicion në: <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2020/09/izveshtaj-na-javnite-obvinitelst-va-na-rsm-za-2019-godina.pdf>

15 Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut: Vendim për krijimin e një Qendre Kombëtare Koordinuese për Luftën kundër Krimin të Organizuar dhe të Rëndë. Nr. 42-2332/1 të datës 16.03.2014 (zbatohet që nga 01.01.2015). Në dispozicion në: <https://dejure.mk/zakon/odluka-za-formiranje-na-nacionalen-koordinativen-centar-za-suzbivanje-na-organiziran-i-seriozen-kriminal>

16 Ministria e Punëve të Brendshme, Njësia e Inteligjencës Financiare, Policia Financiare, Administrata Doganore, Zyra e të Ardhurave Publike dhe Prokuroria Publike për Luftën kundër Krimin të Organizuar

17 UNODC: "Vlerësim i thelluar formues i pavarur i Iniciativës kundër Krimin të Rëndë të Ballkanit Perëndimor (WBCSCI) në kontekstin e mekanizmit të Qeverisjes së Sigurisë së Brendshme Integruese (IISG) duke përfshirë veprimin e Bashkimit Evropian: "Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimin (IPA II) Programi i Veprimit Shumë Vendesh 2017 - Mbështetja për Qeverisjen Integruese të Sigurisë së Brendshme të Ballkanit Perëndimor "Ballkani Perëndimor". Në dispozicion në: [https://www.unodc.org/documents/evaluation/indepth-evaluations/2019/UNODC-IES\\_Independent\\_formative\\_evaluation\\_IISG\\_WBCSCI\\_EU\\_action\\_report\\_Feb\\_2019.pdf](https://www.unodc.org/documents/evaluation/indepth-evaluations/2019/UNODC-IES_Independent_formative_evaluation_IISG_WBCSCI_EU_action_report_Feb_2019.pdf)

18 Paratë e drogës: Të ardhurat e paligjshme të opiatëve të trafikuar në rrugën ballkanike (UNODC, 2015). [https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/Studies/IFF\\_report\\_2015\\_final\\_web.pdf](https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/Studies/IFF_report_2015_final_web.pdf) cituar në: [https://www.unodc.org/documents/evaluation/indepth-evaluations/2019/UNODC-IES\\_Independent\\_formative\\_evaluation\\_IISG\\_WBCSCI\\_EU\\_action\\_report\\_Feb\\_2019.pdf](https://www.unodc.org/documents/evaluation/indepth-evaluations/2019/UNODC-IES_Independent_formative_evaluation_IISG_WBCSCI_EU_action_report_Feb_2019.pdf)

Autoritetet në Maqedoninë e Veriut përdorin kanalet për bashkëpunim të ofruar nga Interpol, Europol, SELEC, por edhe zyrtarë ndërlidhës të vendeve të tjera. Maqedonia e Veriut nënshkroi një Marrëveshje mbi Bashkëpunimin Operacional dhe Strategjik me Europolin në vitin 2009,<sup>19</sup> me qëllim të zgjerimit të bashkëpunimit dhe mbështetjes në luftimin e formave të rënda të krimit ndërkombëtar, veçanërisht përmes shkëmbimit të informacionit dhe kontakteve të rregullta në të gjitha nivelet e duhura.<sup>20</sup> KE ka vlerësuar se ekziston një bashkëpunim operacional në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, armëve dhe drogës.<sup>21</sup> Në vitin 2020, Departamenti i Ministrisë së Punëve të Brendshme për Krimin e Rëndë dhe të Organizuar krijoi një vend pune me kompjuter me qasje të drejtpërdrejtë në Qendrën Evropiane për Luftën kundër Terrorizmit në Europol, duke mundësuar shkëmbimin e të dhënave përmes një lidhjeje të sigurt komunikimi për shkëmbimin e informacionit (SIENA). Sidoqoftë, ekziston një rekomandim që Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i të dhënave mund të përmirësohen më tej përmes një qasjeje më proaktive në shkëmbimin e informacionit.<sup>22</sup>

Marrëveshja e bashkëpunimit me Eurojust u nënshkrua në nëntor 2008,<sup>23</sup> ndërsa dhjetë vjet më vonë, Maqedonia e Veriut nënshkroi një marrëveshje me Eurojust. Gjatë të njëjtit vit 2018, në nëntor, Maqedonia e Veriut caktoi zyrtarin e saj të parë ndërlidhës në Eurojust.<sup>24</sup> Policia Financiare e ka vlerësuar bashkëpunimin e tyre ndërkombëtar si “përgjithësisht të mirë”.<sup>25</sup> Ata normalisht bashkëpunojnë përmes zyrës kombëtare të Interpolit, por edhe me Agjencinë Evropiane kundër Mashtrimit OLAF.

Maqedonia e Veriut është anëtare e Interpolit që nga viti 1993. Në vitet e fundit, ka pasur një përmirësim në fushën e shkëmbimit të informacionit. Që nga fundi i vitit 2018, bazat e të dhënave të kontrollit kufitar janë ndërlidhur me ato të Interpolit përmes mjetit FIND (Fixed Interpol Network Database - Baza e të dhënave fikse të Rrjetit të Interpolit), që do të thotë se çdo kontroll i udhëtarëve, dokumenteve të udhëtimit dhe automjeteve automatikisht kalon nëpër kërkuesit e Interpolit për persona, dokumente dhe automjete.<sup>26</sup> Departamentet e Krimit Kibernetik janë gjithashtu të lidhura me bazat e të dhënave të Interpolit për krimin kibernetik.<sup>27</sup>

Bashkëpunimi lidhet gjithashtu me trajnimin dhe ndërtimin e kapaciteteve, pasi shumë prej atyre aktiviteteve janë siguruar nga partnerë ndërkombëtarë. MPB përfiton nga programet e ndihmës të BE-së dhe SHBA-së, instrumenti TAIEX, programe të shumta bilaterale dhe multilaterale etj. Një nga mundësitë më të rëndësishme të trajnimit është marrëveshja midis MPB-së dhe Akademisë Evropiane të Policisë (CEPOL). KE inkurajon autoritetet të vazhdojnë të jenë të përgjegjshëm duke përdorur mundësitë e ofruara nga CEPOL, përkundër kufizimeve të saj buxhetore. Rëndësia e kësaj mundësie është konfirmuar edhe nga MPB.<sup>28</sup>

19 Në dispozicion në: <https://www.europol.europa.eu/agreements/republic-of-north-macedonia>  
Më parë. Maqedonia e Veriut nënshkroi një Marrëveshje Strategjike me Europolin në vitin 2007

20 Po aty. Neni 2

21 Komisioni Evropian: Raporti i Maqedonisë së Veriut 2020

22 Po aty.

23 Në dispozicion në: <https://www.eurojust.europa.eu/agreement-cooperation-between-euro-just-and-former-yugoslav-republic-macedonia>

24 Eurojust, Njoftim për shtyp: “Hapi i madh kundër krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor”, 23.11.2018. Në dispozicion në: <https://www.eurojust.europa.eu/major-step-against-organised-crime-western-balkans>

25 Pyetësori me e-mail, Policia Financiare

26 MPB: Plani Strategjik 2020 - 2022. Në dispozicion në: [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor\\_Upload/STRATESKI%20PLAN%202020-2022\(1\).pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/STRATESKI%20PLAN%202020-2022(1).pdf)

27 Po aty.

28 Intervistë me një përfaqësues të Departamentit të Krimit të Organizuar dhe të Rëndë, Ministria e Punëve të Brendshme

Policia financiare po përfiton gjithashtu nga trajnimet e ofruara nga partnerë ndërkombëtarë, siç janë Misioni i OSBE-së në Maqedoninë e Veriut dhe ambasadat e MB-së, SHBA-së, Italisë dhe Holandës.

Meqenëse pandemia COVID-19 ka pasur një ndikim të fortë në shoqëritë, ajo gjithashtu ndikoi në bashkëpunimin ndërkombëtar midis autoriteteve të zbatimit të ligjit. Në anën pozitive, trajnimi vazhdoi në internet, dhe autoritetet ishin në gjendje të përfitonin vazhdimisht nga trajnimi i ofruar nga aktorë të shquar si UNODC, OSBE, IOM, ICITAP etj. Sidoqoftë, sipas Shefit të Departamentit për Krimin e Rëndë dhe të Organizuar, përvoja ka treguar se bashkëpunimi më i mirë ndodh kur ka mundësi për takime të drejtpërdrejta ballë për ballë, në mënyrë që të forcohet besimi, transparenca dhe llogaridhënia si parime të rëndësishme primare në bashkëpunimin policor ndërkombëtar në operacione të rrezikshme dhe të ndjeshme.<sup>29</sup>

Kur bëhet fjalë për trajnim, disa raporte kanë zbuluar se “ka pasur një bollëk programesh trajnimi të ofruara nga agjenci të jashtme në 20 vitet e fundit”; megjithatë, ka pasur shqetësime nëse ndërtimi i tillë i kapaciteteve ka qenë “mjaftueshëm i rëndësishëm ose i ka marrë parasysh nevojat e sistemeve të drejtësisë penale në rajon”.<sup>30</sup> Prandaj, është e rëndësishme që organizata donatore të bashkëpunojë ngushtë me përfituesit jo vetëm gjatë programimit të ndihmës së tyre, por edhe për aktivitetet dhe modulet konkrete.

## Historiku i përpjekjeve të Maqedonisë së Veriut kundër KO

Pengesa e parë në vlerësimin e rezultateve të zotimeve të vendit për të luftuar krimin e organizuar është qasja në të dhëna që do të analizohen dhe më e rëndësishmja, cilësia e të dhënave që mund të merren. Maqedonia e Veriut ka një sistem të dobët të menaxhimit të të dhënave për krimin e organizuar dhe grupet e krimit të organizuar. Hulumtimi i UNODC<sup>31</sup> ka treguar se Maqedonia e Veriut, si shumica e vendeve në Ballkanin Perëndimor, nuk ka sisteme statistikore në dispozicion për të regjistruar, raportuar dhe analizuar informacionin.<sup>32</sup> Është veçanërisht sfiduese të gjurmohet një çështje përmes procesit të drejtësisë penale, nga hetimi të ndjekja penale deri të gjykimi me një identifikues unik. Gjithashtu, nuk ka të dhëna për vlerën ekonomike të aktiviteteve të organizuara kriminale. Mungesa e një sistemi të duhur të menaxhimit të të dhënave seriozisht pengon aftësinë për të zhvilluar politika të bazuara në dëshmi.

29 Intervistë me një përfaqësues të Departamentit të Krimit të Organizuar dhe të Rëndë, Ministria e Punëve të Brendshme

30 Iniciativa Globale kundër krimit të organizuar transnacional: “Trajtimi i Krimit të Rëndë dhe të Organizuar në Ballkanin Perëndimor. Raporti i Konferencës Wilton Park” shkurt 2020. Në dispozicion në: <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2020/05/GIATOC-Wilton-Park-conference-report-4May1125-Web.pdf>

31 UNODC: “Përmbledhje kërkimore: Matja e krimit të organizuar: Vlerësimi i të dhënave në Ballkanin Perëndimor. Në dispozicion në: [https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/Macro/Research\\_brief.pdf](https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/Macro/Research_brief.pdf)

32 Po aty. Krahasimi rajonal i disponueshëm në faqen 12, profili i vendit për disponueshmërinë e të dhënave mund të gjendet në faqen 27

Në raportin e fundit të vendit nga Komisioni Evropian, Maqedonia e Veriut lavdërohet për përmirësimin e historikut për luftimin e krimit të organizuar në vitin 2019, veçanërisht sepse ka një rritje të vazhdueshme të numrit të hetimeve penale të hapura kundër grupeve të krimit të organizuar, veçanërisht kundër grupeve që përfshijnë shumë të dyshuar.<sup>33</sup> Të dhëna të caktuara mund të gjenden në raportin e fundit vjetor të MPB-së<sup>34</sup> ku mund të konstatohet se MPB ka shtypur 21 grupe të organizuara kriminale në vitin 2019, duke inkriminuar 136 persona fizikë dhe 4 persona juridikë, që është një rritje në krahasim me vitin 2018 (shih Tabelën 1). Gjithashtu, peizazhi kriminal që ka qenë në shënjestër të MPB-së ka ndryshuar. Në vitin 2018, rezultatet kryesore ishin në luftimin e trafikimit të drogave të paligjshme, ndërsa në vitin 2019, MPB ka shënjestruar kryesisht korrupsionin, kontrabandën e migrantëve, pasuar nga trafikimi i paligjshëm i drogave.

Lloji i krimit	Grupet e KO në vitin 2018	Grupet e KO në vitin 2019	Pjesëtarët e grupeve të KO në vitin 2018	Pjesëtarët e grupeve të KO në vitin 2019
Trafikimi i paligjshëm i drogave	9	6	49	19
Kontrabandimi i migrantëve	3	4	15	43
Krimi i dhunshëm	2		11	
Korrupsioni		8		57
Krimi ekonomik	1	1	12	3
Pastrimi i parave				
Trashëgimia kulturore	1		15	
Trafikimi i paligjshëm i armëve		1		9
Kontrabandimi i mallrave		1		5
<b>Totali</b>	<b>16</b>	<b>21</b>	<b>102</b>	<b>136</b>


Tabela 1: Grupet e shtypura kriminale në vitet 2018 dhe 2019<sup>35</sup>

Sidoqoftë, duhet të kihet parasysh se MPB nuk përcjellë përfundimin e rasteve, respektivisht nëse pjesëtarët e grupeve kriminale janë sjellë me sukses para drejtësisë dhe janë dënuar për veprat e tyre. Grafiku 1 tregon numrin e përgjithshëm të kallëzimeve penale të paraqitura për të gjitha llojet e krimeve (statistika të veçanta për krimin e organizuar nuk ishin në dispozicion), numrin e kallëzimeve penale të ngritura nga Prokuroria Publike dhe numrin e dënimeve në vitin 2019. Prokuroria Publike ngritë kallëzime penale për pak më shumë se një të katërtën e numrit të përgjithshëm të rasteve që u janë raportuar atyre.

33 Komisioni Evropian: Raporti i Maqedonisë së Veriut 2020

34 Ministria e Punëve të Brendshme: Raporti Vjetor 2019. Në dispozicion në: [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor\\_Upload/%D0%93%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D1%88%D0%B5%D0%BD%20%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0\\_%202019%20%20\(3\)final.pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/%D0%93%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D1%88%D0%B5%D0%BD%20%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0_%202019%20%20(3)final.pdf)

35 Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme, Raporti Vjetor 2019.



*Grafiku 1: Numri total i kallëzimeve penale të paraqitura, numri i kallëzimeve penale (aktakuzave) të ngritura nga Prokuroria Publike dhe numri i dënimeve në vitin 2019.<sup>36</sup>*

Për qëllim të analizimit të historikut përtej një lloji të të dhënave, vlen të analizohet lufta kundër drogave. Rezultatet në luftën kundër drogave janë veçanërisht të rëndësishme në vlerësimin e zotimit dhe kapacitetit të vendit për të adresuar KO. Tregtia e drogave të paligjshme është tregu më i madh kriminal në BE, i vlerësuar me një vlerë minimale prej 30 miliardë eurosh në vit në BE.<sup>37</sup> Maqedonia e Veriut është një “pikë e madhe e transferimit për heroinën dhe hashashin e Azisë Jugperëndimore dhe një pikë e vogël tranziti për kokainën e Amerikës së Jugut të destinuar për në Evropë”.<sup>38</sup> Për më tepër, kostot e trafikimit të drogave të paligjshme janë të mëdha, duke marrë parasysh rreziqet për jetën dhe shëndetin e përdoruesve të drogës.

Analiza e kombinuar e statistikave të ndryshme tregon një pasqyrë të përzier lidhur me atë nëse autoritetet e Maqedonisë së Veriut kanë demonstruar rezultate të prekshme në luftën kundër drogave. Kur bëhet fjalë për heroinën, sasi të mëdha të sekuestruara ndodhën në gjysmën e parë të dekadës (një sasi totale prej 148 kg heroinë të sekuestruar). Gjatë viteve të fundit, policia ka arritur të sekuestrojë vetëm shuma të parëndësishme, më pak se 1 kg në vit. Kur bëhet fjalë për kokainën, sasi të sekuestruara mund të llogariten në gram, me përjashtim të viteve 2010 dhe 2011 kur autoritetet arritën të sekuestronin 1 kg dhe 1,5 kg kokainë për secilin vit respektivisht. Duket se fokusi është vënë te marihuana, veçanërisht në tri vitet e fundit. Luftimi kundër trafikimit të të gjitha llojeve të drogave rekomandohet patjetër, megjithatë, duket simptomatike që autoritetet filluan të përqendroheshin intensivisht në marihuanë në kohën kur vendi legalizoi marihuanën mjekësore.<sup>39</sup>

36 Burimi: Raporti vjetor i Prokurorisë Publike për vitin 2019, Shkup 2020. Në dispozicion në: <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2020/09/izveshtaj-na-javnite-obvinitelst-va-na-rsm-za-2019-godina.pdf>

37 Komisioni Evropian: “Strategjia e Sigurisë së Bashkimit të BE”, Bruksel, 2020. Në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?qid=1596452256370&uri=CELEX:52020DC0605>

38 Këshilli Këshillëdhënës i Jashtëm i Sigurisë, Byroja e Sigurisë Diplomatike, Departamenti i Shtetit i SHBA: “Raporti i Krimit dhe Sigurisë i OSAC Maqedonia Veriore 2020” në dispozicion në: <https://www.osac.gov/Country/NorthMacedonia/Content/Detail/Report/4c2842d7-0569-4811-8e69-192b0f314190>

39 Maqedonia e Veriut legalizoi marihuanën mjekësore në vitin 2016. Që nga tetori i vitit 2020, 55 kompani u licencuan për të vjelë marihuanë.

Sasia totale e drogave së sekuestruara - sipas llojit dhe sasisë (nenet 215 dhe 216 të Kodit Penal)										
Sekuestruar	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
<b>Marihuanë (në kg)</b>	459,7	286,4	784,6	477	632	226	623,7	510,18	1532,43	977,20
<b>Heroinë (në kg)</b>	37,1	23,7	55,3	11,7	20,2	5,36	0,8	1,4	1,97	0,73
<b>Kokainë</b>	2 kg	1,5 kg	173 g.	15,8 g.	318 g.	0,07 kg	717 g	263,84 g	586,69 g	852,3 g
<b>Rrënjë kanabisi</b>	4,199	1,247	2,755	1,421	1,187	2,362	2,414	389	819	131
<b>Tableta ekstazi</b>	459	3,628	206	142	1,217	490	522	1,187	472	4095

*Tabela 2: Sasia totale e drogave të sekuestruara - sipas llojit dhe sasisë<sup>40</sup>*

Në vitin 2019, Prokuroria Publike vëren një rritje prej 48,7% krahasuar me vitin e kaluar në kryesit e zbuluar të veprave në lidhje me prodhimin dhe shpërndarjen e paligjshme të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve.<sup>41</sup> Edhe pse raporti i tyre vjetor thotë se këto procedura “janë tregues për veprime të përfunduara me sukses nga autoritetet kompetente në parandalimin e krimeve të lidhura me drogën”, kjo deklaratë nuk duhet të merret si e mirëqenë. Statistikat e ofruara nuk tregojnë strukturën e kryesve, respektivisht nëse fokusi është përqendruar në grupe të krimit të organizuar ose thjesht përdorues të drogës të cilët u kapën për shkak të posedimit të drogave të paligjshme.

Së fundmi, krimi i organizuar kryesisht motivohet nga fitimet financiare. Konfiskimi i të ardhurave nga krimi do të ishte hapi i fundit në vendosjen e drejtësisë dhe sigurimin se “krimi nuk ia vlen”. Fatkeqësisht, konfiskimi mbetet një nga sfidat më të mëdha në këtë drejtim dhe do të duhen përpjekje të konsiderueshme për ta bërë këtë mekanizëm funksional në praktikë.

<sup>40</sup> Burimi: Të dhëna të Ministrisë së Brendshme. Në dispozicion në: <https://mvr.gov.mk/analiza/kriminal/31>

<sup>41</sup> Prokuroria Publike e Maqedonisë së Veriut: Raporti Vjetor 2019, 2020



## Konkluzione dhe rekomandime

Analiza ka treguar që zyrtarisht, struktura ligjore dhe institucionale është krijuar dhe e mjaftueshme për të adresuar çështjet e krimit të organizuar. Sidoqoftë, institucionet përgjegjëse ende po luftojnë me burimet njerëzore, teknike dhe financiare për të përmbushur përgjegjësitë e tyre. Në nivelin strategjik, analiza ka vërejtur mungesë të koordinimit strategjik, planifikimit, sistemit për caktimin e prioriteteve si dhe monitorimit dhe vlerësimit. - është veçanërisht e rëndësishme të punohet drejt rritjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë penale, veçanërisht në prokurorinë publike dhe gjyqësorin si institucione më pak të besuara. Prandaj, punimi ofron rekomandimet e mëposhtme:

### Kapacitetet:

Zotimi retorik në nivelin politik për t'i dhënë prioritet luftës kundër krimit të organizuar, duhet të përkthehet në sigurim të burimeve të nevojshme për institucionet, profesionalizim dhe depolitizim të tyre;

Institucionet përgjegjëse duhet të krijojnë sistem të shëndoshë të menaxhimit të burimeve njerëzore. Të gjitha rekrutimet e reja duhet të bëhen transparente dhe të bazuara në merita; ndërsa mundësia për avancim në karrierë, promovim dhe shpërblime të bazuara në merita do të ketë një ndikim pozitiv në promovimin e integritetit personal dhe profesional;

Departamenti për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit duhet të ketë buxhetin e decentralizuar të vet për operacionet e fshehta, të cilat mund të parashikohen në periudhë afatmesme dhe afatgjatë;

### Strategjia dhe koordinimi:

Maqedonia e Veriut duhet të miratojë Metodologjinë SOCTA në përputhje me standardet Evropiane dhe të harmonizojë dhe përditësojë më tej të gjitha strategjitë relevante që adresojnë fusha specifike të krimit dhe/ose zhvillimit institucional.

Ekziston nevoja për krijimin e të ashtuquajturit sistem gjurmimi duke integruar informacione nga procedurat para hetimore, hetimore dhe gjyqësore, të cilat do të mundësonin monitorim të vazhdueshëm të rasteve, monitorim dhe kontroll të progresit të tyre në kohë reale, kontroll të vendimeve, matje të efektivitetit dhe efikasitetit, fondeve të shpenzuara të buxhetit për hetime etj. Për më tepër, autoritetet duhet të demonstrojnë kapacitetin për t'i kthyer shtetit të ardhurat e krimit përmes konfiskimit të pasurive.

Bashkëpunimi dhe koordinimi operacional midis institucioneve të ndryshme nuk duket se funksionon plotësisht në praktikë dhe ka nevojë për rregullimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet prokurorëve publik dhe policisë gjyqësore.

### Roli i shoqërisë civile:

është thelbësore të investohet në organizata të forta të shoqërisë civile dhe media të pavarura që mund të monitorojnë rezultatet në luftën kundër krimit të organizuar, të zbulojnë mungesën sistematike, të ofrojnë rekomandime të bazuara në dëshmi për përmirësim dhe të alarmojnë publikun dhe bashkësinë ndërkombëtare në raste të rezultateve të dobëta ose mungesë të vullnetit për t'u marrë me raste konkrete dhe veçanërisht të nivelit të lartë të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

## Bibliografija

Annual report of the Public Prosecution for 2019, Skopje 2020. Available at: <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2020/09/izveshtaj-na-javnite-obvinitelstva-na-rsm-za-2019-godina.pdf>

Agreement on Operational and Strategic Co-operation between North Macedonia and Europol. Available at: <https://www.europol.europa.eu/agreements/republic-of-north-macedonia>

Cooperation agreement between North Macedonia and Eurojust. Available at: <https://www.eurojust.europa.eu/agreement-cooperation-between-eurojust-and-former-yugoslav-republic-macedonia>

Drug Money: The Illicit Proceeds of Opiates Trafficked on the Balkan Route (UNODC, 2015). [https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/Studies/IFF\\_report\\_2015\\_final\\_web.pdf](https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/Studies/IFF_report_2015_final_web.pdf) cited in: [https://www.unodc.org/documents/evaluation/indepth-evaluations/2019/UNODC-IES\\_Independent\\_formative\\_evaluation\\_IISG\\_WBCSCi\\_EU\\_action\\_report\\_Feb\\_2019.pdf](https://www.unodc.org/documents/evaluation/indepth-evaluations/2019/UNODC-IES_Independent_formative_evaluation_IISG_WBCSCi_EU_action_report_Feb_2019.pdf)

European Commission: North Macedonia Report 2020. Available at: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/north\\_macedonia\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/north_macedonia_report_2020.pdf)

European Commission: "EU Security Union Strategy", Brussels, 2020. Available at: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?qid=1596452256370&uri=CELEX:52020DC0605>

EUROTHINK: Public Opinion Survey EUROMETER, December 2020. Available at: <http://eurothink.mk/2020/12/31/4925/>

Eurojust, Press Release: "Major step against organised crime in Western Balkans", 23.11.2018. Available at: <https://www.eurojust.europa.eu/major-step-against-organised-crime-western-balkans>

Global Initiative against transnational organized crime: "Tackling Serious and Organized Crime in the Western Balkans. Wilton Park Conference Report" February 2020. Available at: <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2020/05/GIATOC-Wilton-Park-conference-report-4May1125-Web.pdf>

Government of the Republic of North Macedonia: Decision for establishing a National Coordination Centre for the Fight against Organised and Serious Crime. No. 42-2332/1 from 16.03.2014 (applicable since 01.01.2015). Available at: <https://dejure.mk/zakon/odlu-ka-za-formiranje-na-nacionalen-koordinativen-centar-za-suzbivanje-na-organiziran-i-seriozen-kriminal>

Interview with Dejan Nikolovski, Organized and Serious Crime Department, Ministry of Interior. Answers received on 24.12.2021

Interview (e-mail questionnaire) with the Financial Police, answers received on 18.01.2021

Ministry of Interior: Serious and Organized Crime Threat Assessment SOCTA, 2016 Available at: [http://www.mvr.gov.mk/Upload/Editor\\_Upload/analizi-statistiki/Socta%20izvestaj%202016%20MK.pdf](http://www.mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/analizi-statistiki/Socta%20izvestaj%202016%20MK.pdf)

Ministry of Interior Official Website. Data on crime 2010 – 2019. Available at: <https://mvr.gov.mk/analiza/kriminal/31>

Ministry of Interior: Annual Report 2019. Available at: [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor\\_Upload/%D0%93%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D1%88%D0%B5%D0%BD%20%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0\\_%202019%2020\(3\)final.pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/%D0%93%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D1%88%D0%B5%D0%BD%20%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0_%202019%2020(3)final.pdf)

Mol: Strategy for human resource management 2020 – 2022. Available at: [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor\\_Upload/FINAL%20HR%20STRATEGY\\_MK.pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/FINAL%20HR%20STRATEGY_MK.pdf)

Mol: Strategy for inclusion and communication with the community 2020 – 2022  
Available at: [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor\\_Upload/CE&C%20STRATEGY\\_MK.pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/CE&C%20STRATEGY_MK.pdf)

Mol: Strategy for Development of the Training Center of the Mol, Available at: [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor\\_Upload/TC%20STRATEGY\\_MK.pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/TC%20STRATEGY_MK.pdf)

Mol: Strategic Plan 2020 – 2022. Available at: [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor\\_Upload/STRATESKI%20PLAN%202020-2022\(1\).pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/STRATESKI%20PLAN%202020-2022(1).pdf)

Police Development Strategy 2016-2020, available at: [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor\\_Upload/Strategija%20za%20razvoj%20na%20policijata%202016-2020.pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/Strategija%20za%20razvoj%20na%20policijata%202016-2020.pdf)

National Strategy on Illicit Drugs 2014-2020, Available at: <http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2018/03/mkd-strategija-za-opojni-drogi-2014-2020.pdf>

National Strategy for Combating Trafficking in Human Beings and Illegal Migration 2017-2020, Available at: <http://nacionalnakomisija.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/Nacionalna-strategija-i-akciski-plan-za-borba-protiv-trgovija-so-lugje.pdf>

Overseas Security Advisory Council, Bureau of Diplomatic Security, U.S. Department of State: “North Macedonia 2020 OSAC Crime & Safety Report” available at: <https://www.osac.gov/Country/NorthMacedonia/Content/Detail/Report/4c2842d7-0569-4811-8e69-192b0f314190>

Public Prosecution of North Macedonia: Annual Report 2019, 2020. Available at: <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2020/09/izveshtaj-na-javnite-obvinitelstva-na-rsm-za-2019-godina.pdf>

Strategy to Strengthen the Capacity for Conducting Financial Investigation and Asset Confiscation 2018-2020


State Commission for Prevention of Corruption: National Strategy for Prevention of Corruption and Conflict of Interest (2021 – 2025), December 2020. Available at: <https://dksk.mk/wp-content/uploads/2021/01/Nacionalna-strategija-DKSK-KONECNA.pdf>

UNODC: “Independent formative In-depth evaluation of the Western Balkans Counter-Serious Crime Initiative (WBCSCi) in the context of the Integrative Internal Security Governance (IISG) mechanism including the European Union action: “Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA II) Multi-Country Action Programme 2017 - Support to the Western Balkan Integrative Internal Security Governance” Western Balkans.” Available at: [https://www.unodc.org/documents/evaluation/indepth-evaluations/2019/UNODC-IES\\_Independent\\_formative\\_evaluation\\_IISG\\_WBCSCi\\_EU\\_action\\_report\\_Feb\\_2019.pdf](https://www.unodc.org/documents/evaluation/indepth-evaluations/2019/UNODC-IES_Independent_formative_evaluation_IISG_WBCSCi_EU_action_report_Feb_2019.pdf)

UNODC: “Research Brief: Measuring Organized Crime: Assessment of data in the Western Balkans. Available at: [https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/Macro/Research\\_brief.pdf](https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/Macro/Research_brief.pdf)

# Serbia

Autor: **Milosh Jovanovic**



## Përmbledhje ekzekutive

Qëllimi kryesor i këtij raporti është të vlerësojë luftën kundër krimit të organizuar (KO) në Serbi, respektivisht kontributin e sistemit të drejtësisë penale në këtë çështje, si mangësi dhe sfida kryesore ekzistuese. Metodologjia cilësore e hulumtimit u përdor gjatë përgatitjes së raportit: 1) analiza e ligjeve dhe strategjive aktuale, si dhe analiza e raporteve përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe 2) analiza dhe interpretimi i përgjigjeve të marra gjatë intervistave të kryera. Për shkak të natyrës së mbyllur të institucioneve përgjegjëse për luftimin e KO, kishte vetëm dy intervista. Korniza ligjore, strategjike dhe institucionale për luftimin e KO në Serbi është e zhvilluar mjaftueshëm. Serbia ka bashkëpunim të mirë policor, si në nivelin rajonal, ashtu edhe në nivelin e Bashkimit Evropian (BE). Prandaj, kushtet për të luftuar KO janë përmbushur, por rezultatet mungojnë. Fatkeqësisht, nuk ka të dhëna të sistemuara në dispozicion të publikut dhe efektet reale të luftës kundër KO nuk janë plotësisht të qarta.

Një nga karakteristikat kryesore të KO është lidhja midis pjesëtarëve të një grupi të organizuar kriminal (GOK) dhe përfaqësuesve të shtetit, siç dëshmohet nga rastet më të fundit në 'Luftën kundër Mafisë' të deklaruar nga Qeveria Serbe në tetor 2020. Ky rregullim parandalon luftën e vërtetë kundër KO dhe ridrejton në mënyrë selektive përpjekjet e shtetit kundër GOK-ve rivale, siç tregohet nga raportet e gazetarëve hulumtues. Kështu, lufta kundër KO në Serbi varet drejtpërdrejt nga vullneti politik. Kjo është arsyeja pse kapja e shtetit është arsyeja kryesore për mungesën e rezultateve në luftimin e KO. Institucionet që nuk janë të pavarura dhe autonome nuk mund të kryejnë në mënyrë adekuate punën për të cilën janë krijuar. Ndikimi politik në punën e institucioneve kompetente për të luftuar KO është sfida kryesore, veçanërisht në polici si institucion që nuk është operacionalisht autonom. E sipërmja është shkak shtesë i bashkëpunimit të pamjaftueshëm midis policisë dhe prokurorisë, gjë që tregon mangësitë e zbatimit të hetimit prokurorial.

## Hyrje

Krimi i organizuar është kërcënim për sigurinë njerëzore, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare gjë që është jashtëzakonisht e dëmshme për shoqërinë bashkëkohore. Një sondazh i fundit i opinionit publik tregon se një e katërta e qytetarëve serbë besojnë se KO është kërcënim për sigurinë kombëtare, ndërsa 15% janë të bindur se është korrupsioni.<sup>1</sup> Zhvillimi i kornizës ligjore dhe institucionale është një parakusht për të luftuar KO. Planet e punës të të gjitha qeverive të Republikës së Serbisë parashikuan një luftë kundër KO, por pothuajse nuk ka pasur rezultate konkrete në terren. Kjo do të thotë që vullneti politik është një komponent i rëndësishëm në luftën kundër KO. Bashkëpunimi midis organeve shtetërore kompetente në nivel rajonal është gjithashtu i nevojshëm për një luftë efektive kundër këtij fenomeni. Lufta kundër KO paraqet një sfidë për pranimin e Serbisë në BE, veçanërisht për shkak të domethënies së Kapitullit 24 (Drejtësia, liria dhe siguria).

1 Ignjatijević, M., Elek. B. dhe Pavlović, M. (2020), "Armët kundër 'murtajës së bardhë', krimi dhe korrupsionit: Pikëpamja e qytetarëve për sigurinë", Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë, në dispozicion në: <https://bezbednost.org/wp-content/uploads/2020/11/naoruzanje-03.pdf> (qasur më 27 janar 2021)

## Analiza e kornizës ligjore, strategjike dhe të politikave

Baza kryesore ligjore për luftën kundër KO përfshin Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin për Organizimin dhe Kompetencën e Organeve Shtetërore në Luftën kundër Krimin të Organizuar, Terrorizmit dhe Korrupsionit. Sipas Kodit të Procedurës Penale, “KO është kryerja e veprave penale nga një GOK ose pjesëtarët e tij”,<sup>2</sup> ndërsa një “GOK është një grup prej tre ose më shumë personave që ekziston për një periudhë të caktuar kohe dhe vepron në bashkëpunim për të kryer një ose më shumë vepra penale të dënueshme me burgim për një afat prej katër vjetësh ose më shumë, për përfitim të drejtpërdrejtë ose indirekt financiar ose tjetër.”<sup>3</sup> Ky përkufizim i KO është pasojë e miratimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër KO (Konventa e Palermos) dhe protokolleve shtesë. Qëllimi i një GOK është të bëjë fitim përmes veprimtarisë kriminale dhe ta bëjë atë fitim të ligjshëm.

Legjislacioni penal i Serbisë ka pranuar përkufizimin e KO që vë në plan të parë organizimin kriminal. Sidoqoftë, aktivitetet e GOK janë element po aq i rëndësishëm i KO dhe paraqiten në pjesën e veçantë të Kodit Penal si forma më të rënda të krimeve konkrete. Trafikimi i drogës, kontrabandimi i njerëzve, trafikimi i qenieve njerëzore, trafikimi i armëve dhe eksplozivëve, krimi i pronës, krimi ekonomik, krimi kibernetik dhe krimi mjedisor janë forma të KO që u analizuan në Vlerësimin e Kërcënimit të Krimin të Rëndë dhe të Organizuar (SOCTA) 2019. Në territorin e Serbisë, “kontrabanda dhe trafikimi i drogës janë aktivitetet më të rëndësishme kriminale të shumicës së GOK-ve”.<sup>4</sup> Kjo është mjaft logjike, pasi trafiku i drogës është një nga format më fitimprurëse të KO në botë.

Prokuroria për Krimin e Organizuar, njësi organizative kompetente për luftimin e Krimin të Organizuar që vepron brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme, Departamenti Special për Krimin e Organizuar i Gjykatës së Lartë në Beograd (si gjykatë e shkallës së parë), Departamenti Special për Krimin e Organizuar i Gjykatës së Apelit në Beograd (si gjykatë e shkallës së dytë) dhe Njësia Speciale e Paraburgimit e Burgut të Qarkut në Beograd janë institucionet kryesore të sistemit të sigurisë kombëtare që janë kompetente për luftimin e KO.<sup>5</sup> Prokuroria për Krimin e Organizuar zhvillon procedurën para hetimore dhe hetimore. Shërbimi për Luftimin e Krimin të Organizuar i Drejtorisë së Policisë Penale është një njësi organizative brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme, kompetente për zbulimin e KO. Agjencia Informative e Sigurisë (BIA), Agjencia Ushtarake e Sigurisë (VBA), si dhe institucionet që veprojnë brenda Ministrisë së Financave janë gjithashtu aktorë që kontribuojnë në kryerjen e procedurës para hetimore dhe hetimore.

2 Kodi i Procedurës Penale, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë” nr. 72/2011, 101/2011, 121/2012, 32/2013, 45/2013, 55/2014 dhe 35/2019, neni 2, paragrafi 34, në dispozicion në: [https://www.paragraf.rs/propisi/zakonik\\_o\\_kvivicnom\\_postupku.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakonik_o_kvivicnom_postupku.html) (qasur më 27 janar 2021)

3 *Po aty*, neni 2, paragrafi 33. (qasur më 27 janar 2021)

4 Ministria e Punëve të Brendshme (2019) “Vlerësimi i Kërcënimit të Krimin të Rëndë dhe të Organizuar 2019”, f. 20, në dispozicion në: <http://www.mup.gov.rs/wps/wcm/connect/3d0a3df4-4e1d-4b70-8475-3d69f6d21107/SOCTA+2019++ENG-compressed.pdf?MOD=AJPERES&CVID=nnvYlq8> (qasur më 12 shkurt 2021)

5 Ligji për Organizimin dhe Kompetencën e Organeve Shtetërore në Luftën kundër Krimin të Organizuar, Terrorizmit dhe Korrupsionit, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë” nr. 94/2016 dhe 87/2018, neni 4, në dispozicion në: <https://www.paragraf.rs/propisi/zakon-o-organizaciji-i-nadleznosti-drzavnih-organa-u-suzbijanju-organizovanog-kriminala-terorizma-i-korupcije.html> (qasur më 27 janar 2021)

Brenda Ministrisë së Drejtësisë, ekziston Drejtoria për Menaxhimin e Pasurisë së Konfiskuar, e cila menaxhon pasurinë e sekuestruar të fituar përmes veprimtarisë së KO. Për shkak të kompleksitetit të KO, sipas Ligjit për Organizimin dhe Kompetencën e Organeve Shtetërore në Luftimin e Krimit të Organizuar, Terrorizmit dhe Korrupsionit është e mundur të themelohet një shërbim kriminalistik financiar, të emërojnë zyrtarë ndërlidhës dhe të formojë një task forcë.<sup>6</sup> Shërbimi Forenzik Financiar u krijua në këtë mënyrë brenda Prokurorisë për Krimin e Organizuar. Kriza e migrantëve e vitit 2015 shkaktoi krijimin e Task Forcës së Përshërme për Luftën kundër Kontrabandës me Njerëz. Ajo u formua në vitin 2016 dhe përfshinte përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Prokurorisë Publike të Republikës, të cilët merreshin me luftimin e kontrabandës së organizuar të qenieve njerëzore. Task forca vazhdoi të punojë përmes Departamentit për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Kontrabandës me Njerëz në Shërbimin për Luftimin e Krimit të Organizuar.

Mënyra më e lehtë për të zbuluar dhe dëshmuar veprimtaritë e një GOK është që një pjesëtar i GOK të bashkëpunojë me policinë ose prokurorinë për të zbuluar informacionin operativ të nevojshëm si provë në gjykatë. Në atë rast, personi merr statusin e dëshmitarit të mbrojtur dhe për të kujdeset Njësia e Mbrojtjes brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme. Përgjimi i fshehtë i komunikimeve, mbikëqyrja dhe regjistrimi i fshehtë, operacionet e simuluar, kërkimi i të dhënave kompjuterike, shpërndarja e kontrolluar dhe hetuesit e fshehtë janë veprime speciale hetimore/dëshmuar siç përcaktohet nga Kodi i Procedurës Penale dhe mund të zbatohen në luftën kundër KO.<sup>7</sup> Sidoqoftë, "Serbia është vonuar në kryerjen e analizave të roleve dhe praktikave të shërbimeve të sigurisë dhe policisë në zbatimin e masave speciale hetimore, veçanërisht në përgjim, në fazën para hetimore, që do t'i sillte ato në përputhje me praktikat më të mira Evropiane".<sup>8</sup> Siç duket, BIA, i vetmi shërbim civil i sigurisë në Serbi, është i vetmi institucion i ngarkuar me zbatimin e masave speciale hetimore, për shkak të faktit se ajo zotëron aftësitë e nevojshme teknike. Prandaj, policia nuk mund të zbatojë në mënyrë të pavarur masa speciale hetimore dhe kështu varet nga BIA. Për më tepër, hetimet financiare janë të rëndësishme për zbulimin e rrjedhës së parave në lidhje me KO, por Serbia për fat të keq nuk ka kapacitete të mjaftueshme në këtë drejtim.

Në Strategjinë Kombëtare për Luftën Kundër Krimit të Organizuar 2009, u theksua se "Qeveria do të krijojë të gjitha parakushtet e nevojshme politike dhe ligjore për zbatimin e suksesshëm të Strategjisë, me fokus në tri parime themelore: zbatimin dhe zhvillimin e veprimeve parandaluese dhe luftuese dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë kriminale".<sup>9</sup> Një nga prioritetet e Qeverisë së re të Republikës së Serbisë, e formuar në tetor 2020 (dhe siç thuhet në fjalën e Kryeministrit) në luftën kundër KO është përqendrimi në "ndërprerjen e burimeve të financimit të grupeve të organizuara kriminale dhe thyerjen e rrjetit të tyre të ndikimit në organet shtetërore, në politikë dhe në media".<sup>10</sup> Megjithatë rregulloret ligjore që lejojnë institucionet kompetente të luftojnë

6 *Po aty*, nenet 19-23 (qasur më 27 janar 2021)

7 Kodi i Procedurës Penale, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë" nr. 72/2011, 101/2011, 121/2012, 32/2013, 45/2013, 55/2014 dhe 35/2019, nenet 161-187, në dispozicion në: [https://www.paragraf.rs/propisi/zakonik\\_o\\_kvivicnom\\_postupku.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakonik_o_kvivicnom_postupku.html) (qasur më 27 janar 2021)

8 Komisioni Evropian (2020), "Dokumenti i punës së stafit të Komisionit: Raporti Serbia 2020", Bruksel, f. 42, në dispozicion në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/serbia\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/serbia_report_2020.pdf) (qasur më 12 shkurt 2021)

9 Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Krimit të Organizuar, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë" nr. 23/2009, në dispozicion në: [http://demo.paragraf.rs/demo/combined/Old/t/2009\\_04/t04\\_0105.htm](http://demo.paragraf.rs/demo/combined/Old/t/2009_04/t04_0105.htm) (qasur më 27 janar 2021)

10 "Programi i Qeverisë së Serbisë, kandidates për Kryeministre Ana Brnabić" (2020), f. 15, në dispozicion në: [https://www.srbija.gov.rs/view\\_file.php?file\\_id=2431&cache=sr](https://www.srbija.gov.rs/view_file.php?file_id=2431&cache=sr) (qasur më 27 janar 2021)

kundër KO janë miratuar gjatë periudhës 2009-2020, pengesë për luftë efektive kundër KO është kryesisht mungesa e vullnetit politik. Është deklaruar në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare të vitit 2019 se KO përfaqëson një “kërcënim të veçantë të sigurisë të paraqitur nga aktivitetet e grupeve kriminale në Serbinë e Jugut, kryesisht për shkak të lidhjeve të tyre me personat e përfshirë në aktivitete terroriste, ekstremiste dhe separatiste”.<sup>11</sup> Prandaj, lufta e suksesshme kundër KO kërkon bashkëpunim në nivelin rajonal, si dhe institucionet kombëtare që veprojnë pa ndikim politik.

## Bashkëpunimi në nivel rajonal dhe të BE-së dhe shkëmbimi i njohurive

Serbia është pjesë e rrugës Ballkanike dhe prandaj duhet të bashkëpunojë me të gjitha agjencitë rajonale të policisë. Ministria e Punëve të Brendshme ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi policor me të gjitha vendet në rajon përveç Kosovës. Kjo do të thotë se bashkëpunimi policor me Kosovën kryhet përmes ndërmjetësit, EULEX-it (Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë) dhe UNMIK-ut (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë), ndërsa bashkëpunimi i drejtpërdrejtë zhvillohet përmes ILECU (Njësieve për Koordinim Ndërkombëtar të Zbatimit të Ligjit), ashtu si bashkëpunimit të policisë kufitare në pikat kufitare.<sup>12</sup> Situata e ndërlikuar politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë vetëm lehtëson veprimtaritë kriminale të GOK-ve. Nga ana tjetër, Serbia ka bashkëpunim të mirë me Qendrën e Zbatimit të Ligjit të Evropës Juglindore (SELEC). “Serbia ka një zyrar ndërlidhës që punon atje, dhe përmes të cilit krijojmë kontakte të nevojshme. Ajo që është e rëndësishme për SELEC është ekspertiza dhe shpejtësia e tyre, sepse ata reagojnë jashtëzakonisht shpejt, gjë që është shumë e rëndësishme në luftën kundër KO.”<sup>13</sup>

Europol dhe Eurojust janë institucionet më të rëndësishme të BE-së që mundësojnë bashkëpunim në luftën kundër krimit të rëndë dhe të organizuar në nivelin e BE-së. Një bashkëpunim i tillë nënkupton bashkëpunimin policor dhe bashkëpunimin gjyqësor plotësues në çështjet penale.<sup>14</sup> Serbia ka lidhur një marrëveshje operacionale dhe strategjike me Europol në vitin 2014, ndërsa në vitin 2019 ajo ka lidhur një marrëveshje me Eurojust. Këto janë të rëndësishme sepse mundësojnë bashkëpunim të drejtpërdrejtë midis autoriteteve të policisë dhe institucioneve të mësipërme, si dhe shkëmbimin e informacionit në lidhje me raste specifike të KO. Gjithashtu, këto marrëveshje mundësojnë formimin e ekipeve të përbashkëta hetimore që do të përfshijnë zyrtarë policie nga Serbia. Historiku i mirë i ndjekjeve penale dhe dënimeve në rastet e KO është i rëndësishëm për pranimin e Serbisë në BE. Për fat të keq, Serbisë i mungon ky historik, gjë që është një çështje që i nënshtrohet kritikave nga Komisioni Evropian në raportet e tij vjetore të vendit për Serbinë.

11 Strategjia e Sigurisë Kombëtare (2019), “Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë” nr. 94/2019, në dispozicion në: <https://www.pravno-informacioni-sistem.rs/SlGlasnikPortal/eli/rep/sgrs/skupstina/strategjia/2019/94/2> (qasur më 27 janar 2021)

12 Elek, B. (2015), “Drejt një bashkëpunimi më efektiv policor midis Serbisë dhe Kosovës”, Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë, në dispozicion në: [https://bezbednost.org/wp-content/uploads/2020/07/towards\\_more\\_effective\\_police\\_cooperation\\_between\\_.pdf](https://bezbednost.org/wp-content/uploads/2020/07/towards_more_effective_police_cooperation_between_.pdf) (qasur më 27 janar 2021)

13 Intervistë me Millan Pekiq, Drejtor i Zyrës për Luftimin e Drogave, 9 shkurt 2021, Beograd

14 Tasić. D. dhe Elek, B. (2015), “Lufta kundër krimit të rëndë dhe të organizuar”, Stojanović Gajić, Sonja (Ed.), Udhëzues për Bashkëpunim në Punët e Brendshme në Bashkimin Evropian, Misioni i OSBE-së në Serbi dhe Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë, f. 165, në dispozicion në: [https://bezbednost.org/wp-content/uploads/2020/06/vodic\\_kroz\\_saradnju\\_u\\_unutrasnjim\\_poslovima\\_u\\_evro\\_20160629\\_11312.pdf](https://bezbednost.org/wp-content/uploads/2020/06/vodic_kroz_saradnju_u_unutrasnjim_poslovima_u_evro_20160629_11312.pdf) (qasur më 27 janar 2021)



## Historiku i përpjekjeve të Serbisë kundër KO

Të dhëna gjithëpërfshirëse, të ndara në lidhje me ndjekjet penale dhe dënimet në rastet e KO nuk janë në dispozicion të publikut për shkak të praktikave të ndryshme të mbajtjes së shënimeve të agjencive të zbatimit të ligjit. Sidoqoftë, disa informacione mund të gjenden në raportin e Komisionit Evropian, i cili thotë se “hetimet e reja për GOK-e filluan në vitin 2019 kundër 156 individëve (krahasuar me 146 në vitin 2018, dhe 191 në vitin 2017). Aktakuzat u ngritën kundër 65 individëve. Numri i dënimeve në rastet e KO është pak në rritje: dënimet (shkalla e parë) në vitin 2019 janë shqiptuar në rastin e 167 individëve (nga të cilat 42 ishin marrëveshje për pranimin e fajësisë të miratuara nga gjykatat) krahasuar me 155 në vitin 2018.”<sup>15</sup> Praktika e luftës kundër KO në Serbi karakterizohet nga arrestime masive, kryesisht të kryesve të krimeve më pak të rënda, pa elemente të organizimit. Për më tepër, këto arrestime masive shoqërohen nga një retorikë populiste e politikanëve dhe zyrtarëve publikë.<sup>16</sup>

Në periudhën nga viti 2015 (kur raporti SOCTA u publikua për herë të parë) deri në vitin 2019 (kur vlerësimi i dytë zyrtar u publikua nga Ministria e Punëve të Brendshme), numri i GOK-ve u zvogëluar, gjë që i atribuohet punës së mirë të policisë. Aktualisht janë 27 GOK-e që veprojnë në Serbi (15 GOK-e të nivelit të mesëm, 7 të nivelit të lartë dhe 5 të nivelit të ulët, të shikuara në lidhje me nivelin e organizimit).<sup>17</sup> Konflikti midis klaneve kriminale Shkalari dhe Kavaç ka vazhduar që nga viti 2014. Ai ndau nëntokën kriminale në Serbi, duke bërë që GOK-et të kalonin në anën e një klani ose tjetrit. Ky është një shpjegim i mundshëm për zvogëlimin e numrit të GOK-ve. Pjesëtarët e klanit Shkalari u arrestuan në aksionet policore kryesisht sepse ishin më të shumtë dhe më aktivë në Serbi. Raportet nga gazetarët hulumtues tregojnë se ka lidhje të caktuara midis përfaqësuesve të shtetit dhe pjesëtarëve të klanit Kavaç.<sup>18</sup> Konflikti i këtyre klaneve kontribuoi në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e vrasjeve ‘mafioze’ në territorin e Serbisë. Bazuar në të dhënat e përpiluara nga një portal i lajmeve hulumtuese, ka pasur 86 vrasje të stilit mafioz në Serbi në periudhën midis vitit 2015, kur u vra viktimat e parë e këtij konflikti dhe vitit 2020. Kryesit e 49 prej këtyre vrasjeve janë ende të panjohur.<sup>19</sup>

Pjesëtarët e grupit kriminal-huligan *Principi*, të cilët ishin pjesë e klanit Kavaç, u arrestuan në fillim të shkurtit 2021. Velko Bellivuk, udhëheqësi i atij grupi kriminal-huligan dhe pjesëtarët e këtij grupi dyshohen gjithashtu për trafikim droge, rrëmbim dhe disa vrasje. Sidoqoftë, hetimi i profilin të lartë i këtij grupi mbulon periudhën nga viti 2019 e tutje, pavarësisht nga fakti se grupi ishte në atë kohë tashmë aktiv për disa vjet, dhe

15 Komisioni Evropian (2020), “Dokumentin e punës së stafit të Komisionit: Raporti Serbia 2020”, Bruksel, f. 43, në dispozicion në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/serbia\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/serbia_report_2020.pdf) (qasur më 12 shkurt 2021)

16 Pejić Nikić, J. (Ed.) (2020), “Alarmi prEUgovor (para kontratës me BE): Raporti mbi Progresin e Serbisë në Kapitujt 23 dhe 24”, koalicioni prEUgovor, maj 2020, Beograd, në dispozicion në: [http://preugovor.org/upload/document/alarm\\_report.pdf](http://preugovor.org/upload/document/alarm_report.pdf) (qasur më 12 shkurt 2021)

17 Ministria e Punëve të Brendshme (2019) “Vlerësimi i Kërcënimit nga Krimi i Rëndë dhe i Organizuar 2019”, në dispozicion në: <http://www.mup.gov.rs/wps/wcm/connect/3d0a3df4-4e1d-4b70-8475-3d69f6d21107/SOCTA+2019++ENG-compressed.pdf?MOD=AJPERES&CVID=nnvY-lq8> (qasur më 12 shkurt 2021)

18 Vojinović, M. dhe Pavlović, B. (2019) “Stefanović për arrestimet: Klani Shkalar është më i fortë në Serbi”, në dispozicion në <https://www.krik.rs/stefanovic-o-hapsenjima-u-srbiji-ja-ci-skaljarski-klan/> (qasur më 7 mars 2021)

19 KRIK dhe Radio Evropa e Lirë (2021), “Libri i zi”, në dispozicion në: <https://www.crnaknjiga.rs/index.php> (qasur më 12 shkurt 2021)

pavarësisht lidhjeve të vendosura mirë midis pjesëtarëve të tyre dhe zyrtarëve të lartë të shtetit.<sup>20</sup> Në një rast tjetër të njohur si Jovanjica, pjesëtarët e policisë, BIA-s dhe VBA-s u akuzuan për trafikim droge, falsifikim dokumentesh dhe bashkimit me qëllim të kryerjes së veprave penale. Aktakuza për këtë rast u paraqit në Gjykatën e Apelit për vendim.<sup>21</sup> Jovanjica është mbase plantacioni më i madh i marihuanës që është zbuluar në Evropë. Përkundër lidhjeve të dëshmuara të GOK-ve me zyrtarë shtetërorë në të dyja këto raste, procedimi penal nuk i adresoi kurrë ato, gjë që tregon se sa serioze është Qeveria kur bëhet fjalë për trajtimin e KO-ve.

## Mangësitë dhe sfidat kryesore

Institucionet duhet të jenë të pavarura dhe autonome për të qenë në gjendje të luftojnë me sukses kundër KO, por në Serbi, vullneti politik i kufizon ato në këtë fushë. Siç deklaroi një përfaqësues i gjyqësorit, lufta kundër mafisë në Serbi është vënë në skenë "sepse shumë gjëra varen nga politika. Policia, prokuroria dhe gjykatat janë një sistem, por vullneti politik është problemi kryesor."<sup>22</sup> Megjithëse ka profesionistë të vërtetë në institucionet e zbatimit të ligjit, ata nuk mund të bëjnë punën e tyre, veçanërisht nëse puna bie ndesh me interesat e elitës politike. Prandaj, në Serbi vullneti politik është faktori kryesor për të vendosur se si do të bëhet lufta kundër GOK-ve.

Problemi kryesor në punën e policisë është se ajo nuk është e pavarur në mënyrë operacionale, pasi varet nga vendimet e zyrtarëve politikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. "Nuk ka një ndarje të qartë midis policisë, si autoritet civil qeveritar i autorizuar nga ligji për të marrë masa shtrënguese për të zgjidhur situata të dëmshme ose potencialisht të pasigurta, dhe Ministrisë, si pjesë strukturore e Qeverisë e formësuar për të siguruar kërkesat organizative për policinë (buxheti, burimet njerëzore, toka, prona dhe pajisjet)."<sup>23</sup> Në praktikë, kjo situatë reflektohet në faktin se çdo procedim operativ që është veçanërisht i rëndësishëm për luftën kundër KO mund të ndikohet nga Ministri i Punëve të Brendshme i cili është i emëruar politik.

Policia nuk ka bashkëpunim të mjaftueshëm me prokurorinë, përkundër faktit se hetimet prokuroriale filluan që në vitin 2013. Kjo do të thotë që prokuroria kryen hetime, ndërsa policia duhet të zbatojë urdhrat e prokurorisë. Sidoqoftë, problemi është se "gjatë fazave të para hetimit dhe hetimit, policia duhet të raportojë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, jo vetëm në prokurori."<sup>24</sup> Një çështje tjetër është se "marrëdhëniet me mediat, përfshirë njoftimet për shtyp në lidhje me operacionet e vazhdueshme, ende menaxhohen kryesisht nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe jo nga prokuroria dhe/

20 Vojinović, M. (2021), "Belivuk dhe anëtarët e grupit të tij janë mbajtur në paraburgim", në dispozicion në: <https://www.krik.rs/belivuku-i-clanovima-njegove-grupe-produzen-pritvor/> (qasur më 7 mars 2021)

21 Veljković, J. (2021), "Jovanjica 2 e dorëzuar në Gjykatën e Apelit", në dispozicion në: <https://birn.rs/jovanjica-2-dostavljena-apelacionom-sudu/> (qasur më 7 mars 2021)

22 Intervistë me një përfaqësues të gjyqësorit, 10 shkurt 2021, Beograd

23 Pejić Nikić, J. (Ed.) (2020), "Alarmi prEUgovor (para kontratës me BE): Raporti mbi Progresin e Serbisë në Kapitujt 23 dhe 24", koalicioni prEUgovor, maj 2020, Beograd, f. 92, në dispozicion në: [http://preugovor.org/upload/document/alarm\\_report.pdf](http://preugovor.org/upload/document/alarm_report.pdf) (qasur më 12 shkurt 2021)

24 Komisioni Evropian (2020), "Dokumenti i punës së stafit të Komisionit: Raporti Serbia 2020", Bruksel, f. 42, në dispozicion në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/serbia\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/serbia_report_2020.pdf) (qasur më 12 shkurt 2021)

ose policia.”<sup>25</sup> Kjo bën të mundur që përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme të abuzojnë me informacionin nga hetimet e vazhdueshme duke i vendosur ato në media për qëllimet e tyre, gjë që është praktikë që përdoret gjerësisht në Serbi. Për më tepër, Prokuroria për Krimin e Organizuar ka problem me burimet njerëzore, prandaj Komisioni Evropian rekomandon që të rriten kapacitetet e saj njerëzore dhe financiare.<sup>26</sup>

Sipas një të intervistuari, të dy “gjyqësori dhe prokuroria kanë problem me njerëzit që i udhëheqin ato – respektivisht, Këshillin e Gjykatës së Lartë dhe Këshillin Prokurorial të Shtetit. Në rast të një fushate për shpifje mediatike, këto organe duhet të na mbrojnë, dhe ato nuk e bëjnë këtë. Asnjë politikan nuk do të ushtrojë presion të drejtpërdrejtë dhe të thotë ‘bëje këtë dhe atë’; presioni zbatohet në mënyra të tjera, për shembull përmes gjykimeve të mbajtura nga media. Roli që luajnë mediat është mjaft pikëllues; për shkak të sensacionalizmit, provat paraqiten së pari në media dhe vetëm pastaj në gjykatë.”<sup>27</sup> Kjo është pasojë e rrjedhjes së informacionit nga hetimi dhe dorëzimit të tij te tabloidet pro-qeveritare. Kur raportohet për raste të luftës kundër KO, roli i këtyre mediave është t’u përgjigjen kërkesave të elitës politike, gjë që rezulton në krijimin e konkluzioneve të gabuara në publik. Kjo është arsyeja pse raportet e mediave të pavarura, ato që tregojnë fakte të rëndësishme nga raste konkrete të KO, janë shumë të rëndësishme për luftën kundër KO.

## Konkluzion

Korniza ligjor për luftën kundër KO në Serbi është zhvilluar mjaftueshëm, që është të paktën pjesërisht rezultat i harmonizimit të rregulloreve me *acquis* të BE-së. Korniza institucionale është e vendosur, por bashkëpunimi ndërmjet Shërbimit për Luftimin e Krimin të Organizuar dhe Prokurorisë për Krimin e Organizuar nuk është mjaft i mirë. Fatkeqësisht, nuk ka të dhëna të sistemuara dhe të disponueshme publikisht mbi historikun e përpjekjeve të bëra nga Shërbimi i mësipërm, Prokuroria e mësipërme dhe Departamenti Special për Krimin e Organizuar i Gjykatës së Lartë në Beograd. Historiku është i vështirë të kuptohet sepse këto institucione nuk kanë të dhëna të krahasueshme në dispozicion të publikut se sa hetime penale kanë filluar ose sa procedime penale kanë përfunduar në dënime. Prandaj është jashtëzakonisht e vështirë të përcaktohet ndikimi i tyre i vërtetë në luftën kundër KO, dhe publiku nuk i ka këto informacione.

Elita politike në Serbi është e zotuar në mënyrë deklarative në luftën kundër KO, por mungojnë pasojat praktike të zotimit të përmendur. Roli i mediave është shumë i rëndësishëm në luftën kundër KO, por mediat shpesh abuzohen nga elita politike. Provat paraqiten në tabloide, duke prishur hetimet. Si pasojë, qytetarët marrin përshtypjen e gabuar se lufta kundër KO po vazhdon në drejtimin e duhur dhe se rezultatet janë të mira. Gazetarët hulumtues kanë zbuluar lidhje midis përfaqësuesve të shtetit dhe pjesëtarëve të GOK-ve në shumë raste, por asnjë procedurë penale nuk është iniciuar deri më sot. Institucionet në Serbi nuk janë efikase në luftën kundër KO sepse nuk janë të pavarura. Elita politike ndërhyr në punën e tyre, gjë që rezulton në një luftë selektive kundër krimin të organizuar.

25 *Po aty* (qasur më 12 shkurt 2021)

26 *Po aty*, f. 41 (qasur më 12 shkurt 2021)

27 Intervistë me një përfaqësues të gjyqësorit, 10 shkurt 2021, Beograd

## Rekomandime

Është e nevojshme të mbrohet autonomia operacionale e Shërbimit për Luftimin e Krimin të Organizuar dhe Prokurorisë për Krimin e Organizuar;

Bashkëpunimi i mirë ndërmjet Shërbimit për Luftimin e Krimin të Organizuar dhe Prokurorisë për Krimin e Organizuar është i një rëndësie thelbësore në luftën kundër KO. Në atë kuptim, punonjësit e Shërbimit të mësipërm duhet të japin llogari direkt pranë Prokurorisë së mësipërme;

Shërbimi për Luftimin e Krimin të Organizuar, Prokuroria për Krimin e Organizuar dhe Departamenti Special për Krimin e Organizuar i Gjykatës së Lartë në Beograd duhet të publikojnë raporte mbi punën e tyre në lidhje me ndjekjen penale dhe dënimet, dhe kështu të mundësojnë analiza cilësore dhe sasore të luftës kundër KO;

Bashkëpunimi policor me Kosovën duhet të përmirësohet dhe avancohet përmes bashkëpunimit më të drejtpërdrejtë, pasi kjo është mënyra e vetme për të parandaluar aktivitetet e GOK-ve në këto territore;

Këshilli i Gjykatës së Lartë dhe Këshilli Prokurorial i Shtetit duhet të sigurojnë integritetin e sistemit gjyqësor dhe të mbrojnë gjyqtarët dhe prokurorët publik në rast presioni në mënyrë që ata të vazhdojnë të bëjnë punën e tyre në mënyrë të pavarur.

## Bibliografia

Criminal Procedure Code, "Official Gazette of the Republic of Serbia" nos. 72/2011, 101/2011, 121/2012, 32/2013, 45/2013, 55/2014 and 35/2019, available at: [https://www.paragraf.rs/propisi/zakonik\\_o\\_kvivicnom\\_postupku.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakonik_o_kvivicnom_postupku.html) (accessed on 27 January 2021)

Elek, B. (2015), "Towards More Effective Police Cooperation between Serbia and Kosovo", Belgrade Centre for Security Policy, available at: [https://bezbednost.org/wp-content/uploads/2020/07/towards\\_more\\_effective\\_police\\_cooperation\\_between\\_.pdf](https://bezbednost.org/wp-content/uploads/2020/07/towards_more_effective_police_cooperation_between_.pdf) (accessed on 27 January 2021)

European Commission (2020), "Commission staff working document: Serbia 2020 report", Brussels, available at: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/serbia\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/serbia_report_2020.pdf) (accessed on 12 February 2021)

Ignjatijević, M., Elek, B. and Pavlović, M. (2020), "Weapons against 'white plague', crime and corruption: Citizens' view of security", Belgrade Centre for Security Policy, available at: <https://bezbednost.org/wp-content/uploads/2020/11/naoruzanje-03.pdf> (accessed on 27 January 2021)

KRIK and Radio Freed Europe (2021), "Black book", available at: <https://www.crnaknjiga.rs/index.php> (accessed on 12 February 2021)

Law on the Organisation and Competence of State Bodies in the Suppression of Organised crime, Terrorism, and Corruption, "Official Gazette of the Republic of Serbia" nos. 94/2016 and 87/2018, available at: <https://www.paragraf.rs/propisi/zakon-o-organizaciji-i-nadleznosti-drzavnih-organa-u-suzbijanju-organizovanog-kriminala-terorizma-i-korupcije.html> (accessed on 27 January 2021)

Ministry of Interior (2019) "Serious and Organised Crime Threat Assessment 2019", available at: <http://www.mup.gov.rs/wps/wcm/connect/3d0a3df4-4e1d-4b70-8475-3d69f6d21107/SOCTA+2019+-+ENG-compressed.pdf?MOD=AJPERES&CVID=nnvYlq8> (accessed on 12 February 2021)

National Security Strategy (2019), "Official Gazette of the Republic of Serbia" no. 94/2019, available at: <https://www.pravnoinformacionisistem.rs/SIGlasnikPortal/eli/rep/sgrs/skupstina/strategija/2019/94/2> (accessed on 27 January 2021)

National Strategy for the Fight against Organised Crime, "Official Gazette of the Republic of Serbia" no. 23/2009, available at: [http://demo.paragraf.rs/demo/combined/Old-/t/t2009\\_04/t04\\_0105.htm](http://demo.paragraf.rs/demo/combined/Old-/t/t2009_04/t04_0105.htm) (accessed on 27 January 2021)

"Programme of the Government of Serbia, candidate for Prime Minister Ana Brnabić" (2020), available at: [https://www.srbija.gov.rs/view\\_file.php?file\\_id=2431&cache=sr](https://www.srbija.gov.rs/view_file.php?file_id=2431&cache=sr) (accessed on 27 January 2021)

Pejić Nikić, J. (Ed.) (2020), "prEUgovor Alarm: Report on the Progress of Serbia in Chapters 23 and 24", prEUgovor coalition, May 2020, Belgrade, available at: [http://preu.govor.org/upload/document/alarm\\_report.pdf](http://preu.govor.org/upload/document/alarm_report.pdf) (accessed on 12 February 2021)

Tasić. D. and Elek, B. (2015), "Fight against Serious and Organised Crime", Stojanović Gajić. Sonja (ed.), A guide to cooperation in internal affairs in the European Union, OSCE Mission to Serbia and Belgrade Centre for Security Policy, available at: [https://bezbednost.org/wp-content/uploads/2020/06/vodic\\_kroz\\_saradnju\\_u\\_unutrasnjim\\_poslovi-ma\\_u\\_evro\\_20160629\\_113122.pdf](https://bezbednost.org/wp-content/uploads/2020/06/vodic_kroz_saradnju_u_unutrasnjim_poslovi-ma_u_evro_20160629_113122.pdf) (accessed 27 January 2021)

Veljković, J. (2021), "Jovanjica 2 submitted to the Court of Appeals", available at: <https://birn.rs/jovanjica-2-dostavljena-apelacionom-sudu/> (accessed on 07 Mart 2021)

Vojinović, M. (2021), "Belivuk and members of his group have been remanded in custody", available at: <https://www.krik.rs/belivuku-i-clanovima-njegove-grupe-produzen-pri-tvor/> (accessed on 07 Mart 2021)

Vojinović, M. and Pavlović, B. (2019) "Stefanović on arrests: The Škaljar clan is stronger in Serbia", available at: <https://www.krik.rs/stefanovic-o-hapsenjima-u-srbiji-jaci-skaljarski-klan/> (accessed on 07 Mart 2021)



**BCSP**

[bezbednost.org](http://bezbednost.org)



WESTERN BALKANS  
ORGANIZED CRIME  
**RADAR**

[radar.bezbednost.org](http://radar.bezbednost.org)